ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues · Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 23 GUSHT 2025 · NUMËR 349 · VITI VIII I BOTIMIT · ÇMIMI 50 LEKË · WWW.EXLIBRIS.AL · EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL · BOTIM I ONUFRI SHPK

Përkthyesja nga bullgarishtja në shqip, dhe anajelltas

JANKA SELIMI TRIFONOVA:

Përkthimi është pasioni im, më ka mbajtur dhe më mban në jetë

Bisedoi Andreas Dushi

PANAIRI I LIBRIT NË SHËNGJIN 22-23 GUSHT

PROMOVOHEN AUTORËT NIKO KACALIDHA DHE PASHKO R. CAMAJ NË SARANDË, 26 GUSHT

ora 11.00 , tek "GALERIA E ARTEVE SARANDË"

SHËNIME PËR LIBRAT

Kasëm Trebeshina ka nevojë për të pasur marrëdhënie normale me lexuesin, larg demonëve që ia bënë jetën skëterrë.

Letra që rrëzon alibinë e një disidence të stimuluar

Nga Fatbardh Amursi (fq. 5)

ROMANI "SAGA E SARAJEVËS" NGA STEFAN ÇAPALIKU

Nga Robert Prennushi (fq. 8)

Rreth romanit të Anton Nikë Berishës "Bimorja"

E kaluara e ndritshme e përjetësuar poetikisht

Nga Timo Mërkuri (fq. 10)

Rruga e Humanizmit dhe Kujtesa Kolektive: Letërsia e Visar Zhitit në Kontekstin Shqiptar dhe Botëror

Nga Dr. Belfjore Zifla (Qose) (fq. 13)

Danimarka heq TVSH-në për librat për të frenuar "krizën e leximit"

Në Danimarkë, një e katërta e pesëmbëdhjetëvjeçarëve "nuk janë në gjendje të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst të thjeshtë". Qeveria daneze ka vendosur të heqë TVSH-në për librat "për të frenuar krizën e leximit".

"Kleopatra dhe Frankenshtajni", ose rinia nëpërmjet një lupe të re

Rinia dhe qyteti në "Kleopatra dhe Frankenshtajni"

Nga Danielle Bartholet

The Berkeley Beacon (fq. 23)

Botim i ri nga "Minerva"

SI T'I PËRDORNI ARMIQTË TUAJ

Nga Baltasar Gracián (fq. 9)

Oresti, Hamleti ynë Proto-Shekspirian

Nga Orin Maxhari (fq. 12)



BIBLIOTEKË

Ilias Qefallas, Janis Stefanakis, Janis Patilis (fq. 14)
Tre poetë bashkohorë grekë
Përktheu: Niko Kacalidha

Raymond Carver (fq. 16)
Gënjeshtra
Përktheu: Ndue Gjika

Xheni Shehaj (fq. 17)
Ne, banorët e ishullit gri

Odise Kote (fq. 18)
Burrat e mirë kthehen ...

Frano Kulli (fq. 19)
Fletëkampi

Faruk Myrtaj (fq. 20)
Njeriu vdes për librin e të tjerëve

Zaho Vasili (fq. 21)
Dy lumenjtë

Irwin Shaw (fq. 22)
Pjetri Numër 2
Zgjodhi dhe përktheu: Rudolf Marku

Arben Meksi (fq. 24)
Karikatura e së shtunës

Sprovë modeste për të "lexuar" pikturën e Arben Theodhosit

ARTI QË VJEN PREJ FERRIT

Nga Luan Rama (fq. 7)

JANKA SELIMI TRIFONOVA:

Përkthimi është pasioni im, më ka mbajtur dhe më mban në jetë

Bisedoi Andreas Dushi

Vizatim nga Anastas Kostandini - Taso

A.D.: Zonja Janka, mbiemri juaj i vajzërisë është Trifonova, ndërsa ai pas martese, Selimi. Keni lindur në Bullgari dhe jetën po e kaloni, prej dekadash tanimë, në Shqipëri. Si u gjendët në këtë vend dhe, a u ndjetë e mirepritur?

J.S.: Në Shqipëri më solli dashuria ime Skender Selimin. Si studentë nga dy vende mike të Ballkanit, ne u takuam në Moskë, u dashuruam dhe u martuam atje. Skenderi mbaroi studimet dy vjet para meje dhe punonte si baletmaester në Teatrin e Operas dhe Baletit në Tiranë. Kur unë u ktheva pas diplomimit tim në Bullgari erdhi dhe Skenderi nga Shqipëtia. Prindërit e mi nuk arritën të gëzohen, ata u mërzitën shumë. Nuk prisnin të largohesha kaq shpejt, i lëndova shumë.. Nuk ishte i lehtë largimi dhe ndarrja nga vendi im dhe nga prindërit, por ne kishim dhënë fjalën njeri tjetrit, kishim vendosur se do të jetonim dhe do të punonim edhe në Shqipëri edhe në Bullgari. Kështu i thamë edhe prindërve të mi. Vendet tona bënin pjesë në kampin socialist atëherë, levizjet midis tyre ishin të lira, ishim vende vëllezër, prandaj idea ishte e mundëshme për t'u realizuar dhe e pranueshme për të dyja palet. Me 24 gusht të vitit 1958 unë erdha në Tiranë bashkë me burrin tim Skenderi për të jetuar dhe krijuar familjen tonë. Në fakt kjo ishte hera e dytë që vija në Tiranë. Për herë të parë, akoma studente, kisha qenë gjashtë muaj më parë, për festën e Vitit të Ri dhe u prita si nuse në familje. Këtë herë po vija përgjithmonë dhe isha mjaft Në Tiranë u prita shumë mirë në familje, farefis dhe shoqëri. Shumë shok e miq të dashur i njihja qe kur ishim studentë. Ata ishin një rreth i gjerë artistësh dhe njerëz të kulturës, miq e shok të bashkëshortit tim, dhe më kishin pranuar edhe mua në mesin e tyre. Me disa kishim mbaruar të njëjtën shkollë si Shefqet Selan dhe e shoqja Galja, me të tjera u njoha në punë dhe kudo ndjihesha mirë. Jetonim në Tiranën e re, në Pallatet e " 1 Majit". Gjeta mikpritjen dhe mbështetjen edhe të fqinjeve mësueses Hatixhe Daci, mjekes pediatre bullgare Rashella Cikuli dhe të Antigoni Lekës etj. Më vonë këto marrëdhënje miqësore dhe dashamirëse u zgjaruan. Me kalimin e viteve fillova të ndjihem pjesë e kësaj shoqërie, më pak si e huaj më shumë si shqiptare.

A.D.: Në çastet e ngatërruara të historisë së 45 viteve komunizëm, kur dinamikat e marrëdhënieve me jashtë dëshmonin herë vëllazëri e herë armiqësi, si ishte gjendja e përgjithshme shoqërore ndaj jush?

J.S.: Vitet e para në Shqipëri kaluan shumë mirë në situatën e miqësisë dhe atmosferën e përgjithshme që ngjasonte shumë në të dy vëndet tona. Ne ishim rritur dhe edukuar në kushtet e socualizmit besonim në miqësinë midis popujve kështu që nuk kishte shumë ndryshime sa i përket jetës sociale apo politike në të dy vendet tona. Çdo vitë unë shkoja për vizitë në Bullgari pa pengesa. Me prishjen e marrëdhënjeve gjithçka ndryshoi. Në shtator të vitit 1961 isha për vizitë në Bullgari kur im shoq më njoftoi se duhet të kthehem urgjentë. Isha me djalin pa mbushur 2 vjeç. Babi im më paralajmeroi, ai tha: Mendohu mirë, kufit do të mbyllen. Kësaj rradhe unë nuk mendova për dashurinë time, por për atë të tim biri dhe babit të tij, nuk mund t'ua privoja. Dhe u ktheva në Tiranë bashkë me djalin për të vazhduar këtu jetën e familjes tonë në kushtet e izolimit. Ndryshoi opinioni ndaj grave të huaja. Disa u larguan shumë shpejt. Dyshimi dhe ndekjet filluan, u ngushtua rrethi i miqësisë dhe i shoqërimit. Filloi i ashtuquaturi qarkullimi , pastaj arestime dhe burgosje. Shumë familja me gra të huaja u përfshinë në këto levizje. Në vitin 1976 burrin tim Skënder Selimi e dërguan në Koplik, në shtëpinë e kulturës, ku mbeti plot 6 vjet. Unë vazhdova në Radio. Isha vetëm një përkthyese në emisionin e bullgarishtes. Puna u shtua, shumë herë pa pushime javore, madje u hap dhe dega e gjuhëve të vogla te filologjiku dhe u caktova pedagoge e jashtme edhe atje. Ishin vite shumë të vështira, tronditjet vinin njeri pas tjetrit, përjetova strese dhe frika të papërshkruara pas arestimit dhe burgosjes së grave ruse, mes të cilave shoqen time te ngushtë Inga Tarasova, pedagogja e rusishtes në Universitet. Në rrethin e miqve po ashtu plot burgosje dhe internime. Dhe vet s'e di ku gjeta forca të mbijetoja. Unë, e huaj, në shtëpi me vjehrën e sëmurë, djali ne gjimnaz, vajza në follore, burri vinte të shtunave në dark, here me kamiona, herë me tren, i lodhur, përpiqeshim të mbajmë frymën e gëzimit dhe dashurisë në familje. U përqëndrova te puna dhe kujdesi për fëmijet. Lufta kundër çfaqjeve të

huaja Edhe në këtë drejtim ishim në shinjestër. Me nënë te huaj dhe babë kosovar patjetër që një ditë e pësuan. Një ditë djali kishte kërcyer nga dritarja e klasës në katin e parë. Organizata e rinisë erdhi në shtëpi me paralajmerim. Kalamajt e lagjes i thanë vajzës"revizioniste".Për rastin e djalit sigurisht e pranova dhe e qortova. Sa për nofkën e vajzës u revoltova dhe u ankova tee prindit e fëmijes, por shyqyr pa pasoja. Ç'të them, e tillë ishte koha!

Përpara dy vitesh, mos gaboj, Milena më lexoi një material që gjendet në dosjet e sigurimit të shtetit për Janka Selimin. Diçka e tillë "Janka Trifonova Selimi, e datëlindjes 1935, lindur në Bullgari, me kombësi bullgare e shtetësi shqiptare, e martuar me ..., e padënuar, e paorganizuar, me punë në Radio-Tirana, përkthyese. Ka frekuentuar ambasadën bullgare. Burri i saj S.S është me qëndrim të keq politik". Di të them se shkoja në punë me frikën se mund të mos ktheheshe jo vetëm aty, por as në shtëpinë tënde. Kam ndier ndjekjen në vitet '74-'76, vite kur im shoq Skënder Selimi u transferua në Koplik. Atë kohë, punoja si përkthyese e bullgarishtes në Radio-Tirana. Dy miq të afërt të familjes sonë u arrestuan dhe kur shkoja në punë me biçikletë, ndieja se më shoqëronte një xhip, që e dinim se ishte makina e Sigurimit, sepse të tilla ishin makinat e Sigurimit të Shtetit. Nuk dua ta di kush janë spiunët, ata kanë punuar me mua, dosja ka plot pseudonime, por nuk e kam lexuar dhe nuk më intereson, ajo kohë i shpërfytyroi njerëzit. Unë mbijetova falë punës, dashurisë dhe familjes.

A.D.: Patët ndonjë moment kur ju kërkuan të iknit? Po ndonjë moment kur menduar vetë ta bënit këtë?

J.S.: Jo nuk kam patur moment të tillë, unë nuk kam menduar asnjëherë të largohem.

A.D.: Si e kujtoni bashkëshortin tuaj që, fatkeqësisht, ndërroi jetë shumë shepjt, baletmaestrin e parë Skënder Selimi? Çfarë ndikimi pati tek ju fama, jeta dhe gjithë aktiviteti i tij artistik? Po te familja?

J.S.: Skënderin e kujtoj me shumë mall. Çdo ditë, orë e çast ! Më mungon. Jetuam plot 60 vjet bashkë. Ai ishte një bashkëshort dhe prind të veçant, artist dhe personalitet i jashtëzakonshëm. Për të të duash do të thoshte të duash jetën! Ai donte me shpirt familjen, natyrën, njerëzit, Shqipërinë,Kosovën! Jetoj i përkushtuar dy dashurive me të mëdha të jetës së tij , familjes dhe artit! Ne u bëmë prindër të lumtur, rritëm, edukuam dhe nxorrëm në jetë dy fëmijet tanë, djalin Adrian Selimin dhe vajzën Milena Selimi. Ai ishte i palodhur si babë dhe bëri çmos që ata të realizonin dëshirat e tyre. Akoma

më i palodhur dhe i apasionuar Skënderi ishte si baletmaestër shumë i talentuar, pedagog, profesor dhe doktor i shkencave, me baletet

që ka vënë në skenë në Teatrin e Operas dhe Baletit, me kërkimet dhe veprat teorike dhe studimore në fushën e koreoggrafisë, me pedagogjinë, programet dhe tekstet për katedrën e koreografisë që hapi ai në Akademinë e arteve, ku sot punojnë si profesorë dhe pedagogë ish studentë tij. Jeta e një artisti të tillë, fama e tij patën një ndikim shumë pozitiv tek unë, unë isha bashkëudhëtarja e tij, ne ndanim ide dhe parime të përbashkëta për jetën, kulturën dhe artin, kemi jetuar bashkë çaste lumturie edhe hidhërime, ngritje dhe ulije të hasura jo një herë. Mbi të gjitha kishim një familje të mrekullueshme. Djali dhe vajza ishin lumturia dhe krenaria jonë. Por në vigjile të ndryshimeve të mëdha historike ne humbëm djalin tone. Na u desh të mbledhnim vetën, të vazhdojmë të jemi prindër, me detyrat dhe dashurinë. Punuam. Skënderi vazhdoi si profesor, vuri në skenë edhe njherë baletin " Sheherezada", ëndërronte të tjera, por u largua shpejt.

A.D.: Kur e filluat karrierën si përkthyese, zonja Janka? Cilat kujtoni të kenë qenë detyrat tuaja të para?

J.S.: Unë punoja si bibloigrafe në Bibliotekën Shkencore të Universitetit. E doja shumë punën me librin dhe isha miqësuar me punonjëset e bibliotekës. Drejtor kishim Mihal Hanxhari, inteligjent dhe njohes i letërsisë dhe kulturës botërore, poet. Në vitin 1966 na qarkulluan me Skenderin në Korçe. Pas 4 muajsh nuk gjetën punë për baletmaestrin Skender Selimi në Korçe. U ktheva në Bibliotekë. Por nuk qe e thënë të vazhdoja atje. Duhet të paraqitesha në Radion e jashtme. U shqetësova por refuzimi qe i pamundur. Dhe fillova punë si përkthyese - redaktore në emisionin e gjuhës bullgare. Përkthenim lajme, komente, rubrika dhe materiale vendi për dy emisione në ditë dhe disa transmetime. Unë isha përkthyese dhe folëse. Gjuha ishte politike, anti revizioniste, propagandistike dhe sociale. Kam përkthyer unë veprat e të madhit dhe shefja ime më thoshte " të kesh për nder ". Dhe mund të them se fal asaj pune 27 vjeçare në Radio, me gjithë tensionin dhe ngarkesën psikike, kërkesave dhe përgjegjësisë jetike për sa i përket saktësisë së përkthimit erdha dhe bëra një përkthyese e mirë. Dhe madje e dalluar, me urdhrdhin Naim Frashëri shkalla e tretë. Me mbylljen e emisionit në vitin 1993 fillova me përkthimin e letërsisë artistike. Fillova me tregime të autorëve bashkëkohor dhe klasik bullgar. Kam përkthyer romane nga gjuha bullgare, kroate, sërbe, maqedone, malëzeze si dhe nga shqip në bullgarisht të autorëve Georgi Gospodinov, Stefan Canev, Jordan Jovkov, Bllaga Dimitrova,

Renato Baretiç, Ivo Andriç. Ognen Spahiç, Jovan Nikolaidis , Arian Leka etj. Libri dhe letërsia janë bashkëudhëtarët e mi të pandarë.

A.D.: Ndjesë, pasi kaluam shumë, pa u ndalur në një çast kyç të jetës suaj: Shkollimin në Rusi. Përtej metodikës filologjike që, patjetër, e keni mësuar atje, cilat ishin ato tipare njerëzore që mendoni se u skalitën në ju gjatë atyre viteve?

J.S.: Unë i përkas brezit i cili u rrit dhe u shkollua në kohën e socializmit " ngadhnimtar ' dhe marrëdhënjeve me Rusinë e athershme. Ne mësonim rusisht në shkollë dhe unë isha njohur me me të gjitha veprat të autorëve rusë klasik dhe bashkohorë si Pushkini, Lermontovi, Lev Tolstoj, Sholohov, Turgenev, Gorki, Çehov etj. Gjatë studimeve listës iu shtuan plot emra të tjera. Personazhet e veprave të këtyre autorëve i kisha si udhuj, Ato kishin lënë gjurma të thella në formimin tim. Përveç kësaj organizata e komsomolit po ashtu kishte ndikimin e saj në formimin tim. Unë shkova në Rusi me një frymëzim dhe entusiazëm të madh karakteristika për rininë e kohës time. Realiteti ishte i qetë, rinia shumë miqësore, e gatshme për të mbështetur në çdo drejtim, organizata e komsomolit ekzistonte, organizonte jetën kulturore artistike etj. Krahas mësimeve unë kam patur interes për historinë, kulturën dhe artin. Me shoqen time polake Eva Tumidajska blinim abone mujore për në teatër, vizitonim ekspozita, muze, bibloteka deri te ato më kryesoret, si në Moskë dhe në Sank Peterburg Bolshoj, Tretjakovka, etj. Ato ishin një Universitet tjetër për historinë, kulturën dhe artin . Kam parë ekspozita të artit botëror siç ishte ajo e Galerisë së Drezdenit, të Pikasos etj. Kam qenë në Ermitazhin në muzet dhe Operën dhe baletit të Sank Peterburgut. Në një eskursion në muzen Arhangelskoe jashtë Moskës u takuam dhe me Skenderin. Pastaj të dy bashkë nuk lamë teatër dhe muze pa shkelur. Kam qenë në Jasnaja Poljana, në shtëpinë muze të Tolstoit, ku është dhe varri i thjeshtë të tij. Kudo takoheshe njerëz të kulturuar dhe të lexuar shumë. Një herë kam qenë për 8 marsin në shtëpin e një shoqe të grupit. I ati i saj ishte gjeneral. E gjetëm me përparëse, kishte shtruar tavolinën për ne, vajzave dhe gruas së tij dhe na shërbente i buzëqeshur dhe plot respekt. Barazia dhe respekti në familje ishin të dukshme. Pyetjes tuaj sa i përket tipareve njerëzore them se unë isha dhe mbeta e sinqert , e besueshme dhe shumë dashamirëse. Dola e sigurt , optimiste dhe e vendosur të jetoj dhe punoj në të mirën e njeriut.

A.D.: Nga '58 kur u zhvendosët në Shqipëri, deri në '90, e vizituat ndonjëherë vendin tuaj? Familjarët

në Bullgari, si e shihnin zhvendosjen tuaj në Shqipëri?

J.S.: Në 3 vitet e para shkoja çdo vit për vizitë të prinderit në Bullgari. Madje në 1959 linda dhe djalin në Bullgari. Im shoq shkoi në Moskë për mrojtjen e diplomës pas vënjen në skenë të baletit " Zhurale" të parin balet shfaqe vënë në skenë nga një baletmaestër shqiptar. Siç thash më lartë, në vitin 1961 ishte hera e fundit që kalova pushime në vendin tim. Pastaj shkova pas 12 vjetësh. Shkova me vajzën e 3 vjeçe. Djali që kishte lindur në Bullgari nuk e lejuan. Ai u mërzit shumë. Kështu që gjatë 28 viteve shkova gjithësej 3 herë. Nuk shkova dot për vdekjen e babit, Nuk më dhanë vizë megjithë paraqitjen e telegramit Nuk e besuan. Madje thanë se është gënjeshtër. I kam lënduar shumë prindërit, kjo gjë më ka ndjekur gjithë jetën, por në letrat e tyre, që i mbaj akoma nuk do gjesh asnjë fjalë se sa vuajnë, apo qajnë, nuk kanë dashur kurrë të më lëndojnë, vetëm fjalë dashurie, këshilla dhe shumë kurajo e optimizëm. Ata erdhën vetëm një herë në Shqipëri, dhe ikën me fjalët: tani qe pamë me sytë tanë ku jeton, po ikim të qetë.

A.D.: Po mirë, ndonëse jeni 90 vjeç sot, si ka mundësi që vazhdoni të përktheni, duke ripunuar e risjellë për lexuesin tash së voni "Roman Natyral" të Gospodinovit? Çfarë do të thotë për ju puna, të punuarit?

J.S.: Në jetë të mban dashuria, kureshtje dhe puna! Në qofte se zgjohesh dhe nuk di se si do ta kalosh ditën, fillon dhe i zvarrit orët çfarë kuptim ka se je gjallë. Edhe pse në moshë do të punosh, aq më tepër kur mendjen e ke akoma, duar dhe sy dhe mbi të gjitha ke dashurinë e fëmijeve. U gëzova shumë me ribotimin e "Romanit natyral" i Gospodinovit. Ishte si një terapi shumë efikase për mua. Mbajtje e lidhjeve, mosshkëputja nga e përditëshmja, nga informacioni për ngjarjet ne vend dhe në botë, është si të mos lëshosh fijet që të mbajnë në jetë. Dritare ka shume. Telefoni, televizori, interneti. Me t'u zgjuar hap dritaren, hynë drita, ajri i freskët, marr frymë thellë, hedh sytë jashtë, shikoj qiellin, dëgjoj zëra, zëra fëmijesh, njerëz, makina. E gjithë kjo më jep një shtytje për

A.D.: Përkthyesit përherë lidhin dy gjuhë, dy kultura, dy realitete... E aq më tepër rasti juaj, një njeri me jetën, fatin dhe historinë e ndarë mes këtyre dy gjuhëve, kulturave e realiteteve: shqipes dhe bullgarishtes. Ka qenë përkthimi një mënyrë për ruajtjen e identitetit kombëtar tek ju?

J.S.: Identitetitetin tim kombëtar e kam ruajtur në saj të gjuhës amtare. Në familje flisja me fëmijet, lexonim përralla dhe këndonim kënga bullgare. Kështu arrita ta mbaj gjallë dhe t'ua përcjellë këtë frymë edhe atyre. Unë punoja në bibliotekë. Atje mësova mirë gjuhën shqipe. Lexova shumë autorë te njohur shqiptarë: Kol Jakova, Jakov Dzodze, Migjeni, Fatos Arapi, njoha gjuhëtarët e famshëm shqipetar Aleksandër Xhuvani, Mahir Domi, Eqrem Çabej, Skënder Luarasi etj. dhe gjuha shqipe u bë shumë e dashur për mua. Përkthimi dhe është pasioni im, më ka mbajtur dhe më mban në jetë. Nëpërmjet përkthimeve unë kam dhënë kontributin tim modest për urën që lidhë dy kulturat tona. Jam e lumtur dhe ndiej një sodisfakcion të madh se këtë rrugë ka përqafuar dhe e vazhdon me dinjitet vajza ime, përkthyesja e gjyhës bullgare Milena Selimi.

A.D.: Dhe, në fund, sot një tjetër përkthyese shumë e mirë nga bullgarishtja është bija juaj, Milena. Sa e ka ndikuar prania juaj këtë? Dhe, si gjatë formimit të saj, ashtu edhe punës, keni qenë në rolin e mbikqyrëses dashamirëse apo kritikes gjakftohtë?

J.S.: Milena është thesari im. Mësoj gjuhën e nënës që e vogël, me këngët dhe vjershat e para, pastaj me abetaren, filloi të shkruante letra gjushes dhe diplomën në Universitet e mbrojti me temën e Poezisë bullgare. Filloj punë si gazetare në Radio, në styp dhe revista. Përkthimet e para lidhen pikërisht me urën midis vëndeve ballkanike nëpërmjet letërsisë. Përktheu pjesë nga vepra dhe tregime shkrimtarësh ballkanik nga gjuha bullgare. Mua më pëlqeu shumë se ajo i hyri kësaj pune me shumë interes dhe seriozitet. Patjetër se isha e gatshmë për të ndihmuar, përveç tëtjerësh isha si një fjalor i gjuhës bullgare, që s' ishte e nevojshme ta shvletosh dhe të kërkosh një fjalë, idiomë apo shprehje. Milena është përfekte. Ajo është shumë kërkuese dhe nuk lodhet pa gjetur si thuhet në shqip emri qoftë edhe një luleje. Por kritikat dhe vërejtjet e mia janë. Përkthyesi e do gjyhën. Milena do edhe gjyhën e Atdheut edhe të Mëmëdheut, siç thotë vetë.

Kasëm Trebeshina ka nevojë për të patur marrëdhënie normale me lexuesin, larg demonëve që ia bënë jetën skëterrë.

LETRA QË RRËZON ALBINË E NJË DISIDENCE TË STIMULUAR

Nga Fatbardh Amursi



Vizatim nga Ina Lajthia

Këto ditë në media është botuar një letër e Kasëm Trebeshinës dërguar ish kryministrit komunist të kohës Mehmet Shehu, e cila, për habi nuk përmendet as në librin monografik "Trebeshina një jetë para gjyqit" të Nuri Dragojt, si një botim serjoz, ndoshta më i ploti dhe më dashamirësi ndaj shkrimtarit, që bubulliu në diktaturë, por u goditur nga rrufeja vdekjeprurëse, sikundër ndaj një ushtaraku tjetër,Trifon Xhagjika. Letra merr rendësi, si për kohën kur është shkruar, kujto masakrën ndaj liberalëve dhe njeriut të cilin ai ka zgjedhur t`i drejtohet, kryeministrit Shehu, i cili u kishte dhënë ultimatum shkrimtarëve dhe artistëve, që heroin pozitiv ta pasqyronin pa të meta, kur atij pas vetëvrasjes s`do i linin gjë pa thënë. (Fiqerete Shehu dhe nëna e Kasëmit ishin vajza xhaxhallarësh, ndërsa Zydija, e shoqja e tij vajza e motrës së Bilbil Klosit, nga dhe rrjedh Ardian Klosi, i njohur si vazhdues i pakënaqësisë së Trebeshinës ndaj Kadaresë. I vëllai, Zylyftari qendroi në pozita të larta në nomenklaturën e kuqe.)

Kush ka lexuar librin e Nuri Dragojt, nuk mund të mos i kenë bërë përshtypje raportet e Kasëm Trebeshinës, i njohur si "qeveri më vete" me Enver Hoxhën, Mehmet Shehun dhe me kolegët e tij shkrimtarë, sikurse do i përmend shpejt e shpejt, si freskim të kujtesës, jo pa qëllim, ngaqë janë me efekte prapavepruese. Mehmet Shehu e fton në zyra ku kish dhe herarkë të tjerë dhe në prani të tyre i thotë: "Vendi yt është këtu midis nesh. Ty të kanë zhveshur kot në kohën e Koçi Xoxes. Unë mendoj të vishesh prapë ushtarak. Të premtoj se do të krijoj kushte të zhvillohesh edhe si talent." Si shenjë rehabilitimi i afron gradën e majorit. Por, ai gradat i preferonte në letërsi. "Unë jam poet dhe nuk bëj për ushtarak." Enver Hoxha, në një vizitë tek i vëllai i Kasëmit, që nuk u i shkeli në shtëpi sa ishte gjallë, i drejtohet hallës së Kasëmit: "Më duket se je zemëruar për nipin tënd, për Kasëmin, por do ta lirojmë. Mbase është nxituar në të folur, pasi nuk besoj të ketë gjë me Partinë...Edhe ai ka qenë luftëtar." (Nëse Kasëmi do ishte autor i Promemories, ky gjest i Enver Hoxhës, duhet të shënonte një kulm të tolerancës së një tirani.) "Në një bisedë me Dhimitër Shuteriqin në Aeroportin e Rinasit, Enver Hoxha është shprehur se "Kasëm Trebeshina është njeriu më i talentuar që kemi sot."-i thotë Kasëmi autorit të monografisë, Nuri Dragojt. Për botimin e një librit të tij ka udhëzim nga lart. "Interesohet vetë shoqja Nexhmije Hoxha", i thonë. Përplasjen më të madhe e ka me byroistin Manush Myftiun, i caktuar për dënim-internimet:

Manush Myftiu: "Tani për tani nuk do të botojmë, por pas 20-30 vitesh."

Kasëmi-A duhen veprat e mia të realizmit socialist, apo t`i djeg?

Manush Myftiu-Mund t`i djegësh kur të dojë qejfi." Veprat, që Trebeshina i quan "të realizmit socialist", po digjeshin për shkak të autorit, i cili donte të dilte e vetja në çdo gjë.

Përkundër Kadaresë, raportet me Driteron dallohen për një vlerësim të ndërsjelltë. "E kam vlerësuar Driteroin si shkrimtarin më të mirë të realizmit socialist." Domethënë, mund të jesh shkrimtar i mirë dhe me realizëm socialist?! Nuk i paska fajet metoda, por autori, nëse s`ia del dot. "Ai e kishte pritur mirë time shoqe, Zydien, që kërkonte një dokument për vjetërsinë time në punë dhe u kishte bërtitur zyrtarëve burokrat që nuk e jepnin shkresën dhe kishte urdhëruar të lëshohej me porosi të tij. Kjo tregon një karakter të fortë të këtij burri." Driteroi nga ana e tij shprehet: "Me Kasëmin jam takuar vetëm njëherë...Është nga të paktët njerëz, që i ka thënë gjërat ashtu siç i ka menduar. Është shkrimtar i mirë dhe shumë shkrime i kanë mbetur pa botuar. Kasëmi e thoshte me trimëri çdo gjë." I mirë njëri dhe i mirë tjetëri.

Driteroi, sikurse shkruhet në librin e Nuri Dragojt, i kish kërkuar një takim Kasëmit pikërisht në atë vit, kur ai i shkruan letrën kryeministrit Shehu, por Kasëmi e refuzon takimin. Ndërkohë poeti dhe përkthyesi Jorgo Bllaci, i persekutuar, dëshmon në hetuesi: "Kur u dënua Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja në Plenimun IV, Kasëmi tha se priste një kthesë. "Përderisa nuk hiqet dorë nga Ismail Kadareja, nuk ka për t`u hedhur asnjë hap serjoz në drejtim të letërsisë." Ndërsa Nuri Dragoj nga goja e Trebeshinës, dëshmon: "Llazar Siliqi erdhi bashkë me Ismail Kadarenë. Nuk mund të kisha asnjë lloji dyshimi pse ata erdhën së bashku. Me Ismailin kisha marrëdhënie shumë të mira shoqërore dhe ishte një e drejta e tij e ligjshme të dilte dhe kundër librit tim...Ismaili rrinte pranë Llazarit dhe nuk dinte si ta ngushëllonte." Referuar rastit, kur dikutohej në Lidhje një dorëshkrim i Kasëmit, në vitin 1953. I bie që, Kadare, të ketë qenë 17 vjeç, një adolishent, gjimnazist?! Kaq i rëndësishëm në mesin e burrave?! I pyetur në sallën e Akademisë së Arteve për raportet me Kadarenë, ai shprehet: "Enver Hoxha kujton se e shkruan ai historinë, dhe po ta shkruajë ai, ka vdekur ajo për më tej. Nuk e di ai që ka të tjerë që e shkruajnë historinë. Dhe kështu shpërndante bileta gratis për në Panteonin shqiptar. Dhe njerëzit vraponin pas tij për ato bileta të Panteonit, që të hynin aty gratis... Pseudointelektualët duhet të menjanohen dhe të hidhen në anë të rrugës që të mos na pengojnë!" Kjo duhet shënuar, si thirrja e parë publike për rrëzimin e Kadaresë, pas shtatores së Enver Hoxhës dhe, ndër të parët, që iu përgjigj "thirrjes së gjakut" ishte Ardian Klosi në një shkrim denigrues ndaj Ismail Kadaresë i botuar në librin "Refleksione". "Duket se aty, në Paris, ishte lidhur ai gomari që më vonë do të bënte bajga të pafurmuara.", do aludojë Kasëmi për Kadarenë, pas një takimi me Zihni Sakon, i cili i kishte folur për hapje ndaj letërsisë franceze.

I gjithë ky parashtrim na ndihmon, për të kuptuar edhe më shumë midis rreshtave në letrën drejtuar kryeministrit komunist, nisur me një ankesë personale. (Pas `90-tës po ndodhte ajo që Kadare e kishte përshkruar shumë vite më para në novelën e tij "Fundi i perëndive të stepës", me "vjelljen e subjekteve", që mund ta ilustronim dhe me një pasazh nga romani "Manastiri i Parmës" i Stendalit: "Vetë ata rojtarë dhe mbikqyrës të burgjeve që gjatë revolucionit ishin revolucionarët më të ndezur, nuk lodhen kurrë të pohojnë në kohën e Luigjit XVIII se sa e kanë adhuruar fshehtazi mbretëreshën e tyre të mëshirshme e të virtytshme." Madje dhe të tillë, sikurse i përshkruan dhe Kasëm Trebeshina: "Gjysma e ushqimit të burgosurëve vidhej nga komanda e burgut për të ushqyer spiunët e burgjeve...Nuk e çaj kokën për ata të burgosur që jepnin në burg shfaqje për të argëtuar komunistët." Ka prej tyre, që fshihen pas "disidencës" se imptovizuar, si ushtari pas takut, si e si të sulmojnë të tjerët, pasi kanë ndryshuar llogoret.

Në vitin 1975, nisur nga një hall personal, i largimit si përkthyes dhe i punësuar si redaktor teknik në shtëpinë botuese "Naim Frashëri", ngaqë vetja i qe dukur si bedel i Petro Zhejit, Kasëmi e kundërshton qarkullimin, ku i nxehur do i thotë shefes së redaksisë: po qe për qarkullim i pari që duhet të qarkullojë është vetë Enver Hoxha që ka vite që s`e lëshon kolltukun dhe, më pas i dërgon një letër kryeministrit të kohës, Mehmet Shehu, krejt zhgënjyese ndaj imazhit të një disidenti të pretenduar. (Në të njëjtën kohë Kadare dërgohet për riedukim në fshat për "Pashallarët e kuq".) Kjo letër duhej të shkaktonte bujë në mjedisin letrar, por gjithkush merret me idile facebooku. Pavarësisht se Kasëm Trebeshina i rrëfehet kryeministrit komunist, letra ka aq shumë sinqeritet, e hap zemrën para partisë, aq sa ty të duket sikur shkrimtari po rrëfehet në dhomën e fshehtë të At Zef Pllumit, të cilit i ka thënë, sikurse ai e rrëfen në librin e tij: "Enver Hoxha bëri Kadarenë dhe Kadareja bëri Enver Hoxhën."

Trebeshina nis e rrëfehet: "Më 1953 kam dërguar në udhëheqje një relacion më dhjetëra faqe ku analizoja shumë çështje të letërsisë dhe të shoqërisë. Duke qenë se kanë kaluar njëzet e dy vjetë dhe rasti po më paraqitet, po i kujtoj edhe njëherë disa nga gjërat parimore që shtroja."- Pra, rasti ia solli në shteg, të shkarkojë batarenë e pakënaqësive ndaj Kadaresë tek kryeministri, i cili e ndaloi të birin të takohej me shkrimtarin i dyshuar si "agjent i Perëndimit". Ishte mbushur dhe afati prej 20 vitesh për ndalim botimit, sikurse iu deklarua byroisti Manush Myftiu. I lë hallet personale dhe fokusohet tek çështjet parimore, konform gjuhës partiake. Por, kush ishin shkelësit e parimeve? Anakronikave të mundur të viteve `60-të, me gjasa, u erdhi koha për revansh. Duke besuar se partia me dërmën që u dha liberalëve, kishte ndryshuar kurs dhe ishte rasti i volitshëm për të pakënaqurin Trebeshina, të lante hesapet me Ismail Kadarenë, se Driteroi bëhet kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, ndërsa Fatos Arapi ishte në "gjendje lufte" me Ismailin. Në letër, si "plangprishës" figuron vetëm emri i Ismail Kadaresë. Ja dhe rënditja e problematikave që ai parashtron në sinkron me vijën e partisë kundër ndikimeve të huaja dhe izmaxhinjëve, ku më pas do shpallej si shprehësi i surealizmit.

1. "Në krye të Lidhjes së Shkrimtarëve në atë kohë (vitet `60) erdhi Dh. S. Shuteriqi. Rruga nëpër të cilën erdhi dihet, por unë po e kujtoj: në komplot më Mark Ndojën dhe Gjovalin Lukën minuan Shefqet Musarain dhe i zunë vendin." Në kohën kur partia godiste grupet armiqësore, Trebeshina po denoncon një komplot në Lidhjen e Shkrimtarëve?! Viktimë e këtij puçi autori i "Epopesë së Ballit Kombëtar", Shefqet Musaraj, shkrimtar tipik i realizmit socialist. "Dh. S. Shuteriqi u kishte premtuar shokëve të tij se, kur të vinte në fuqi, do të shtronte çështjen e Fishtës. Kam dëgjuar më veshët e mi kur Mark Ndoja i thoshte "tradhtar" dhe ika nga zyra se nuk doja t'i dëgjoja." (S`e paska dashur Fishtën as Kasëmi?!) Ti vetvetiu pyet: a po i shet shokët tek kryeministri si fishtianë? A po kontribon në zbulimin e armiqëve të vërtetë, duke kërkur rehabilitimin e vetes si shkrimtar i një tipi me Shefqet Musaranë? I bindur se për shkrimtarin Kadare kishte rënë ora e ligë, Plenumi IV kishte bërë gjëmën në radhët e liberalëve, nga pozita e një arkaiku të nëpërkëmbur, Trebeshina, kërkon rishikimin, revizionimin e viteve 60, kur të rinjtë me mbështetjen e Enver Hoxhës marrin hov. Ka kujtuar se udhëheqësi më në fund po i thërriste mendjes dhe kish rast të njihte "ushtarët e vjetër" të revolucionit, ku Kasemi fuste veten. Për të shkuar tek Sekretari i Parë, duhej të merrte më parë mbështetjen e kryeministrit, që, me sa duket ia dinte mendjen.

2. "Në vitin 1960 në Lidhjen e Shkrimtarëve u krijua një atmosferë e ndyrë duke u ndarë në të rinj dhe të vjetër. Miqve më të afërt ua thashë hapur se kjo nuk ishte e drejtë. Në emër të një modernizmi prej "snobësh" vogëlushët tanë të modernizmit po sulmonin traditën e letërsisë shqipe. Në emër të modernizmit edhe sot e kësaj dite, në bisedat intime, vogëlushët e modernizmit e quajnë "arkaike" çdo gjë të shëndoshë të letërsisë shqipe më frymë të shëndoshë popullore. Çdo gjë e shkruar mirë për ta është konservatore." Skema është e qartë, liberalët, "vogëlushët e modernizmit" quajnë arkaike, konservatore, letërsinë e shëndetshme me frymë popullore e mbështetur kjo në traditë dhe folklor, sipas parimeve të metodës së realizmit socialist. Duke qenë në dijeni të rasteve intime të "snobëve", mos po

(Vijon në faqen 6)

(Vijon nga faqja 5)

vetë-afrohet për shërbime ekstra?! Ti pret emrat e grupazhit "të vogëlueshëve të modernismit", por na del vetëm një, armiku i gjithë jetës së tij: Ismail Kadare. "Dhe pikërisht në vitin 1961 kemi manifestin e shkollës moderniste (Manifestin e dytë, se të parin e kishte bërë që në vitet tridhjetë Dh. S. Shuteriqi në librin "Kangë"), tani "Shekulli im" i I. Kadaresë." I bie të jetë një manifest me vargje dhe ky i dyti i shpalosur në vëllimin me poezi "Shekulli im" të Kadaresë. Manifesti i Shuteriqit i viteve 30 s`kish të bënte me realizmin socialist, kështu që dhe ky i Kadaresë, si vazhdim i të parit, i bie të jetë allafrenga. Shkrimtari që pranoi në fund të jetës shtetësinë turke, dihet dhe "pakënaqësia islamike" ndaj Kadaresë, si arkaik e konservator e godet poshtë brezit nga pozita allaturka. Dhe kjo akuzë bëhet, kur në Shqipëri valonte huri kundër "izmave të huaja". Po tek tradita që fuste dhe në çfarë metode ata shkruanin? A e nderon kjo betejë në emër të parimeve të realizmit socialist një disident?

Nga pozita e njeriut që i kanë rrëmbyer trofenë, Trebeshina denoncon dhe një tjetër prapaskenë të Shuteriqit, i cili, për të qenë ai shkrimtar i romanit të parë të realizmit socialist, mënjanon kolegët, konkretisht: Sterjo Spassen dhe Kasëm Trebeshinën. "Me sa di unë, data nuk është shumë e sigurt, Sterjo Spasseja e ka shkruar romanin e tij "Ata nuk ishin vetëm" shumë kohë përpara se të botonte Dh. S. Shuteriqi romanin e tij "Çlirimtarët". Spasseja ndoshta nuk ka qenë përpjekur ta botonte, por me mua puna qëndron ndryshe. Romanin tim "Të rinj të kohës sonë" e kam shkruar në vitin 1948 dhe u përpoqa ta botoj… Në vitin 1951 kisha gati tetëqind faqe (dy vëllimet e para të "Këngës Shqiptare") dhe isha gati t'i botoja!… Por duhej të prisnim që të shkruante patjetër Dh. S. Shuteriqi "Çlirimtarët" në vitin 1952 që të hapej rruga e romanit tonë të ri… Në këtë rast titulli i shkrimtarit u dha si "ofiq".- denoncon Kasemi "ofiqin" e grabitur me luftë bërrylash. Nëse nuk do të ndodhte ky dobiçllëk, si autor të parë të romanit të realizmit socialist do të kishim Kasëm Trebeshinën, disidentin e pretenduar kundër realizmit socialist?! (Romani "Ata nuk ishin vetem" i Sterjo Spasses është botuar në vitin 1952.) Pohuar me gojën e tij bie e gjithë alibia e shkrimtarit disident, që u përndoq nga të vetët, se s`donte ta shihte me sy realizmin socialist, kur zotëria na paska pretenduar të ishte korife i saj?!

Në fund të letrës Trebeshina çimentos konkluzionin, duke u ankuar se "shkrimtarët filluan të ngrihen në mënyrë burokratike dhe kulmi arriti në të ashtuquajturit "vite gjashtëdhjetë", me "vogëlushët e modernizmit", duke cituar vargje vetëm nga Kadare. "Favoritizmi" dhe sistemi "preferencial" u bënë jetë. Ky nuk mund të kritikohet, ai nuk mund të kritikohet!… Naim Frashëri është arkaik… Dhe kështu për të gjithë! Vetëm kur "aeroplanët ulen nëpër pistat e pizhamave" (varg i Kadaresë), vetëm kur figura dhe kompozicioni ngatërrohen, (siç i ngatërron Kadare) vetëm kur imiton Xhon Dos Pasosin dhe ndonjë tjetër ka letërsi. (si Kadare Hemiguejn) Jo shokë! Ka letërsi, dhe letërsi të madhe bile, kur zhvillon traditat më të mira të klasikëve! Por në letërsinë shqipe triumfoi snobizmi dhe në kushte të tilla, nuk është ndarë përfundimisht shapi nga sheqeri, nuk hedh asnjë hap në drejtim të letërsisë shqipe. Mos kritikoni se na preket poeti!" Në kohën kur shkrimtarët dhe poetët po sulmoheshin, internoheshin, burgoseshin e pushkatoheshin, ky bën thirrje se akoma s`keni qëlluar në shenjë, nuk kemi goditur kokën e tyre?!

"Vogëlushët e modernizmit" i përmend në shumës, ndërsa poeti që s`duhet prekut në njëjës?! Realisht me "Shekulli im" Kadare hëngri kopaçe sa u shqep! Trebeshina, thua se ishte Solzhenicini, i shkruan Enver Hoxhës t`i jepte leje të shkonte në Zvicër, që dhe sot, heqin dreqin për të marr shtetësinë. Kjo letër bëhet shkak të arrestohet. Ja dialogu në hetuesi, marr nga libri i Nuri Dragojt:

Hetuesi: Ç`mendon të bëje në Zvicër?

Kasëmi:Unë do të isha poet punist, art për art, post kullës së fildisht. Do të merresha me letërsi dhe isha i sigurt se do të bëja karierë letrare. Shoqëria kishte të drejtë të më dënonte, jo të më ofendonte." Pra, do të bënte punët e "vogëlueshëve të modernizmit"?! Sa përkojnë fjalët e Razi Brahimit thënë kolegut të tij Adriatik Kallulli me të "disidentit" Trebeshina për mos prekje të poetit: "Dëgjo, Ismaili është monument kulture që mbrohet nga shteti dhe kritika ndaj tij është shumë e vështirë, ndaj tregohu shumë i kujdesshëm". Nëse kritikat këta i bënin nga pozita e partisë, parimore, sikurse pretendon dhe Kasemi, pse duhej të ishin të kujdesshëm? "Më kujtohet, kemi qenë përpara Pallatit të Kulturës. U mbështeta pas kolonave dhe i thashë hajde dhe më rrëzo tani. "Mundesh? Kam kolonën pas shpine".) O zot! Shyqyr që shpëtuam prej këtyre, që s`i merr vesh kurrë se me kë janë dhe në emër të kujt të luftojnë?!

Trebeshina vazhdon: "Përgjersa manifesti i modernizmit, që ka fyer të gjithë letërsinë shqipe, nuk mund të kritikohen, për mua nuk ka vënd në letërsi. Patenta e gjenialitetit nuk mund të shpërndahet në këtë mënyrë. Fundja, unë kështu mendoj: qofsha i gabuar. E di që fola shumë rëndë, por fola si një ushtar i vjetër dhe i fola një ushtari akoma më të vjetër, që nuk shkoi më kot gjer në Spanjë!"-e mbyll ai letrën. (Nënshkrimi: Kasëm Trebeshina Tiranë, 19.6.1975. Kjo ishte koha për disidencë, ndërsa Trebëshina me armët e ndryshkura të arkaizmit i bashkohet partisë në luftë kundër "vogëlushëve të modernizmit", duke u ankuar se i kishin vjedhur kurorën për të qenë ai autori i parë i romanit të realizmit socialist dhe, indirekt, kërkonte patentën e gjenialitetit, ndërsa ata i dhanë "kartelën" e të sëmurit psiqik?! Ai ankohet: më mirë t`ma dënonin se sa t`ma fyenin. Por, a mund të jesh disident me një "kartelë" të tillë, ku ti mund të flasësh dhe fjalët s`të merren për bazë?)

Romani i tij "Stinë e stinëve" është në përputhje të plotë me letërsinë e ashtuquajtur të realizmit socialist. Nga ky roman më ka mbetur në mendje një batutë: "Komisarët i morën gratë e bukura, ngaqë ishin të gojës." Thënë më bukur në kujtimet e tij: "Kongresi i Helmsit ishte pazari ku u shitën dhe u blenë pa pare dhëndurrët dhe nuset. Dhe repartet partizane u kthyen në zyra ku regjistroheshin martesat. Komunistët e gradave të larta morën vajzat më të bukura dhe ato që mbetën u ndanë midis atyre që kishin më pak rëndësi. Asnjë vajzë nuk u martua me ndonjë partizan të thjeshtë." Marr nga libri i Nuri Dragojt "Trebeshina, një jetë para gjyqit", i cili jep edhe këtë detaj: "Ai, vetë duke qenë një nga kuadrot më me përgjegjësi, mund të zgjidhte vajzën më të bukur, por e refuzoi me përbuzje këtë dhuratë të komunistëve shqiptar, që po e fusnin familjen në një krizë me pasoja historike. Kur i erdhi rasti, mori për nuse një vajzë të mrekullueshme që ia propozoi nëna e tij, e cila i qendroi në krah dhe në Golgotë." Edhe këtu tradicional. Kur i raportojnë se një kuadro i batalionit kishte lënë gruan e fëmijët dhe se qe martuar me një partizane 16 vjeçare e arreston dhe e mbyll në kishën e Pilurit. Por, lush e vrau Ramize Gjebren pas shpine?!

Kasëm trebeshina nuk ishte kundër realizmit socialist, por kundër Ismail Kadaresë, ngaqë i dukej se i kish rrëmbyer kismetin. Këto vargje të Kadaresë për poetët bimor, do t`i kenë rënduar shumë sedrës së tij të sëmur. Ti Kasëm je mikroborgjez, por unë jam ca më shumë nga ty, do i thotë miku i tij, kryeministri komunist Shehu. Vargje nga poezia e Kadaresë:

"Hapni udhën, poetë të poezisë së deklasuar,

Ju që gatuani fjalë të zgjedhura...

Që vishni kostumin e ri me vija të dielave!...

Hiquni udhëve, poet bimorë!

Hapni udhën fanatikë të artit!...

Një poezi të madhe tani ne po ngremë!"

Arshi Pipa matanë oqeanit në të njëjtën kohë bën një shkrim diabolik për romanin "Kronikë në gur", të cilin botuesi anglez nuk ia pranon si parathënie, ku ndër të tjera bën këtë insinuatë: *"Kronikë në gur", i cili ndjek "Kështjellën", sjell në një pikë të mprehtë rebelizmin jokonformist të autorit dhe akuzon këtë herë në mënyrë të nënkuptueshme partinë komuniste, që nxiti luftën civile dhe e shndërroi luftën kombëtare kundër fashizmit në luftë klasash."* Dhe më poshtë: *"Temën e seksit, tabu kjo për realizmin socialist të ngurtë shqiptar. Seksi shtrihet gjatë gjithë tregimit si një fill i kuq." Pra, roman pa pullë të kuqe?! Në kohën kur Enver Hoxha kishte mprehur shpatën edhe njëherë për situatën, i ofronin në gostinë makabre dhe kokën e shkrimtarit Kadare. Gjuha e Pipës është në sinkron me gjuhën e ekspertëve të artit që prokurorët i përdorën si akt-akuza kundër autorëve që u pushkatuan dhe u burgosën.* Arshi Pipa, pavarësisht se po i jepte shkrimtarit ngjyra "disidence", në fakt po i përgatiste funeralin.

Drugo-mesele, Prof.dr.Milazim Krasniqi, i cili me entuziazmin e një zbuluesi, duke iu referuar shkrimit të Kadaresë "Realizimi socialist-arti i madh i revolucionit" botuar në "Zërin e Popullit" të vitit 1974, e cilëson at*ë* si një platformë teorike-ideologjike të realizmit socialist, duke na habitur, kur kritika e kohës ankohej se Kadare nuk i respektonte parimet e kësaj metode?! Bilal Xhaferri në letrën revolucionare dërguar Enver Hoxhës, i ankohet: *"U ngrita kundër romanit "Dasma", se ai më dukej i gabuar fund e krye në brendinë e tij....Një shkrimtar i mirë revolucionar, nuk duhet të abuzojë me idetë e mëdha të partisë, duke i përdoruar si prestigjiator tezat dhe parrullat e partisë, vetëm sa për të bërë efekt, vetëm sa për të krijuar iluzione te lexuesi... Romanin "Dasma", unë e denoncova si një vepër të shkruar shumë larg metodës së realizmit socialist dhe të rënë nën ndikimin e artit dekadent." Një tablo maskarallëku kundër Ismail Kadaresë, që, për fat të keq, ka në mesin e saj dhe të vuajtur të regjimit. Sa më shumë që të hapen letrat, aq dhe më tepër do dal në pah falsiteti i "statujave prej dylli".* Ja si e konfiguron Trebeshina figurën e krimit, që po i bëhet letërsisë së shëndoshë shqipe, duke iu referuar vargjeve të molepsura të Kadaresë: "Në të është: "dielli që mbërthehet në abazhur", "ajo që nuk duhet ta ngrejë televizorin për të mos dështuar kopilin", "virgjëria nuk kërkohet më", "aeroplanët zbresin në pizhamë", "dashuria bredh nëpër stacionet e trenave"… e tjerë." I bashkëngjisni dosjen e Petraq Kolovicës "Autobiografia e Kadaresë në vargje" për të kuptuar kakofonin i cmirëzinjëve, që fshiheshin pas parimeve dhe bëjnë viktimën, duke i rënë më qafë tjetrit. (Edhe Kasëmi ka shkruar elegji për vdekjen e Stalinit, s`ia përmend kush.)

Kasëm Trebeshina është një dhimbje e madhe, por jo aty ku duan ta bëjnë hero me zor, me stilin e njohur: ulu mal të dali hëna. Pra: ulu Kadare, që të dali Trebeshina. Për më keq një hero të fabrikuar në shërbim të politikës së ditës, duke e glorifikuar me atribute të rreme dhe, duke lënë në heshtje punën e tij kolosale, ende e panjohur për publikun. Pabesi: të glorofikosh autorin



dhe të groposësh veprën. "Varianti se ai ishte një i çmendur u quajt më i pëlqyer për nomenklaturën e lartë komuniste",-shkruan Nuri Dragoj. E paska fshehur për të keqen e vet? Pra, është me "kartelë", mos ia vini veshin. Mjafton "kartela" dhe disidenca bie, kur ka shumë të tjerë, që u është nxirë jetë për një fjalë goje. Ti ke llapur, se kishe atë pusullën që të mbronte. Ardian Klosi, pasi iu turr Kadaresë, do shprehej për Trebeshinën në një kohë, kur mund të thoje ç`të doje: "Kasëm Trebeshina zhvilloi personalitetin pa patur komunikim me lexuesin." Nuk di se si mund të ushtrohet disidenca, kur je pa ndikim tek lexuesi, larg njerëzve?! "Pashallarët e kuq" të Kadaresë iu ndal botimi, pak veta mundën ta lexonin, si pati aq jehonë, thua se e kishin lexuar të gjithë? Sepse njihnin prirjen e shkrimtarit. Një personalitet i zhvilluar në komunukim me lexuesin, që ia përpinte librat me uri të madhe. "Në një kohë kur në letërsinë tonë i thureshin himne komunizmit dhe metodës së realizmit secialist, një shkrimtar i panjohur merr guximin ta vështrojë botën me sytë e viktimëve të këtij komunizmi, si të një burgosuri në psikiatri, duka na dhënë kështu të parën vepër surealiste të letërsisë sonë."-shkruan Ardian Klosi. (E harroi "Përbindëshin" e Kadaresë, të ndaluar nga regjimi i bllokmenëve, si një vepër surealiste?!) Trebeshina vetë është shprehur: "Poetët bashkohorë të botës së jashtme nuk kam patur mundësi t`i njoh. Vonë më ka rënë në dorë ndonjë prej tyre." Si u bë modern pa e njohur modernizmin?

Kasëm Trebeshina ka nevojë për tjetër gjë, sikurse e shpreh dhe shkrimtari Naum Prifiti në rrëfimin e tij: "Midis dramaturgëve që do të shqyrtonin veprat, Dalan Shaplloja më futi dhe mua. Kjo më erdhi papritur, sepse unë nuk isha nga njerëzit e afërt apo të besuar të Lidhjes... E dija se ai vazhdonte të shkruante, edhe pse nuk kishte asnjë shpresë për të botuar, dhe kjo më dukej vërtetë e jashtëzakonshme për rrethanat dhe praktikën tonë, kur ne i shpinim veprat për t`u botuar pa u tharë mirë boja...Njëra prej dramave me titull "Për ata që s`janë më" ishte akuzë e fortë kundër hetuesëve, njerëzve të Sigurimit të zvetnuar moralisht. Duke menduar se drama do të asgjësohej nga Sigurimi, mendova si ta shpëtoja nga hiri...Pas shumë vitesh kur u takuam më falenderoi për dramën e kopjuar se atë kopje nuk e kishte."

80 dramat dhe komeditë e tij do ishin një thesar për teatrin e ri, që po ndërtohet, se tek i "teatri i vjetër" ishte i padëshirueshëm. Një rast dhe për ata që luftuan në emër të mbrojtjes së kujtesës, që dramaturgjia e Trebeshinës të përfshihet në repertoret e teatrove. Kasëm Trebeshina ka nevojë të shpëtohet nga përdorimi politik i tij, nga atribute që ai nuk mundi t`i ushtronte për shumë arsye. Të shpëtohet nga kinse antikomunistët, që të kthejnë në mish për topat e tyre. Nga mediokër, që i përmendin për të thënë se dhe atyre u është ngrënë haku. "Unë jam nga ata që kam folur gjithë jetën me veten time...Edhe tërë jetën kam punuar si qeni... Jam kaq i ngopur sa nuk dua më të merrem me këtë vend."-shprehet shkrimtari që ka nevojë për të gjithë ne, duke dhënë dhe kriterin e vlerësimit: "Ajo që ka rëndësi për një letërsi nuk është vendi ku është shkruar një vepër, por niveli i saj artistik." I lini vuajtjet dhe i shihni shpirtin të derdhur në art. Ky i krisur, nuk ka nevojë për bejleg, ai ka nevojë të dali në dritë, duke pretenduar dhe besuar se: "Unë jam poet i 28 mijë vargjeve dhe ato do t`i pranoni të tëra. Në mos ju të tjerët. Mos tani, pas vdekjes sime. Unë s`rroj një kohë...Tej kohëve nisem." Dëgjoni lutjen e një polici drejtuar së shoqes së tij, Zydijes: "Të lutem mos e lërë vetëm atë njeri aq të pastër!" Kasëm Trebeshina ka nevojë për të patur marrëdhënie normale me lexuesin, larg demonëve që ia bënë jetën skëterr.

Sprovë modeste për të "lexuar" pikturën e Arben Theodhosit

ARTI QË VJEN PREJ FERRIT

Nga Luan Rama

Nuk është krejt pa shkak që sa herë shoh punët e Arben Theodhosit, ndërmend më vjen gjithmonë e pothuaj përmes përfytyrimit në të njejtën trajtë, "Ferri" i Dantes.

Nuk e di në ka ndodhur që të njejtën gjendje ta ketë përjetuar edhe vetë Beni (kështu, Beni e kam njohur që prej ditës së parë këtu e 49 vjet të shkuar, atë verë të vitit 1976 në Kurbnesh, ku ai qe dërguar i internuar familjarisht e unë po familjarisht për të jetuar në atë qytezë minatorësh), por edhe pse nuk e kam pyetur ndonjëherë, jam i bindur se pyetjen që Danteja i bëri mësuesit të vet, Virgjilit; - "ç`është kjo e zeza rrugë?", për të marrë prej tij përgjigjen "- ky është vendi ku do të shohësh mjerimin!" , ia ka bërë me mijëra herë vetes.

Ishte fare i ri, ende pa i kryer studimet në Institutin e Lartë të Arteve ku studionte në degën e pikturës, kur e rrëmbyen për ta futur atje ku ishte "bota tjetër".

Babanë (Koço Theodhosi, ishte ministër i industrisë dhe minierave dhe anëtar i Byrosë Politike), ia vranë.

Por, kaq nuk mjaftoi që të ngopej babëzia e vrasësve.

Duheshin vrarë të gjithë; bashkëshortja e Koços e nëna e Benit, zonja e mirë Mirandë, për të cilën kam shkruar më parë; e bija e tyre dhe motra e Benit, Nina arkitekte e talentuar; dhe i biri, Beni vetë.

Madje, Beni qe i pari në rradhë. Ndaj e rrasën "te e zeza rrugë". Që ëndërra e tij të mos kishte dritë, të mos kishte shpresë.

Përballë rrethi i parë i ferrit.

Askush nuk duhej t'i fliste.

Në punë, punën më të rëndë. Diferencimi klasor, lufta e klasave në plan të parë për armikun e klasës.

Mandej, apeli. Paraqitja tre herë në ditë në vendnumërimin e përditshëm. Një ritual poshtërues, i pandryshueshëm.

Miniera qe një vend pune për të gjithë. Dhe në të punonin qytetarë të zakonshëm. Edhe komunistë e prej tyre edhe të dashuruar me sistemin, të përkëdhelurit e tij.

Pra, në minierë nuk punonte vetëm Beni dhe të ngjashmit me të, në kuptimin e diferencimit klasor.

Por, ndryshimi ishte se Beni nuk zgjodhi.

Atë e zgjodhën, e dënuan dhe e çuan në minierë që ai ta kuptonte se jeta e tij do të ishtë e errët si galeritë ku vërtitej niveleve duke shtyrë vagonët. Dhe për të plotësuar tablonë, edhe pasi dilte nga miniera, horizonti i tij qe prapë një galeri. Një galeri tjetër, po aq e në mos edhe më e errët.

Rrathët e ferrit vinin varg, njëri pas tjetrit.

Por le të kthehemi tek piktura e të "lexojmë" përmes saj, artin e Benit që na vjen prej ferrit.

Piktura e Benit në tërësinë e vet është metafizike.

Pavarësisht teknikave të përdorura apo motivit të zgjedhur për t'u trajtuar, raporti i dritës me hijen, është në thelb kushtëzimi mes dritës si burimi i pashtershëm i energjisë, dhe hijes si dëshmi e ekzistencës së materies që na rrethon. Ky raport përcakton edhe për vetë piktorin ekzistencën e tij në gjirin e natyrës.

Drita dhe hija, si një raport apo marrëdhënie e ndërvarur kontrastesh të pandara mes tyre, përcakton edhe hapësirën tonale dhe koloritin e vetë veprës, e cila edhe pse në shumë punë kushtëzohet prej ferrit ku e mbyllën piktorin, vjen e ripërmasohet në universin e tij krijues, proporcionalisht me universin e gjithësisë ku piktori e gjen veten.

"Destinacioni ishte miniera, një variant i Ferrit, - ka thënë dikur vetë piktori, por rrugëtimi në mes të pyllit gjatë natës së turnit të tretë, ndonjëherë të dhuronte disa kënaqësi që shteti i diktatorëve, i politikanëve dhe i policëve nuk do të arrinte kurrë t'i pikaste e t'i ndalonte - as në të shkuarën, as në të ardhmen! Ishte një mesnatë e rrallë".

Njësoj si raporti i dritës me hijen, na vjen përmes veprës së Ben Theodhosit edhe raporti i të shkuarës me të ardhmen, i të moralshmes me të pamoralshmen, i të ndergjegjshmes me të pandergjegjshmen, i të keqes me të mirën. Kjo e bën veprën e tij universale për nga mesazhi, por edhe unike për nga vlera artistike që mbart dhe kontributet që i jep artit tonë pamor në tërësi.

Ai e ka thënë vetë se "Në një farë mënyre edhe vuajtja është një nga format kryesore të ndriçimit".

Arben Theodhosi ia ka dalë ta dominojë vuajtjen.

Piktori nuk është vetëm një vëzhgues apo soditës i botës ku gjendet, qoftë kjo një galeri e errët miniere apo qielli plot i një mesnate të rrallë.

Ai jeton duke e ndjerë gjithë atë realitet rreth vetes dhe përmes përjetimit artistik na jep me një gjuhe krejt të veçantë peizazhe, portrete, gravura apo në tërësi kompozime ikonike, ku metafizika si koncept filozofik vërehet dallueshëm gjithkund.

Pa pretenduar që të bëj një analizë të detajuar e profesionale të gjithë krijimtarisë së Arben Theodhosit, ç'ka e kam të pamundur pasi nuk është as profesioni im, në tërësinë e vet e brenda kohezionit krejt të dallueshëm, një pjesë e krijimtarisë së tij dhe që për mua përbën fazën e parë të saj, atë që lidhet me përjetimet në kohën e internimit, dëbimit, përgjimit dhe punës në minierë, ajo dominohet nga epirizmi. Kjo cilësi vjen e bëhet me periferike me kalimin e kohës, për t'u veçantuar në fazën e konsolidimit dhe të pjekurisë krijuese si krijimtari më racionale.

Edhe pse jam përpjekur të gjej pikëtakimi me vepra të krijuesve, sidomos të piktorëve të tjerë që janë gjendur në të njejtat kushte si ato të ferrit danteskt ku u detyrua të punojë Beni, (përshembull vepra e Ali Osekut apo Maks Velos etj.), kam vërejtur në fakt qasje krejt të ndryshme.

Kjo e bën veprën e Arben Thodhosit, më shumë se të veçantë, një pasuri të vyer për artin tonë kombëtar në tërësi dhe për artin pamor në veçanti.

Jo prej faktit se është arti që na vjen prej ferrit, po për mesazhin e madh që përcjell, përmes një gjuhe artistike të përkorë në pamje të parë, por me shumë intensitet, dinamikë dhe mjeshtëri.

Beni dhe arti i tij ia dolën ta sfidojnë Cerberus-in. Ia dolën ta sfidojnë dhe të fitojnë.

(Në foto: një nga punët e Benit, pjesë e koleksionit tim privat dhe dedikimi i tij nga pas, dhuruar në Athinë, ku e takova rastësisht në lagjen Plaka, pranë Akropolit, në nëntor 1998).

ROMANI "SAGA E SARAJEVËS" NGA STEFAN ÇAPALIKU

Nga Robert Prennushi

Kur mbarova së lexuemi romanin Saga e Sarajevës të shkrimtarit Stefan Çapaliku, pyetja e parë ishte se çfarë titulli do t'i vente Koleci këtij libri. Kush asht Koleci, mund të thoni ju. Asht një shok që, kur ishim në shkollën e mesme, na thonte me serjozitet se kishte mbarue nji roman, por nuk e botonte vetëm pse nuk dinte me i vue titullin. Si duket kjo gja më asht ngulë gozhdë, pak me shaka, pak përnjimend e thashë me vete pse Çapaliku i ka vue këte titull. Saga-rrëfim, shpesh herë me karakter familjar, më thotë kujtesa e leximi i Sagës së Forsajvet.

Ngaqë shoh se në këte verë të nxehtë shokët shkrimtarë e muzikantë shkruejnë pak për njeni tjetrin, thashë t'i them dy fjalë për këte roman, që më asht dukë nji risi edhe për nga ndertimi. Edhe pse titulli asht i saktë, sot më vjen ta filloj se romani asht vertetë saga a rrëfimi, por i Dy jetëve paralele, jo si ata të Plutarkut, por të nji familje shkodrane që ndahet, çahet dyshë me dhembje, nga shkaqe që vetëm lufta i shkakton. Janë dy linja paralele që zhvillohen në naltësi të ndryshme si në nji fugë, si në nji fugë të vertetë muzikore. Tema asht ajo; pse nji asht trungu familjar, por duke u zhvillue "ma nalt" o "ma poshtë" në kohë, -si shkallë o tonalitet do të thonim në gjuhën muzikore, zhvillohet e merr udhë. Por nga kushtet ku ndodhet secila nga temat, krijohen kontraste që sjellin zhvillim e tension letrar. Vertetë nji fugë sepse linjat marrin ngjyra të ndryshme, prej rrethanave të ndryshme. Ajo poshtë në kohë, që fillon më vitin 1918, ma shumë. Por ju ndoshta nuk e njihni veprën.

Nësa linja sipër, e kohëve tona zgjatë vetëm15 ditë, aq sa rri shkrimtari në Sarajevë, ndërsa linja e dytë zgjatë afro 13 vite, ndaj zhvillohet ma shpejt. Si nji film me xhiro të shpejta. Por kjo nuk ndjehet, sepse linja e dytë, ajo poshtë në kohë, asht e mbushun me shumë ngjarje njerëzore e historike; me jetë konkrete, me perditëshmeninë e nji familje që rritet, gjithnji nën veshtrimin e Nanës dhe mirësisë së familjes hebreje.

xxx

Asht vështirë të gjendet nji qytet tjetër, si Shkodra, që bashkë me rrethinat, të ketë kalue ngjarje kaq 'të veçanta' - (luftë, uri, rrethim, ndërrim uniformash e gjuhë të ndryshme) - nga viti 1911 deri në vitin 1918. Autori nuk tregon histori. Janë ngjarjet e rrethanat e familjeve të gjenduna në ata kushte që e tregojnë këte lamsh historik kaq dramatik. Edhe tregimi e sjellja e personazheve, me kursim, por tipikë, asht pa ndeshje të mëdha. Në fund të fundit: 'Kështu ka qenë shkrue'..'Jemi në dorë të Zotit'.

Jemi në vitin 1918 në Shkodër. Të ndodhesh pa pritë grue e ve me katër fëmijë nën 12 vjeç, në atë përjudhë që buka sigurohej me ar, vetëm me ar. Por edhe ndryshe, mund të ishte nji tragjedi e vertetë.

Por në vepër nuk ka vaj, as trishtim, as zgjidhje të pandershme. Ka vetëm realitet e zgjidhje. Zgjidhje minimale për mbijetësë, por jo trishtim. Asht Nana, përsonifikimi i sakrificës, së bukurës, sepse kishte qellue edhe malësore e bukur, e martueme në nji familje të mirë shkodrane. Por fati e la të vejë.

Kush do të na e tregojë se si e zgjidhë nana bukën e përditëshme, kur as ari nuk hyni ma në punë?

Çapaliku të befason sepse ai ja beson këte rrëfim nji fëmije dhjetë vjeç që ngjan si të ketë qenë dikur i madh (Budizëm anasjelltas?).

Thotë në nji vend shkrimtari: "uni im kishte dalë nga prej meje". E thotë këte, sepse duket se asht vetë ai, që në vitet e Luftës Ballkanike e në teposhten që mori Perandoria Austro Hungare, që tregon me gojën e një fëmije... Sa të pastra, sa të natyrshme e të sakta mendimet e nji fëmije!

Romani (që nuk kam ndërmend t'ju tregoj, sepse vertetë nuk tregohet) fillon me nji ngjarje krejt të zakonshme.

Asht shkrimtari që shkon "me sherbim" në Sarajevë, në kuadër të mardhanieve kulturore. Kjo ndodhë disa vite mbas ngjarjeve të përgjakshme të Sarajevës dhe Serbrenicës. Por këtu ngatrrohen punët. Ai ka marrë. gati për rrëshqit, nji porosi nga babai. "Shiko, bir. Ti e ke pa Librin e shtëpisë (Pemën gjenealogjike me shenimet). Kështu e kështu i ka ndodhë familjes së vëllaut të gjyshit tand. Dijmë se grueja e tij me katër fëmijët ka ikë dhe ka jetue në Sarajevë. Kemi pasë dhe korespondencë, por mbas vitit 1948, mbas prishjes me Titon, kemi pasë frikë me vazhdue korespondencën. Shih se mos gjen kushrijte tonë Cukali se ku ndodhen.

Por ardhja në Sarajevë për të shkrue diçka, o të pakten me marrë ndonjë spunto për ndonji vepër në të ardhmen, shkrimtarit nuk i shkon mbarë. Asht ajo porosia: 'Cukali' që e mundon. Po ku gjehet nji Cukali, kur nuk ka gjendje civile, ku interneti vihet me Pasword në Kafe o në vendin ku ndodhesh. E asht kaq i gjatë dhe i çuditshem ky Pasword, sa ngjan me nji "kod të shifruem nga sherbimet sekrete". Ku gjehet Cukali, atje ku edhe uji i ngrohtë vonon ditë me ardhë. Ku nuk ka termosifonë. Amarcord asht nji kafe që të kujton Përendimin. E mandej, thotë shkrimtari, pse unë duhet të baja rrugën Tiranë Beograd e mandej Beograd Sarajevë. Pse në Bashçarshinë, pazari ma i vjetër i Sarajevës në festa sheh turistë nga bota arabe, ma shumë se europianë. Madje ngjanë se je në ndonji treg arab, por edhe si në Shqipëri. Në fund të fundit Sarajeva asht thuej gati në qendër të Europës! Mendime si këto, si pa qellim, janë penelata që herë komike e herë ironike sillen aty këtu mes ngjarjve e ndodhive të zakonshme.

Po kush janë personazhet e romanit, mund të thoni. Asht autori në të dy historitë paralele, por në kohë të ndryshme, që jep përshtypjet e veta, analizat e shumë rallë tregohet si në çdo roman, ku shpesh tregohet jo në vetë të parë. Këndej edhe personazhet zbulohen dalëngadalë. Asht Esmaja boshnjake, nji linguiste që njeh edhe arabishten e qe asht e bindun se arabishtja duhet të ngjante me shqipen. Ajo asht e ngarkueme për t'i sigurue çdo gja që i nevoitet nji shkrimtari: tavolinë shkrimi, ndejse komode e internet. Por edhe ujë të nxehtë. Të gjitha këto kerkesa nuk gjenden në apartamentin që ka marrë me qera Esmaja për shkrimtarin. Të tjerët janë njerëz të mirë të Sarajevës, si pronarët e apartamentit, nji çift i paqtë, 'i bashëm boshnjak' që nuk mungojnë ta ftojnë shkrimtarin me perzemërsi në Natën e Kadrit, ku do të ishin rreth 20 vetë. (E shkrimtarit i shkon mendja se ndoshta mund ta shfrytëzonte këte rast për të pyet nëse ndokush njeh njeri me mbiemnin Cukali).

Ndoshta ndër përsonazhet ma me randësi asht vetë Ballkani, me kontradiktat e veta. Veç fuqi baroti nuk quhet. Por 'personazh' asht dhe Feja, Besimi. E duket se shkrimtari- personazhi kryesor, - vëren se si lutja e zotni Blumit - hebre, si lutja e Nanës, ashtu edhe ajo e mikut në Iftarin e Natës së Kadrit nuk ndryshojnë pothuej fare: paqë, begati, urime e shpresë. Atë që thotë edhe ai djali 10 vjeç kur sajon lutje, që ta marrë gjumi kur e kishte barkun bosh, o në raste të tjera të vështira.

Atëherë ku u gjetën ata djaj që i ngatërruen kaq keq popujt e Ballkanit?! Siguristh feja jo, as popujt.

Por mendimi-gozhdë- i shkrimtarit mbetë se si të përmbush porosinë e babait. E këtu Çapaliku gjen nji shkak, nji gjetje strukturale vertetë interesante për ndërtimin e fabules së romanit.

Zbret në kohë. Digresion. 'Uni im iku nga uni i vetes sime..' thotë si padashje në nji faqe. Pikrisht ky digresion, ku shkrimtari zë vendin e fëmijës, bahet tashma nji mënyrë për të vazhdue ngjarjen. E asht shumë e natyrshme kjo thurje.



Duket se lexon dy histori të ndryshme, por që lidhen e gërshetohet ngadalë në kohë, sepse kanë dalë nga nji burim, nga familja Cukali.

Janë dy linja paralele që zhvillohen në naltësi të ndryshme si në nji fugë. Po, si në nji fugë të vertetë muzikore. Tema asht ajo e trungut familjar CUKALI, por duke u zhvillue "ma nalt" o "ma poshtë" në kohë, si shkallë o në tonalitet të ndryshëm, do të thonim në gjuhën muzikore. E kjo i jep udhë zhvillimit. Kështu tema: Nana me katër fëimijë që lufton për mbijetesë dhe tema tjetër, por ma në maxhor: shkrimtari, kushrini tyne, por ma i sigurtë në vetvehte, pak i habitun nga kushtet, por i aftë të bajë vrojtime, konkluzione, madje dhe shaka. Të gjitha këto krijojnë kontraste, zhvillim e pritshmenì tek lexuesi.

xxx

Si ikën e pse ikën Cukalët në vitin 1918 nga Shkodra? Cukalët që mungojnë në Librin gjenealogjik të shtëpisë. Babai, pra vëllau i gjyshit të shkrimtarit, u vra nga plagët që mori nga nji kalë i tërbuem dhe assicurazion italian 'Adriatica', i dha 100 napolona ari që mbajtën gjallë Nanën me katër fëmijët. Deri sa, deri sa as edhe ari nuk jepte ma bukë.

(Nana, mbas nji radhe të gjatë shtrin dorën me dhanë napolonin, por nji telefonatë i thotë bukëdhanësit se ari nuk vlen. Duhej bakër! Situatë sureale por që ka ndodhë vertetë në Shkodër).

Tashma në këte linjë, që do ta quejmë linja e Nanës, do të shohim shpesh nji skenë gati në gjithë romanin: Nana që shtërngon dorën e 'tregimtarit' 10 vjeç, por që veshtrimin hetues e ka gjithnji drejt vajzës 12 vjeçare, me dy binjakët që janë gjithnji kapun dorë për dore. Mes Nanës e djalit 'tregimtar' ka nji sekret. Asht nji nagant, nji revolver i vogël, që herë e merr Nana e herë ja dorëzon të birit. Kur e merr Nana, vogëlushi xheloz asht i bindun se Nana që asht kaq e bukur, di të mbrohet po qe nevoja.

Rallë, shumë rallë flet shkrimtari.

...Në Shkodër që nga findi i shekullit XIX e fillimi të shekullit XX kishte nji komunitet te huajsh prej 50/60 personash me veshje e sjellje Përendimore që bënte bujë. ne mjedisin anadollak. Gjysa ishin italianë, të tjerë dalmat ose dhe nga Greqia... Italianët (që kishin arrijtë deri afër Shkumbinit) nuk morën pjesë atë vit në Ballon që organizohej tek Kafja e Franit. Rroku i agjensisë ma të madhe funerale, si zakonisht shkoi me Nanën në ballon e caktueme. (Duhej nji kavaljer mendonte voglushi). Ai pau se Jozefi 'guardian' wachmeister, që kuptohet se e donte praninë e Nanës, i puthi dorën e te tjerët u përkulen edhe para Rrokut pa qafë. Kishte vetem tre gra ne ate 'ballo' (Nana, e shoqja e Franos dhe vajza e saj)...Ushtritë italiane sulmonin austriaket drejt Fierit e Beratit... Nana kercente vals e tango. Tek Frano, kercente me të huej ashiqare… Jozefi mori nanën e filluan të kërcenin në shesh. Askush nuk i ndoqi. Kur mbaroi Jozefi e përcolli nanën der tek vendi, 'dhe unë ju hodha në prehën të saj tue e lutë pa fjalë që të mos e bante ma këte punë. edhe pse e bante vetëm për ne…'

Fundi i Perandorisë po vinte. Nji shkrim "Viva Savoia" që u shfaq dikund në nji mur të Shkodrës e friksoi Jozefin...Duhet të ikim sa ma parë...

xxx

Tregon djali i vogël.

Do të niseshin në veri me autokolonën në tërheqjen, në kamjonçinin e austriakut Jozef, të cilin ai nuk mund ta shihte me sy, po nana i besonte se do t'i çonte në nji qytet të qetë në Austrinë e Jugut. Mandej kishte edhe nagatin!

'Dolëm nga lagja katolike në lindje e kaluem Rrëmajt nga e majta. Printe nana me valixhen e madhe ne dorë. Dimni po afronte. Ishim pesë. Nana, unë, dy binjaket e motra. Secili prej nesh nji torbë, ndërresa e pak bukë'.

Plasje. Ura e Kirit ishte hedhe ne erë… Ecim në errësinë e ma në fund shihet nji dritë që tundej. Ishte kandili ne dorën e Jozefit që na futi nën mushamanë e nji kamjonçini. Ishin 5 të tjerë, kuarteti i harqeve që luejti në Ballo e kontrabasi, që Tomasi nuk pushonte t'ja spjegonte randësinë. U vumë në autokolonë. E harruem se dora mund të lëvizej, trupi jo se jo. Dhjetë vetë në nji kamionçin. Si sardelat.

Vetëm nji Nanë e di se në çfarë prove po vente jetën e fëmijëve të vet. Nji rrugë kaq e gjatë që do të bahej bashkë me autokolonën, pra ndal e nisu, që vetëm me e mendue të dhemb kryet. E me gjithë këte kjo situatë kalohet pa i ngarkue emocionalisht fëmijët. As vrasja nga nji minë e oficerit austriak nuk i randohet atyne. Madje

dhe nji ethe shqetesuese e njenit prej binjakëve, kalohet lehtë, gati me gaz. Nji ushtar mendon se këtu ethja ulet tue hapë nji kuti të madhe mishi... Sa kohë kishin fëmijët pa hangër ashtu...

Ky lehtësim realizohet edhe me atë ndërrim kohe, sepse kthehemi në linjen e autorit të ditëve tona, në Iftarin e Natës së Kadrit. Në fakt shkrimtari ka si gozhdë në kokë porosinë e babait: 'Shih e mos gjen ç'asht ba me ata kushrijt tanë që u detyruen të ikin'.

xxx

Edhe sa ka topi/edhe njizet dekika/Dalin burrat prej xhamijet/Me shami me pika. Nji lutje nga Hajdini, i zoti i apartamentit e mandej çorba, samuna, mish viçi, jahni, pilaf me djathë, kos me u pre me thikë dhe në fund bakllavaja e pakrahasueshme me çdo gja që kishte hanger në jetën e vet, thotë autori me emnin Lekë, pra shqiptar dhe kristian...Hana, grueja e tij, 'e bëshme e që duhet të ketë qenë sevdalie', shton me humor, si gjithnji tregimtari). - pyeti të pranishmit për familjen Cukali. Vetëm nji profesor me sa duket tha diçka që i kujtoi dramen 'Rinoceronti' të Joneskut . 'Të vdekurit janë bërë më shumë se të gjallët'. Kërkoni në agjencinë funerale. Katolikë kane mbetë pak, tha dikush.

E mandej prap batuta: "besoj se isha njeriu i vetëm në botë që nisej me kaq gëzim drejt varrezave". Asht dita që gjen vendin se në cilën parcelë ishte vorrosë nji farë Cukali. Bare , K, 11-14-28. K do të thonte katolikë. Madje bani edhe nji foto atje dhe e nxori në fb.

Shkrimtari asht kurjoz për historinë e Sarajevës. Por tregon vetëm ata aspekte që janë të veçanta, kurjoze. Ai tregon se Hasref Beu që ndërtoi Kullen e sahatit, medrezen, bibliotekën, hamamin, bezistanin, ishte varrosë ne harem. Ai vëren në atë qytet njerëz të ngeshem si në Shkodër. Ndoshta pak ma të ngadaltë. Shprehja 'Nxitoni ngadalë', asht parulla e pashkruar e sarajevasve.

...Esmaja lajmëron se të zotët e shtëpisë po i sjellin skrivaninë... Por në linjen poshtë udhetimi në autokolonën austriake në terheqje vazhdon.

xxx

Pesëshja Cukali (e dy brezave ma parë) vazhdon udhëtimin. Por ka nji të papritun. Asht shoferi që ka marrë komandën. E këtu nji reflektim i shkrimtarit, kësaj herë serjoz, që krahason austriakët në terheqje me austriakët që i kishin dhanë kaq shumë Shkodrës dhe vendit.

Mbasi zbriti orkestra dhe fëmijët panë se dora e trupi mund të lëvizin, shoferi, ju drejtue Nanës: 'Do t'ju ndali në vendbanimin ma të parë'. Fatmirësisht ishte Sarajeva. Kështu shpetuen dhe napolonat e arit që nana donte me i dhanë shoferit që duhet të na çonte në Austri.

Tregon fëmia:

'Kur arritëm në Sarajevë na u duk vehtja ma të rritun. Nana gjatë dy javëve kishte humbë nga feminiliteti i saj e ngjante me nji hyzmeqare fshati e jo zonjë qyteti. Nana filloi të lutej. Edhe unë sajova nji lutje. '

Ishim pesë qyqarë të ulun e të shtrimë në nji trotuar, kur ndaloi makina e zotit Blum. Na pyeti në shumë gjuhë, deri sa nana ju pergjgj italisht, dhe kështu ai u muer vesht me nanën që na i përkthente të gjitha. Shkurt nana na spjegoi se zotni Blum donte t'i takonte në shtëpinë e tij të nesërmen në mjesditë, mbasi ai kishte marrë vesht se çfarë kerkonte: punë çfarëdo, por të nderëshme.

Por ishim të palarë. Duhet të laheshim. Duhet të kishte të pakten nji lum. Në Shkodër kemi tre... Zoti kishte falë ujë e ajr për të gjithë... mendova (flet si i madh fëmia). Nana ndezi zjarr dhe u thamë. Të gjithë dukeshim të tjerë. Motra ma e rritun.

Jeta në jerevinë e familjes Blum që kishte tre vajza, asht nji histori në vete. Nji histori ku nana i bani me luejtë mendësh me gjellët që gatuente e për mbajtjen e shtëpisë. Të katër fëmijët rriteshin, ashtu si fëmia tregimtar që ishte e dashurue me njenën prej dy vajzave të familjes hebreje Blum, pa e dijtë kerkush...Motra arriti në maturë e shkonte shumë mirë me mësime. Madje fitoi edhe nji bursë.

xxx

Në linjen tjetër, në ate investigative për familjen Cukali -se për krijimtari as që bahej fjalë- shkrimtari pson nji zhgenjim. Në messenger nji vajzë nga Holanda, me emnin Ana, i thotë se pse kishte dalë në foto tek varri i familjes së saj. Por edhe pse emnat e vëllezerve binjakë Luka e Gaspri koencidonin, koencidonin e kaq, mendonte ajo. Fliste edhe për nji kangëtare me famë, gja që nuk kishim pasë pasë në familje. Shkrimtari nxjerr konkluzionin se po të kishte qenë gjerman o anglez, Ana Cukali do të kërkonte ta zgjaste muhabetin. Zoran Cukali ishte i fundit që kishte vdekë nga familja Cukali. Vetëm kaq.

Por herë herë bahej kurjoz. Çuditej se si aeroporti me vetëm pak të huej, kishte vetëm 13/14 fluturime në dite. Pranon ftesën e Esmasë me pa nji opera në Teatrin e Sarajevës. Dhe njihet me historinë e Bashkisë, që kishte shpetue pa u hedhë në erë nga austriakët, nga nji shqiptar i quejtun Nush, i kthyem në Nushiç, natyrisht...

Shikon fasadat e mureve të zhbirueme nga plumbat, në atë luftë të pakuptimtë vëllavrasëse. Vetëm me ata vrima, mendonte shkrimtari, mund të shkrueje nji tragjedi...

E herë herë thotë:

'Unë përhumbem e shoh aeroportin në sproporcion me vendet arabe edhe pse jemi afer qendrës së Europës... Nuk marr pergjgije për Cukali... Dal e eci bri lumit. aty ku studenti serb Gavrilo Princip shtiu mbi çiftin perandorak austro-hungarez. Mica rrugës...', përfundon përshtypjet shkrimtari në disa shenime.

xxx

Siç thamë, linja poshtë, në kohë, ecë vertetë paralelisht, por e përshpejtueme. Jemi në Beograd. Po, në Beograd. Kemi vendosë me e përcjellë me tren motren, të gjithë ne. Ajo shkon në Paris me ndjekë studimet e nalta.

Përcjellim motren me trenin Orient Ekspres. Nana asht e veshun mirë. Duhet vetem te qeshnim kur të ndaheshim me motren, - ishte porosia e Nanës.

Jemi në nji kabinë luksoze. Motra kishte kapë per beli nanen e nuk e leshonte...

Atë natë askush nuk fjeti. Luka e Gaspri nuk kishin humbë kohë. Atë ditë kishin gjetë punë përmes nji gazete. Madje me telefon ishin marrë vesht që të fillonin punën nesër. Por në vende të ndryshme. Po pse kjo i duhej thanë nanës pikrisht në ditën që motra do të shkonte në Francë? Nana më shterngonte dorën, si të donte të sigurohej se unë nuk do ta braktisja.

Në Beograd pamë pak Shqipni. E para herë që nana qau, por motra nuk ja pau lotët e saj. Ishte në udhëtim. Pamë në Beograd Rrugën e Durrësit, Rrugën Skenderbeg, Rrugën e Prizrendit deri tek Rruga e Esat Pashës; 'atij ja marrtë dreqi shpirtin', lëshoi namën për herë të parë nana... Porositëm supë dhe krap Danubi. Po nuk ishte kërkund me krapin e Shkodrës.

Nanës i pregatita mengjesin, ashtu si i pelqente asaj, - thotë tashma jo fëmia, por i riu tregimtar. Vitet kalonin.

xxx

Në linjen e siperme shkrimtari asht i shqetësuem. Nji leter anonime e futur nën derën e tij i thotë se Besa merr fund mbas 24 orëve. 'Lekë Cukali keni 24 orë besë. Besa jonë merr fund. Miqtë e Amarcord'. Amarcord? Pse të shqetesohem. Keqkuptim? Zorani i vramë e Amarkordi ç'hyn në punë. Mbush valixhen, e dij se jam shkrimtar, por ndoshta dhe jo...Kush jam, Im atë... Ai më ka lanë porosi që ja kam krye. Edhe varrin e kam gjetë. 'Besa merr fund'. Po ky asht neni i Kanuni shqiptar. Ç'hyn këtu.

Neni i Njiqindenjizetedytë. Besa.

E gjithë kjo në nji ditë prilli që gdhiu e bardhë e me nji të ftohtë të papritun. Në nji ditë kur në Sarajevë shkrimtari i shqetësuem nuk mundi të gjej edhe nji shall të trashë burrash...

xxx

-Tashti që mbeta pa fëmijë, më duket vetja se jam edhe pa atdhe, i tha nana zotit Blum. Hera e parë që foli për atdheun. Ja tha nji hebreu që nuk e kishte parë atdheun e tij kurrë. "Për cilin atdhe e ke fjalën ? Për ate qe nuk të siguroj buken?

Zoti Blum pati frike se e teproi. 'Atdheu asht ai qe të siguron jetën, jo vdekjen'.

Nana mbante në dorë mbante letrat e Lukës dhe Gasprit.

xxx

Kur më mbërthen frika trupi im nis e sforcohet për t'u mobilizue....per t'i dhanë përgjigje nji rreziku potencial. Duke kthye në shtëpi ju shmanga Amarcordit. U shmanga pa e kuptuar hiç se ç'më duhej mua kjo punë. Tim eti ja gjeta rrënjët. Natë pa gjumë.

SI T'I PËRDORNI ARMIQTË TUAJ

Nga Baltasar Gracián

Botim i ri nga "Minerva"

Në këto aforizma të urta dhe makiaveliste, prifti i pazakontë spanjoll, Baltasar Gracián, na tregon se si të përfitojmë si nga miqtë, ashtu edhe nga armiqtë, për të lulëzuar në një botë me mashtrime dhe iluzione.

Vepra e Gracián-it nuk është thjesht një për- mbledhje pohimesh filozofike; është një doracak praktik për ata që synojnë të shkëlqejnë në botë. Aforizmat e tij i nxisin lexuesit të jenë proaktivë, të mprehtë dhe strategjikë në ndjekjen e suksesit. Rëndësia e librit i tejkalon kufijtë historikë, duke ofruar njohuri të vlefshme për lexuesit e sotëm që duan të kuptojnë natyrën njerëzore dhe të përmirësojnë jetën e tyre.

Shkrimtari e braktisë apartamentin. Nji gjysë ore asht larg stacioni i autobusave. Shkrimtari kishte braktisë apartamentin e rezidencës së tij letrare. Kishte frikë të merrte taksi, ku mund të ishin ata. Ata që kishin shkrue atë letër kërcnuese.

'Më del përpara autobusi: Podgoricë... Mbeshteti kryet tek hekuri i karrigës para. Nuk due te shoh anash. Shoh kuq të semaforëve e ma në fund të gjelbër'.

xxx

Zoti Blum asht i shqetësuem. Para ka nji grumbull gazetash. Kishim festue dy herë Vitin e Ri 1941. Nji herë në shtator hebraikun dhe tashti...Bosnja Hercegovina ranë nën pushtimin Kroat kuisling nazist. U shfaqen ustashët me antisemitizmin e tyne; me ndjekjen e hebrejve, serbeve e romëve.

Për herë të parë Nana e ndërpreu zotin Blum, madje edhe me nji za të premë: 'Ju duhet të shkoni në Shqipni, zoti Blum!'

Shqipëri?, tha e habitun mbas nji heshtje të gjatë, zoja Blum.

-Do ju shoqnojnë Mikeli (dhe shikoj nga unë). Shtëpinë e ruej unë...

-Kush na siguron se nuk na deportojnë.

-Besa, i tha nana. E ja spejgoi punën gjatë, deri tek kanuni...Miku nuk dorëzohet tek askush. Ai asht që urdhnon në shtëpiat tona...

xxx

Gjithkund Ballkani njilloj. Rrugë që ndjekin lumejt... Lugina, shkurre e në sfond male me borë. Shoh fytyra të qeta, por jo të gëzueme e jo të rrezikshme. Shoferi lajmëron të vetmen ndalesë e unë due të shkoj ne banjë me nxjerrë gjithë sikletet nji nga nji...Nji njeri del nga baja e unë hyj. Dal dhe e kerkoj. Me ngjet. Unë jam i pasigurtë, jam unë, por dyshoj. Ai asht i qetë...

xxx

Do të udhëtonin drejt jugut me makinen e Blumit, nji Mercesdes Benz e viti 1938, pra mjaft e re. Tre vende para e tre mbrapa. Nana më thirri dhe me futi ndër rroba pistoleten e dikurshme. Edhe 6 fishekë. Më puthi në ballë e më bani shejin e kryqit. Vetëm për vetmbrojtje. Ma mirë mos me e përdorë. Zoja Asher filloi te lutej. Tre bidonë me benzinë në bagazhë. Tre e natës u nisëm.

E mandej në roman do të ndodhë gjiththça që asht e paparashikueme, por shumë e pasun me ngjarje. Si duket autori e ka lanë këte fund me tregue se kush janë shqiptarët; por pa bujë e pa krenari; të tregojë madje krejt thjeshtë historinë e besimeve në Shqipni e Kanunin. Pa nene, por me shembuj konkretë. Pa asnji deklaratë, por vetëm me atë ngjarje të gjetun e të ngjeshun të atij udhëtimi, të asaj nate e në atë kullë të lashtë 400 vjeçare.

xxx

Por mos të harrojmë shkrimtarin që po kthehet në Shqipni. Po përsërisim fjalinë e fundit që ku e kishim lanë.

...Nji njeri del nga baja e unë hyj. Dal dhe e kerkoj. Me ngjet. Unë jam i pasigurtë, jam unë, por dyshoj. Ai asht i qetë...

-Po shkoj të takoj nanën, më thot. E kemi lanë në Sarajevë. E ti?

-Unë po kthehem në Shkodër, i them. Sa mirë që u takuam këtu. Është mirë kur takohesh në vende të ndërmjeme. Por nuk po e kuptoj mirë, vazhdoj unë, në çfarë kohë jemi?

-He pra, as unë nuk po e marr vesht se në ç'kohë jemi.

Në ç'kohë?

Këte herë dy linjat e fugës përfundojnë në unison.

xxx

E kjo kuptohet duke lexue romanin 'Saga e Srajevës', nji roman modern, me formë e rrëfim origjinal, që asht edhe plot informacion esencial kulturor, historik e sociologjik. Urime!

Rreth romanit të Anton Nikë Berishës "Bimorja", botimi i dytë i përpunuar, "Faik Konica"

E kaluara e ndritshme e përjetësuar poetikisht

Nga Timo Mërkuri

Në romanin e Anton Nikë Berishës "Bimorja" Pjetër Bogdani nuk vjen thjesht si një figurë historike, por si një trupëzim drite, një shpirt që bart në vete klithmën e një kombi të përndjekur dhe mallin e një atdheu që ende nuk ka lindur plotësisht. Ai rrëmon në thellësinë e dheut të vet për të gjetur jo vetëm rrënjët, por edhe rrugët e shpëtimit. Nga faqet e romanit, Bogdani ngrihet si një kryemurg i gjuhës, i fesë dhe i kombit, një figurë e ndritshme që flakëron në terrin e shekullit XVII.

Kohë e përflakur është ajo e Bogdanit: Perandoria Osmane në grahmat e saj, dhuna e sistematizuar mbi trojet shqiptare, një shoqëri që lëngon nën barrën e varfërisë, analfabetizmit dhe konvertimeve të dhunshme. Në këtë sfond të errët, Bogdani është drita që guxon të ndeshet me perandorinë, jo me heshta, por me pendë. Ai e përshkruan Perandorinë si një "i sëmurë i Bosforit" që përhap mjerim, ndërsa shqiptarët si njerëz që i përballojnë këto plagë me krenari dhe qëndresë – si rrënjë, bimësi që ngrihen mbi gërmadha.

Romani, i ndërtuar me një gjuhë që përzihet ndërmjet epikës së moçme dhe thurjeve të poetikës moderne, i jep zë shpirtit të Bogdanit përmes letrave, kujtimeve dhe përfytyrimeve. Ai shfaqet njëherazi si bari shpirtëror dhe prijës popullor; një ndërmjetës ndërmjet tokës dhe qiellit, që e kupton se kombi s'mund të shpëtohet vetëm nga qielli. E ndjen thellë përgjegjësinë ndaj njerëzve të gjakut të vet, dhe kështu përgatit një kryengritje, kërkon ndihmë ndërkombëtare, thur plane ushtarake dhe ruan besimin në fjalën e dhënë: "Kur shqiptari jep besën, atëherë mëdyshje s'ka; vetëm vdekja mund t'ia thyejë".

Në romanin "Bimorja" Anton Nikë Berisha e vesh Bogdanin me tis legjendar. Ai është një figurë që kalon kufijtë e historisë dhe shndërrohet në simbol të qëndresës. Edhe pas vdekjes, ai nuk gjen qetësi, trupi i tij kërkohet nga Porta e Lartë, ndërsa hija e tij ndjek nëpër net sadriazemin osman, duke i pështëritur në gjuhën amtare kujtimin e mëkatit dhe peshën e tradhtisë. Është Bogdani që e zgjon ndërgjegjen e fjetur, që flet në emër të një populli të përbuzur, por të papërkulur, një murg që kurrë nuk heshti, një shkrimtar që e shkroi shpirtin në gjuhën e vet.

Përmes një strukture të ngjeshur dhe një stili të ngjizur me figura të fuqishme poetike, "Bimorja" nuk është vetëm roman për një njeri, ai është elegji për një epokë, një himn për gjuhën dhe një testament për të ardhmen. Në këtë rrëfim të ndërthurur mes mitit dhe realitetit, Pjetër Bogdani është më shumë se një hero, ai është vetë gjaku që qarkullon në trungun e kombit shqiptar. Ka njerëz që nuk ikin kurrë, sepse nuk kanë jetuar vetëm për veten. Ata marrin frymë nëpër gjuhën dhe gjurmët që lanë pas.

I- Subjekti dhe personazhet në "Bimorja" – ndërmjet kujtesës, veprimit dhe hijes së pavdekshme

Në romanin Bimorja Anton Nikë Berisha thur një rrëfim që shtrihet në kufirin mes historisë dhe mitit, mes jetës dhe vdekjes, ku qenia njerëzore e vendosur përballë dhunës së Perandorisë Osmane merr përmasat e një qëndrese epike. Subjekti ngrihet mbi gjurmimin e një kufome, të arqipeshkvit, Pjetër Bogdanit, një trup i fshehur që tmerron Portën e Lartë, sepse nuk është thjesht një trup, por është një shpirt që s'ka pranuar të shkojë në qiell pa u përfunduar më parë misioni në tokë.

Varrimi i tij, i padukshëm, pazhurmshëm dhe i pabashkëngjitur me ceremoni, është gur shqetësimi për Sulltanin dhe Sadriazemin, sepse aty është një kryengritje, një thirrje lirie, një popull. Pra, Porta ngarkon njerëzit e saj të zbulojnë vendvarrimin, por sa më shumë kërkojnë, aq më e thellë bëhet misteri. Rrëfimi ndjek dy fusha të mëdha që përballen, njërin të zaptuar nga frika e humbjes dhe të tjetrit të ndriçuar nga drita e qëndresës.

1.Kampi i dritës, Pjetër Bogdani dhe pasuesit e tij

Në zemër të kësaj fushe qëndron Pjetër Bogdani, "bari i përshpirtshëm" dhe njëherazi strateg i lirisë. Ai është më shumë se një njeri, është një kryq i ngritur në ballë të kombit dhe një pendë që derdh gjakun në faqet e letërsisë shqipe. Në letrat e tij, ai rrëfen me dhembje dhe përkushtim fatin e shqiptarëve: "Nuk heqin dorë nga gjuha e tyre, që e çmojnë të shenjtë. Nuk heqin dorë as nga përkatësia kombëtare e fetare; ruajnë me këmbëngulësi doket dhe zakonet e lashta…".

Pranë tij qëndrojnë priftërinj si don Drenekurti, zëra të heshtur që ruajnë kujtesën, librat, letrat, besën, njësoj siç mbrohen rrënjët e një bime të lashtë nga era që kërkon t'i shkulë. Edhe figura si Lukë Marini, "i përshpirtshmi" që sillet në hijet e kishave, e që fillimisht i shërben kadiut, preket nga drita e Bogdanit dhe ndien se ky "qiri i ndezur për njeriun tonë" mund ta ndryshojë edhe vetëdijen e tij.

2.Kampi i errësirës – Porta e Lartë dhe hijet e saj

Në skajin tjetër qëndron fusha e errësirës; Kopryly Fayil Ahmet Pasha, sadriazemi shqiptar me shpirt të humbur, që e sheh veten si pjesë të fuqisë, por që brenda tij flet një zë i thellë, i përgjumur, po ende gjallë. Ai përndiqet nëpër net nga hija e Bogdanit që i flet në gjuhën e nënës: "O i mjerë, që gjaku t'u ka bërë ujë, po të flas në gjuhën, me të cilën të ka kënduar me aq dashuri nëna jote në djep!"

Ai është i ndarë mes detyrës dhe prejardhjes. Hije të tjera si Kadiu Abdul Hikmeti dhe zyrtarët e tjerë, bredhin nëpër dosje, letra, urdhra dhe harta, por kurrë nuk prekin thelbin, sepse po kërkojnë kufomën e një trupi, ndërsa ajo që i tremb vërtet është gjallimi i një fryme, i frymës së lirisë.

Në këtë përplasje të gjatë, Anton Nikë Berisha nuk shkruan thjesht një histori për të kaluarën, por ndërton një poemë për fatin shqiptar. Bimorja është një rrëfim për gjurmimin e një varri, i cili është bërë bimë, është ngjizur me tokën dhe ka shndërruar vetëdijen në rrënjë të pashkulshme.

Në fund, të dy veprimet mbesin: njëri në heshtjen e dosjeve që nuk flasin më, e tjetri në frymën që endet ndër male, ndër libra, ndër gjuhë, ndër breza. Dhe në mes qëndron ai, Pjetër Bogdani, i gjallë në vdekje, i rrënjosur si bimë që nuk thahet.

II-Risitë e romanit "Bimorja": Kur historia shndërrohet në shpirt dhe kujtesa bëhet bimë.

Në një kohë ku shpejtësia e harresës është më e madhe se ajo e mendimit, Bimorja e Anton Nikë Berishës vjen si një vepër që nuk ecën në udhët e modës letrare, por rritet në heshtje si një bimë me rrënjë të thella, që ushqehet nga kujtesa kolektive, nga dhimbja e trashëguar, nga fjala që nuk vdes. Risia e saj nuk qëndron në një risi teknike apo thjesht strukturore – ajo vjen nga fryma, nga qasja shpirtërore që kjo vepër i jep historisë dhe identitetit shqiptar.

1. Historia e rikthyer si rrëfim poetik

Risia e parë është mënyra si Berisha e kthen historinë – këtë materie të rëndë, shpesh të ftohtë – në një rrëfim me vlerë poetike, ku edhe arkivat marrin frymë, edhe dosjet psherëtijnë, edhe hijet ngjiten nëpër netët e njerëzve. Ai e kthen një ngjarje historike – vdekjen dhe fshehjen e varrit të Pjetër Bogdanit – në një dramë metafizike, ku kërkimi i kufomës shndërrohet në kërkim të kuptimit, të shpirtit, të të vërtetës. Kryepersonazhi i këtij romani është i vetmi në letërsisë tonë dhe më gjerë, që fizikisht është i vdekur.

"Emri i tij ishte gjetur në librin e të vdekurve të spitalit të Prishtinës. Çdo gjë tjetër e kishte gëlltitur Toka…".

Ky nuk është thjesht fakt, por mallkim, zbrazëti, metaforë për një komb që e fsheh të gjallin nëpër varre dhe i kërkon shenjat më pas, nëpër letra, pluhur, gjurmë, rrënjë.

2. Te "Bimorja" shfaqet shkrirja e zhanreve; roman, poemë, testament, duke sjellë risinë e gjuhës dhe të shprehurit; një prozë që përkundet si psalm, që përzihet me ligjërimin rrëfimtar, dokumentar, mistik e filozofik. Ajo nuk ndjek një linearitet tradicional, por ndërton vetveten si një lëndinë me shtegtime shpirtërore. Bimorja është roman, por është diçka më shumë; ajo është poemë në prozë, është testament kombëtar, është këngë zie dhe lavdie me të njëjtën frymë.

3. Këtu heroi vjen si një zë kolektiv dhe kujtesë e gjallë. Në kohën tonë të individit të zbrazët dhe heroit të sajuar nga mediat, Pjetër Bogdani rikthehet si një figurë që nuk e shteron dot as historia, as letërsia. Ai nuk është vetëm një njeri i kohës së vet, por një flamur i asaj që nuk vdes: kultura, gjuha, besimi, atdhedashuria. Risia qëndron në këtë përmasim të ri që i jepet heroit, ai nuk është thjesht një prijës shpirtëror, por një rrënjë që ndriçon edhe kur ndodhet nën dhe. Dhe ky portret, kjo masë është shprehur poetikisht në roman, gjë që shfaq talentin e autorit dhe ndërlidhjen me njohjen e historisë dhe të teologjisë. "Në luftë për atdheun ata nuk kursejnë asgjë. I njoh mirëfilli këta njerëz… edhe sot janë të gatshëm të bëhen therorë për të mirën e atdheut dhe lirimin e tij."

4. Një tjetër risi e fuqishme është metafora e vdekjes, që nuk shfaqet si një fund, por si nisje. Romani " Bimorja" na flet për një trup të vdekur që mbahet i fshehtë, por që pikërisht për këtë bëhet më i pranishëm, më i rëndë, më i frikshëm për pushtuesit. Kjo është një mënyrë e re e të konceptuarit të martirizimit në letërsinë shqipe: jo si mbyllje, por si dritare e hapur, si farë që pret të mbijë. "Ai ka qenë njeri me zë të madh në atë krah dhe rrënjët e veprimit të tij nuk shuhen lehtë…"

Romani nuk vjen për të tronditur me shfaqjen e jashtme, ajo flet me thellësinë e saj. Në kohën e sotme të klithmave, ajo zgjedh urtësinë. Në epokën e harrimeve të mëdha, ajo ndalet dhe kujton. Është një roman që i flet shpirtrave të kohës sonë përmes një gjuhe që nuk vdes, përmes një heroizmi që nuk thërret, por ngjizet si bimë që përkundet në tokën e plagosur dhe, prapëseprapë lind.

Kjo është risia më e madhe: një roman që nuk shpreh vetëm çfarë ndodhi, por si duhet ta ndjejmë atë që na ndodhi, dhe si duhet ta ruajmë që të mos na ndodhë më.

III- Në romanin Bimorja të Anton Nikë Berishës përmendet vepra themelore e Pjetër Bogdanit, "Çeta e profetëve" (Cuneus Prophetarum botuar më 1685), që cilësohet si themeli i prozës së vjetër shqiptare bashkë me paraardhësit e tij, Buzkun E budin, dhe përmendja e saj në roman shërben për të ndriçuar rolin e Bogdanit jo vetëm si klerik dhe prijës popullor, por edhe si ndër themeltarët e letërsisë së shkruar shqipe. Në roman thuhet: "Ky njeri, përveç se ishte udhëheqës shpirtëror, kishte shkruar edhe një libër të rrallë për kohën, në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për malësorët, për ta bërë Zotin të afërt dhe fjalën e shenjtë të kuptueshme për popullin e vet…".

Ky pasazh është një referencë e qartë për "Çetën e profetëve", dhe tregon se Anton Nikë Berisha ka pasur për qëllim të theksojë rolet e shumëfishta të Bogdanit: si shpirtëror, atdhetar, por edhe si krijues i gjuhës shqipe të kultivuar, i cili e ngriti fjalën në nivel të shenjtë, në shërbim të kombit.

Ky fakt që përmendje nuk është i rastësishëm, ai ndihmon në ndërtimin e një portreti të plotë të Bogdanit, i cili në roman paraqitet jo thjesht si figurë historike, por si bimë që lëshon rrënjë në të gjitha shtresat e shpirtit shqiptar: në gjuhë, në besim, në letërsi dhe në kujtesë.

Anton Nikë Berisha, përmes Pjetër Bogdanit, nuk e sjell vetëm figurën e një arqipeshkvi të urtë e kryengritës, por rikujton dhe rithemelon një prej gurëve të paktë e të çmuar të themelit të shqipes së shkruar. Ai nuk e ndan gjuhën nga qëndresa, e as besimin nga letërsia. Kjo është njëra nga risitë domethënëse të romanit: ai e shpalos Bogdanin si njërin nga prindërit e gjuhës shqipe, që me "Çetën e Profetëve" hodhi themelet të një shqipeje të ndriçuar, të pasur, të qartë – një gjuhë që sot na mban gjallë si komb.

Në një kohë kur kujtesa jonë për portrete të tilla historike po tretet dhe rrënjët shpesh zbehen nën hijen e harresës, Bimorja vjen si libër i kujtimit dhe i trashëgimisë dhe i nderimit të gjuhës shqipe, që nga goja e Bogdanit nuk doli vetëm si predikim, por si shpëtim dhe atdhe dashuri. Kjo rikujtesë, në vetvete, është një dëshmi shpirtërore dhe kulturore për leximtarin e sotëm, që në figurën e Bogdanit gjen një fakt se fjala shqipe i ka pasur priftërinjtë e saj që e kanë mbrojtur me jetën dhe e kanë bekuar me veprën.

IV-"Bimorja" na shfaqet si një epikë e rrënjëve dhe dritës në errësirën e Perandorisë. Në këtë roman, Anton Nikë Berisha, një njohës i thellë i historisë dhe shpirtit shqiptar, e ndërton veprën e tij jo si një rrëfim të thjeshtë ngjarjesh, por si një poemë të gjatë dhe të dhimbshme për qëndresën, për nderin, për fjalën e patharë në gjuhën amtare dhe për kujtesën që nuk dorëzohet. Vlerat e këtij romani nuk qëndrojnë në temën që trajton, por në mënyrën si ai e thur dhe e shpreh historinë me poezi, filozofinë me dhembje, dhe gjuhën me shpirt.

1. Vlera artistike është fjala që rritet si bimë mbi dhé të djegur, pse Berisha e shkruan Bimoren me një gjuhë të ngjeshur, të dendur, që nuk rrëshqet lehtë, por duhet ta mbash si një emër të dashur mbi gjuhë për ta ndier peshën dhe aromën e saj. Figura si Bogdani, pashai osman, kadiu, Sadriazemi, Lukë Marini, janë jo thjesht personazhe, por shtresa të mendimit dhe kujtesës. Aty nuk ka bardhësi absolute e as zi të kulluar, por një dritë që vjen nga rrënjët dhe një errësirë që rrjedh nga padija, pushteti dhe frika.

Pjetër Bogdani është portretizuar përmes një gjuhe që e ngre mbi tokën e zakonshme, por pa e larguar nga njerëzit e tij. Ai është i përshpirtshëm dhe i heshtur, por njëkohësisht i zhurmshëm në kujtesë, saqë edhe i vdekur, trupi i tij tund themelet e Portës së Lartë: "Trupi i tij do t'u qitet qenve te Sheshi i tregut… sepse nga trupi i tij nuk u shkëput shpirti...".

Ky është një nga kulmet e artistikes: kur shpirti i heroit mbetet në tokë për të vazhduar betejën, për të qenë me popullin e vet, për të mos u ngritur në qiej pa parë lirinë.

2. Vlera historike është më së pari kujtesa që përgjon prapa çdo fjale, pse romani "Bimorja" nuk është vetëm letërsi, ajo është dëshmi historike e bërë art. Proza ngre një pasqyrë të thellë të shekullit XVII, ku perandoria osmane, me burokracinë e saj të sëmurë dhe dhunën e përditshme, përpiqet të mbysë çdo shkëndijë ndriçimi në viset shqiptare. Letra që Bogdani i dërgon Papës dhe Perandorit të Austrisë janë letra historike të vërteta, të dokumentuara, të cilat autori i ka qepur në rrëfim me një mjeshtëri të rrallë: "Jam i gatshëm të ngre në luftë prej 6000 deri në 8000 vetë, burra të paepur... dhe një pjesë e mirë janë shqiptarë të besimit islam. E kur shqiptari jep besën, mëdyshje nuk ka…".

Kjo është histori shqiptare që flet shqip, që flet me gjakun dhe besën e popullit, kjo është një portret i vetë popullit shqiptar që qëndron përballë pushtuesit turk dhe islamizmit që ai sjell, për të qëndruar të lidhur me Evropën dhe krishterimin. Duket sikur thotë: Ne jemi Evropë, nuk bëhemi Azi.

3. Vlera filozofike që shfaq romani duket kur njeriu bëhet rrënjë dhe fjala bimë. Në thelbin e veprës qëndron një filozofi e thellë: çfarë ndodh me njeriun kur vdes, por nuk vdes shpirti i tij? Çfarë ndodh me një komb kur i fshihet varri i kujtesës? A mund të shuhet drita që është rrënjosur thellë në shpirtin e njerëzve? Pashai i Sulltanit, sadriazemi Kopryly, është përfytyrimi i një qenieje që s'ka më as atdhe, as gjuhë, as kujtesë. Ai përndiqet në gjumë nga hija e Bogdanit, që i flet në gjuhën që ai e ka harruar: "Po të flas në gjuhën me të cilën të ka kënduar nëna në djep…"

Ky është momenti më filozofik i romanit, fjala e nënës, fjala shqipe, si zgjim i ndërgjegjes së fjetur, si thirrje për dalje nga errësira.

4. Antiteza e romanit: Bogdani i dritës kundër Pashait të verbërisë, pse në zemër të romanit gjendet antiteza e madhe: Bogdani dhe Pashai. Bogdani është shkrues i fjalës që shëron, pashai është shkresaxhi i urdhrave që vrasin. Bogdani kërkon lirinë dhe i flet Perëndisë, pashai kërkon varrin dhe i flet frikës. Edhe i vdekur, Bogdani shndrit si yll mbi viset shqiptare; ndërsa pashai, edhe i gjallë, është një hije që tretet në oborret e Portës. Në përballjen e tyre, e vdekura fiton

mbi të gjallin, sepse është një e vdekur që nuk u nënshtrua.

5.Portreti kolektiv paraqet malësorët dhe ushtarët osmanë, por me ngjyra të ndryshme. Malësorët janë gjaku që nxit Bogdanin. Ata janë të heshtur, por me zemra që vlojnë si vullkane. Ata nuk kanë as letra, as fjalime, por kanë besën, pushkën dhe këngën. Ata janë të rrallë në faqe, por të gjithë pranishëm në frymë, në betejë, në mal, në lartësi.

Përballë tyre qëndrojnë ushtarët osmanë, figura pa emra, pa rrënjë, që ndjekin urdhrin dhe jo ndërgjegjen. Ata janë pjesë e një trupi të verbër, që frikësohet nga hija e një kufome dhe që trembet nga fjala që nuk mund ta kuptojë.

Bimorja është një ndërtim me gurë të rrallë: gjuha, kujtesa, qëndresa dhe drita e shpirtit shqiptar; një roman ku e shkuara nuk është vetëm histori, por një pasqyrë që na flet edhe sot, edhe nesër, për atë çfarë duhet të jemi, dhe për atë çfarë s'duhet kurrë të harrojmë. Bogdani është i vdekur, por ai mbin si bimë në çdo cep të tokës shqiptare ku fjala e tij është ruajtur. Ka të vdekur që nuk vdesin kurrë, dhe të gjallë që nuk jetojnë asnjëherë.

V-Romani "Bimorja" është një vepër moderne me frymë thellësisht introspektive dhe të përshpirtshme, e cili i qaset qartë rrymës moderniste të romanit eseistik dhe simbolik, duke u ushqyer njëkohësisht nga rrënjët e prozës meditative dhe të kujtesës kolektive. Ai nuk ndjek format klasike të rrëfimit realist, por zgjedh udhë të shpirtit, të ndërgjegjes, të simbolit dhe të fjalës që bart kuptimin përtej të dukshmes.

1. Romani i përket rrymës moderniste, sepse shkon përtej linjës së zakonshme narrative; nuk i qëndron besnik një ngjarjeje të vetme, por shfaq një strukturë të ndërlikuar që ndërlidhet më shumë me mënyrën si ndërtohet mendimi, kujtesa, frika dhe përsiatja sesa me veprimi i jashtëm. Struktura është cirkulare, shpesh fragmentare, me kthime të brendshme, dhe mendimi filozofik mbizotëron mbi ngjarjen. P. sh., përshkrimet e natës së Sadriazemit, ku hija e Bogdanit i shfaqet në ëndërr dhe i flet me gjuhën e nënës, nuk janë vetëm ngjarje, ato janë gjendje shpirtërore, ndërgjegje e përndjekur: "O i mjerë, që gjaku t'u ka bërë ujë… Mos të është shuar çdo gjë dhe nuk e ndien më atdheun tënd?"

Ky zë nuk është zë i narracionit të zakonshëm, por një zë i ndërgjegjes historike, një ndërthurje e realitetit me metafizikën e shprehur përmes artit të pasur. Qëllimi kryesor i autorit të këtij romani është që gjuha me të cilën rrëfehet të jetë sa më poetike dhe teksti që e krijon të jetë sa më poetik dhe kuptimisht sa më i pasur dhe më shumësor, si dëshmohet në këtë pjesë të tekstit:

Buzëlythi, i cili kishte gropuar paksa dhe madje një pjesë të dheut e kishte hedhur anash, e pa me kureshtje dhe me frikë Vetullprerin e stepur në bishtin e kacisë. Një nur i hirtë ia kishte mbuluar fytyrën; i kishin rënë vetullat deri poshtë dhe i ishte ngrysur pamja thuajse ndonjë re e vrugët i ishte ngjitur për fytyrë. Gjithë atë që Buzëlythi e vërejti te Vetullpreri, e arsyetoi: puna që bënin ua gërmonte shpirtin me kazmën e ferrit. Ata njëmend gërmonin në varrin e panjohur, po a nuk gërmonin njëherit në kobin dhe në fatkeqësinë e tyre? Në qoftë se vdekatari është shndërruar në lugat, atëherë së pari do të sulet mbi këta që ia prishin qetësinë, e trazonin. Kur njeriu vdes asgjë nuk është e tij, pos ajo pjesë e tokës. Po qe se në këtë varr, njëmend, rri ndonjë lugat, çfarë e keqe do t'i gjejë? Ndoshta nga ai do të shpërthejë shkumë e verdhë verbuese që t'i mbështjellë si shtjella e vdekjes? Ndoshta do të shqirret me zë të tillë gërvallës sa do t'ua shqyejë timpanet e veshëve? Mund të ndodhë që në shenjë hakmarrjeje t'i kafshojë me dhëmbët që i janë zgjatur nga pluhuri, nga balta dhe nga terri i nëntokës ose do t'ua ngulë thonjtë e stërzgjatur nga amshtimi e kjasina e dheut? E keqja e lugatit nuk do të marrë fund me kaq; mbasi të kryejë punën me varrmihësit, do të kaptojë varrezat dhe do të mësyjë shtëpitë e tyre. Do të presë të bëhet natë, pastaj do të fluturojë dhe do t'u fryjë njerëzve me dufin e lugatit dhe ata frik do të shndërrohen në qenie të botës së nëndheshme, që për ushqim do t'i kenë rrënjët dhe thëngjillin, ndërsa etjen do ta shuajnë me djersën dhe me lotët e tyre! Vërtet çka do të ndodhte me ta? Në ç'mënyrë do t'i sulmonte lugati nga varri që po e hapnin?

2. Rryma tjetër moderniste që përshkon romanin është ajo simboliste, ku çdo element merr ngarkesë të shumëfishtë kuptimore. Vetë titulli "Bimorja" është një metaforë: Bogdani nuk është thjesht një kufomë, por një bimë që mbin nën tokë dhe çel kujtesën e popullit të vet. Është një shenjë që nuk vdes, një rrënjë që nuk thahet. Kërkimi i trupit të Bogdanit nuk është thjesht një urdhër burokratik, por një udhëtim i frikshëm i Perandorisë drejt vetëzbulimit të shkatërrimit të saj.

Simboli i hijes, i trupit të zhdukur, i zërit të përtejbotshëm, janë elemente që e afrojnë veprën me modernizmin e autorëve si Kafka, Joyce apo Faulkner, ku realja nuk është kurrë e vetme, dhe rrëfimi është rrafsh më shumë shpirtëror sesa kronikal.

3. Bimorja është pjesë e modernizmit të identitetit dhe të gjuhës, një rrymë që e sheh njeriun si qenie të ndërlikuar historikisht e shpirtërisht, të lidhur pazgjidhshmërisht me gjuhën e tij, me rrënjët e tij. Figura e Bogdanit është shkrirje e arqipeshkvit, atdhetarit, filozofit, dhe autorit të gjuhës, një hero i paemër i shpirtit kolektiv shqiptar. Në këtë aspekt, romani ndjek gjurmët e modernizmit që e sheh letërsinë si mjet për të rindërtuar kujtesën dhe për të rikthyer zërin e humbur të një kombi.

Kjo vepër, në thelb, është një sublimim i përndritur nga rrënjët, ku përmes figurës së një të vdekuri që nuk vdes, lexohet historia, filozofia dhe letërsia e një kombi i cili, për të mbijetuar, ka mësuar të jetojë edhe duke kujtuar.

VI- Në një kohë kur fjalët rëndojnë si gurë mbi vetëdijen kombëtare, kur zërat e përvuajtur të historisë po shuhen në harresë, romani Bimorja i Anton Nikë Berishës vjen si zë i ngjizur nga rrënjët, si një mallkim i ëmbël ndaj heshtjes sonë kolektive. Ky roman nuk e rikthen Pjetër Bogdanin vetëm për të nderuar një figurë, por për të na rikujtuar vetveten në një kohë që kemi harruar kush jemi.

1. Rikthimi i Bogdanit në letrat tona nuk është një gjest përkujtimor, por një shkundje e thellë ndaj fjetjes sonë shpirtërore. Ai rikthehet si një frymë e tokës që nuk është pajtuar me harresën. Në një epokë ku jeta politike dhe kulturore ndonjëherë është shndërruar në një pasqyrë pa thellësi, figura e Bogdanit ngrihet si një shtyllë e ndërgjegjes së mirëfilltë.

Ai nuk thërret me fjalë të mëdha, por me një zë të qartë, që buron nga dheu, nga besa, nga gjuha. Tek ne vjen si një profet i heshtur që nuk predikon, por jeton brenda çdo fjale që e kemi harruar. "Ai kishte mbetur i pazbuluar, i pastër, i palëvizur… si një farë që pret tokën e duhur për të mbirë".

2.Në vendin tonë ku pemët në tokë, por dhe vetë toka, ka nevojë për rrënjë të thella. Shqipëria, Kosova dhe trojet tona të tjera janë truall i plagosur nga harresa dhe nga përçarja, por edhe vend i bekuar nga shpirtra të mëdhenj.

Berisha e sjell Bogdanin si një farë të gjallë që duhet të mbillet në çdo cep të atdheut, për të mos harruar se gjuha jonë, feja jonë, liria jonë kanë pasur themelues, martirë, njerëz që u dogjën për dritën që na lanë. Nëpër faqet e romanit, populli ynë përshkruhet si një bimë që është përpjekur të shkulet, por nuk është shuar, sepse rrënjët e tij janë thellë, atje ku fjala e Bogdanit është ngulitur si kryq i pathyeshëm.

3. Populli që Berisha përshkruan përmes letrave të Bogdanit nuk është një turmë e përgjumur, por një popull me ndërgjegje të lashtë, me besë të pathyeshme, me gjuhë të shenjtëruar. Figura e Bogdanit bëhet zë i shumësisë, bëhet ikonë e atij shqiptari që, pavarësisht besimit, e mban tokën dhe gjakun si shenjtëri.

"I njoh mirëfilli këta njerëz… janë shqiptarë të besimit islam, por kur japin besën, mëdyshje nuk ka...". Në këtë fjali rrëqethëse, Bogdani flet për një popull të bashkuar në vlerë, jo në formë; në shpirt, jo në dogmë. Dhe kjo është një nga vlerat më të mëdha që romani "Bimorja" i sjell kohës sonë, një popull nuk matet me ndasi, por me thellësinë e rrënjës së tij të përbashkët.

4. Ky roman është më shumë se një histori: është një pasqyrë që na fton të shikojmë veten përmes një figure të ndritshme, për të matur sa larg jemi nga fjala, nga nderi, nga përkushtimi. Është një udhëtim brenda vetes, ku Bogdani nuk është thjesht një personazh, por një zë që troket në ndërgjegjen tonë dhe na pyet në heshtje: "Po ju, çfarë po bëni me fjalën, me gjuhën, me atdheun"?

Rikthimi i Pjetër Bogdanit në kohën tonë, përmes romanit Bimorja është një vlerë që nuk mund të matet me fjalë të zakonshme. Ai është dritë e moçme që vjen për të na ndriçuar udhën, është një gojë e vjetër që na thotë fjalën e re, është kufomë që ringjallet në çdo ndërgjegje që nuk pranon të vdesë pa pasur liri. Në thelb ai është një dritë që kërkon sy për t'u parë.

Për këtë arsye, ky roman është një bimë që duhet lexuar ngadalë, me kujdes, siç bëhet një lutje e vjetër, siç dëgjohet një këngë e harruar, që vetëm kur e këndon edhe ti, kupton se është kënga jote.

VII- Në letërsinë shqipe, ku zërat janë të shumëllojtë, por jo gjithmonë të thellë, Bimorja e Anton Nikë Berishës qëndron si një psalm që nuk thotë fjalë për të rrëfyer ngjarje, por për të shkundur ndërgjegje. Ky roman nuk ecën nëpër udhët e zakonshme të prozës realiste apo të trillimit të përshpejtuar. Ai është i vetmi në llojin e vet në letërsinë shqipe bashkëkohore, një tekst i rrallë që ngjiz gjuhën, historinë dhe filozofinë në një poemë të heshtur, në një rrëfim që i flet thellësisë dhe që kërkon lexues me sy të brendshëm.

1.Në letërsinë shqipe Bimorja është një gjuhë që nuk vjen nga sipërfaqja, por nga brendësia e dheut. Stili i autorit është i qëndrueshëm, i kthjellët, por i ngjeshur si gur varri mbi të cilin rritet një bimë e gjelbër. S'ka zbukurime të kota, s'ka ndjeshmëri të lehtë apo retorikë të zhurmshme. Ka një përulje të thellë përpara fjalës dhe respekt të heshtur për kujtesën, për trashëgiminë, për të mbijetuar.

Mirëpo, përsëritja e shpeshtë e fjalëve dhe jehona e thekshme e daulles sa shkuan dhe u futën në kokat e qytetarëve, u ranë si shkreptimë e mbytur në gjëmë: i hapën sytë dhe i picërruan veshët. Një mëdyshje e pafund i futi në dredhën e etheve dhe i shaloi nëpër hulli të errët. Ishte ëndërr apo zhgjëndërr ajo që dëgjonin? Disa thanë se gjithë ajo që ua therte veshët ishte vetëm një përftim që e kishte vjellë nata dhe se ndriçimi i ditës do ta shkrinte si flluskë sapuni. Disa të tjerë mendonin se fjalët dilnin nga kokat e njerëzve dhe nuk i thoshte askush! Plakat dhe pleqtë vunë gishtat në veshë që të hiqnin dyllin e shtresuar me vite si diçka e kobshme që ishte grumbulluar me pahir aty dhe nuk i linte të dëgjonin si duhet, ndërsa fëmijët kumtin e morën si fillim të një loje, e cila do të bëhej më e madhe dhe më e pazakontë; në të do të futeshin edhe të tjerë: të rinj e të vjetër; do të shtyhen si delet kur ua çel derën e vathit dhe gëlojnë nga lugjet me kripë!

Gjuha e Bimorja është e ngjashme me gjuhën e urtive të moçme, e fjalëve që nuk harxhohen, por ndriçojnë. Ajo vjen nga tradita e prozës së lashtë shqipe, nga ligjërimi kishtar, nga rrëfimi biblik dhe nga vargu i këngëve të kreshnikëve.

Ky gërshetim e bën romanin unik në letrat tona, një tempull të ndërtuar me gurët e historisë, me erën e dheut dhe me zërin e fjalëve poetike të shkruara me gjak. "Në të ashtuquajturin spital kishte një libër ku regjistroheshin të vdekurit... por emri i tij qëndronte i vetmuar, i palidhur me asgjë."

Ky pasazh nuk është thjesht informatë, kumt; është dhimbje e heshtur, zbrazëti që flet më shumë se çdo fjalë tjetër.



2. Në horizontin më të gjerë të letërsisë evropiane, Bimorja mund të vihet në një vijë me veprat që nuk janë krijuar për të argëtuar, por për të trazuar mendimin, për të ndezur heshtjen. Ajo i afrohet frymës së Albert Camus, kur ky shkruan për absurditetin e ekzistencës dhe të drejtësisë që mungon; i afrohet Hermann Broch, me romanin Vdekja e Virgjilit, ku fati i njeriut të shenjtëruar përzihet me fatin e perandorive që bien në mëkat. Ashtu si ata, edhe Berisha, nuk e ngut rrëfimin, ai e mban fjalën në dorë si një gur të shenjtë dhe e lë të bjerë vetëm kur toka është e denjë për ta pranuar. Ai e ndjen që fjala është përgjegjësi. Dhe përgjegjësia është gur i rëndë në kohën tonë.

3."Bimorja" është një vepër e ndërmjetme, një urë mes tokës dhe përtejmendimit; në qoftë se romanet e zakonshme ndjekin personazhe, veprime, konflikte të jashtme, ky roman s'ka konflikt klasik, ajo ka dridhje të brendshme, psherëtima të historisë, trokitje të hijes në ndërgjegjen e njeriut.

Kjo e bën romanin një vepër që qëndron në kufirin ndërmjet prozës poetike dhe meditimit, ndërmjet dokumentit dhe mitit.

Figura e Pjetër Bogdanit është arketipi i njeriut që nuk pranon të pushojë edhe në vdekje, një shenjt laik i kombit, që përmes vdekjes, bëhet më i gjallë se kurrë. Portretizimi i tij është si një dritë që ndriçon nga nëntoka, si një rrënjë që thërret mbi dhé.

4.Bimorja është një nga ato vepra që nuk bëjnë zhurmë, por qëndrojnë si një shtyllë në mes të një rruge të errët. Ajo është më shumë një dritare shpirtërore sesa një dritë e menjëhershme.

Kjo e bën veprën një gur të çmuar, si ato që gjenden rrallë në letërsinë shqiptare, një vepër që vjen nga rrënjët për të ndriçuar trungun dhe që i përket një gjysmë-heshtjeje që është më e fortë se çdo britmë. Ndoshta, siç na thotë vetë Bogdani në roman: "Nuk do të më gjeni më në asnjë libër… por do të jem aty ku do të jetë fjala që nuk u shit."

Dhe aty Bimorja ka vendin e vet, në ato pak vepra që nuk i përkasin vetëm një kohe, por asaj që nuk shuhet: kujtesës, fjalës poetike, dhe shpirtit që nuk harron.

VII- Vetëm pas kësaj ndjen se titulli "Bimorja" është një nga ato tituj që nuk e zbulon vetveten menjëherë, por të fton ta mendosh, ta ndjesh dhe ta përjetosh thellë. Është një titull poetik, simbolik dhe filozofik njëherësh, që nuk ka të bëjë me një emër personi, vendi apo ngjarjeje, por me një gjendje, një prani që nuk shuhet, një shenjë që nuk vdes.

1."Bimorja" shfaqet si emër i rrënjës që nuk thahet. Në vetë fjalën "bimorja" dëgjojmë një botë të heshtur që rritet nga nëntoka, një frymëmarrje që vjen nga dheu, si një jetë e dytë që nuk ka nevojë për dritë, por për kujtim. Kjo fjalë e rrallë, në gjuhën shqipe, shënjon diçka që ka lidhje me bimët, me rritjen, me tokën, me procesin e heshtur të ringjalljes.

Në roman Bimorja është trupi i Pjetër Bogdanit i fshehur në një varr të panjohur, që nuk tretet, që nuk pushon, që mbetet gjallë në ndërgjegjen e pushtuesit dhe në frymën e popullit. Trupi i tij është si një bimë e gjallë, që edhe pse i varrosur, nuk pushon së jetuari. Ai bëhet rrënjë kujtese, rrënjë fjale, rrënjë kombi. "Trupi i tij s'u gjet, por njerëzit vazhduan ta ndienin praninë e tij. Si një bimë që rritet në errësirë."

2. "Bimorja" vjen si metaforë e qëndresës dhe e kujtesës, pse bart në vetvete një kuptim më të thellë: atë të qëndresës në heshtje, të ringjalljes së një ideali, të jetës që nuk përfundon me vdekjen; nënkupton se Bogdani, ndonëse i zhdukur fizikisht, ka mbetur në këtë tokë si një bimë e pavdekshme, që u përket malësorëve, kujtesës, dhe vetë gjuhës shqipe që ai e deshi dhe e ngriti në fjalë të shenjtë.

Bimorja është ajo që nuk bërtet, por mbin. Ajo që nuk klith, por lëshon rrënjë në heshtje. Ajo që nuk vret, por rilind." Pra, edhe figura e Bogdanit është një bimë që mbijeton në çdo ndërgjegje të pastër, në çdo këngë që thërret emrin e tij pa e ditur se pse, në çdo fjalë të shqipes që ka ngrohtësinë e gjakut të shkrimtarit që e shkroi atë me dashuri.

Sigurisht që ndokush do pyesë: Përse ky titull në kohën tonë?

Koha jonë ka nevojë më shumë se kurrë për rrënjë të gjalla, jo për simbole të ngrira. Ka nevojë për njerëz që nuk shihen, por ndihen. Për kujtime që nuk shiten, por qëndrojnë. Titulli Bimorja është një thirrje që të mos kërkojmë heronjtë vetëm në monumente, por në nënësinë e gjuhës, në pjekurinë e mendimit dhe në heshtjen e tokës që ruan emra të mëdhenj; është një fjalë që e përmbledh gjithë frymën e romanit: Pjetër Bogdani si rrënjë, si gjuhë, si frymë që s'pushon, si truall që lind për të na mbajtur gjallë.

Sarandë, mars 2024-korrik 2025

ORESTI, HAMLETI YNË PROTO-SHEKSPIRIAN

Nga Orin Maxhari

Përshëndetje lexues. Unë jam Orin Maxhari, shtatëmbëdhjetë vjeç, nga Tirana, në vitin e fundit të gjimnazit. Origjinën e kam nga Pogradeci, ku kalova fëmijërinë me gjyshërit përpara se të kthehesha në kryeqytet për të nisur klasën e parë. Dashuria për leximin dhe shkrimin më lindi herët, kur isha ende fëmijë, nga një zakon i pazakontë: koleksionimi i librave të "Jeronim Stilton". Ajo mani e thjeshtë për kopertinat u shndërrua shpejt në pasion për klasikët dhe mitologjinë, hije të cilat prej atëherë më shoqërojnë dhe të cilave u kthehem sa herë marr penën në dorë.

Detaje të tjera të papërmendura:

lindur më 19 Qershor 2008

Gjimnazin e bëj tek "Arben Broci"

Shpresoj që në të ardhmen të bëhem një prokuror, por pa e lënë asnjëherë pas leximin dhe shkrimin.

I.

Shekuj përpara formimit të mjegullës së dyshimtë e cila do të zbriste mbi kështjellën Elsinor. Nëpër korridoret e pallatit të Atridëve, endej një tjetër bir mbreti. I detyruar të niset sërish drejt shtëpisë së fëmijërisë gjithashtu për të marrë hakun e babait të tij të vrarë. **Në këto kushte rikthehet Oresti në Argos**. Djali i cili zbarkoi i vetëm mbi *"skenën e përgjegjësisë"*, mes një nëne e cila i lutet për mëshirë dhe një babai i cili e thërret nga nëntoka.

Vrasjet e Agamemnonit dhe Mbretit Hamlet nuk ishin vetëm tragjedi familjare ose akte të kryera nga ambiciet personale. Ato përfaqësuan dy ndër tronditjet më të thella në rendin moral të botës së tyre. Në të dyja rastet, përmes vrasjes së atit, ne shohim rrëzimin e figurës së mbretit. Simbolit të drejtësisë, qëndrueshmërisë politike dhe autoritetit "të ligjshëm".

Oresti, në "Koeforet" e Eskilit, kthehet nga mërgimi jo vetëm për të hakmarrë vrasjen e Agamemnonit, por edhe për të rivendosur në shtëpinë e Atridëve (e cila është katandisur në një truall të përlyer me mëkat, incest dhe dhunë) sërish rendin, porositur nga orakulli i Apollonit. Në anën tjetër, Hamleti përballet me një detyrë të ngjashme. Ai gjithashtu merr një urdhër nga përtej varrit, këtë herë realizuar përmes fantazmës së babait të tij, për të ndëshkuar Klaudin, vëllain tradhtar i cili kishte helmuar mbretin (baba të Hamletit), duke uzurpuar fronin dhe martuar me Gertrudën, nënën e Hamletit. Por në vend që të veprojë menjëherë, siç bëri Oresti, Hamleti përfshihet nga një krizë "ekzistenciale". Ai dyshon vazhdimisht mbi vërtetsinë e shfaqjes së fantazmës dhe drejtësisë së një akti hakmarrës. Hamleti nuk e sheh hakmarrjen si një borxh të qartë ndaj rendit hyjnor, pasi rasti i tij nuk ishte i tillë, ajo kohë kishte shekuj që ishte lënë pas. Nën këndvështrimin e Hamletit ajo duhet parë si një veprim i cili kërkon shqyrtim të thellë etik dhe shpirtëror. **Ndërsa Oresti lufton me fajin pas kryerjes së aktit të tij, Hamleti "paralizohet" nga vetë ideja e aktit.** Kështu, në vend që të ecë përpara si një hero tragjik klasik, Hamleti endet në errësirën e pafundë të ndërgjegjes. Gjatë kohës që Oresti i bindet zërit të Apollonit, Hamleti vë në dyshim çdo zë që i del përpara, madje edhe zërin e tij. Kjo pasi Oresti i nënshtrohet një bote ku drejtësia përcaktohet nga perënditë dhe kodet zakonore, ndërsa Hamleti, përkundrazi, sillet në një botë ku "perënditë heshten" dhe njeriu dënohet të përballet vetë me drejtësinë.

II.

Është plotësisht e arsyeshme të shtrohet pyetja nëse e njihte Shekspiri Orestin? A e ndjeu, ndërsa ai po shkruante Hamletin, jehonën e atij biri të mëparshëm që qëndronte mes një babai të vrarë dhe një froni të korruptuar. Ne nuk kemi burime të drejtpërdrejta të cilat mund të lidhin Shekspirin me "Orestian" e Eskilit. Trilogjia në fakt nuk ishte përkthyer akoma në anglisht gjatë jetës së tij, (përkthimi i saj i parë në anglisht nuk erdhi deri në vitin 1815) dhe nuk ka dëshmi që ai të ketë ditur greqisht. Por kjo as nuk do të thotë se miti i Orestit i ka qenë i panjohur për të. Ne mund të themi se historia e Orestit qarkullonte gjerësisht në Europën e Rilindjes, përmes përmbledhjeve latine, përshtatjeve mesjetare, madje edhe tregimeve popullore me ton moral. "Oresti" i Euripidit ishte përkthyer në latinisht dhe përfshihej në programin shkollor të kohës. Shkrimtarët e skenës elizabetiane dhe jakobiane, përfshirë Shekspirin, ishin të përmbytur nga kultura greko-romake, edhe kur e përthithenin përmes "ndërmjetësve" si Seneka, Plutarku apo tekste të llojeve të tjera mitografike. Ankthi moral dhe skeleti dramatik i mitit të Orestit, vrasja brenda familjes, faji, çmenduria, drejtësia dhe rrëzimi i shtëpive mbretërore ishin tashmë të ngulitura në imagjinatën tragjike të epokës. Ajo që ka më shumë rëndësi sesa qasja e drejtpërdrejtë ndaj Eskilit është kujtesa kulturore e mitit të Orestit. Shekspiri mund të mos e ketë lexuar kurrë trilogjinë origjinale, por pa dyshim e njihte figurën e birit që vret nënën, ndjekur pas nga erinjtë. Shekspiri, vetëdijshëm ose jo, mund të kishte hyrë në dialog me logjikën tragjike të "Orestias" edhe gjatë jetës së tij.Të dyja, "Hamleti" dhe "Orestia" (këtu i referohem "Koeforet") fillojnë në një vakum politik, një mbretëri e kalbur që nga maja, dhe të dyja paraqesin hijen e një babai të vrarë që thërret birin të rikthejë rendin.

Por Shekspiri ndahet nga Eskili në një pikë themelore. Atje ku "Orestia" kalon nga gjaku te ligji, nga hakmarrja te institucioni (nëpërmjet themelimit të gjykatës së Athinës), Hamleti lihet pas. Nuk ofron asnjë zgjidhje qytetare. Paraliza morale e princit pasqyron një botë që nuk drejtohet më nga drejtësia hyjnore, por nga pasiguria njerëzore. Nga këtu mund të hamendësojmë se Shekspiri mund ta ketë marrë kornizën e Orestit dhe ta ketë zbrazur nga brenda për ta mbushur me pyetje që grekët nuk i shtruan. Për shembull: Po nëse nuk është e qartë në cilin krahë përket drejtësia? Po nëse fantazmat e ngritura nga varri gënjejnë? Në këtë kuptim, Shekspiri nuk e trashëgon Orestin, por e vendos atë në pikëpyetje. Hamleti nuk është një Orest, as një kopje e shtëpisë së Atridëve. Ai është pasoja e rilindjes së mitit të lashtë në një epokë që nuk beson më tek Olimpi. Nëse Oresti vepron dhe më pas thyhet, Hamleti thyhet para se të veprojë.

III.

Oresti, në pamje të parë, mund të shihet si një figurë më e vendosur sesa Hamleti. Një hero i cili vepron, bindet dhe pranon çmimin e gjakut. Por një vështrim më i thellë zbulon se pas aktit të tij qëndron një plagë psikologjike po aq e thellë sa ajo e Hamletit. Oresti nuk është një vrasës me gjakftohtësi, i verbuar nga detyra. Përkundrazi, përballja e tij me nënën është një moment i dhimbshëm, i cili edhe atë e çan shpirtërisht. Kur Oresti përballet me Klitemnestrën, ajo përpiqet të zgjojë në të kujtimin e lidhjes së lashtë të mëmësisë:

"Ndalo, o bir, nderoje këtë gji
Përmbi të cilin gjumi shpesh të zu
Tek qumështin ty të rriti, thithje."

Por Oresti, edhe pse i lëkundur, më vonë i kthehet me:

"Nuk të vras unë, ti veten ke vrarë."

Ky shkëmbim shpreh përplasjen mes lidhjes së gjakut dhe urdhëresës morale. Konflikt me të cilin përballet edhe Hamleti më pas. Menjëherë pas aktit të vrasjes, Oresti nuk ngazëllohet nga fitorja, por ndiqet nga pamje të erinjëve, hyjneshave të hakmarrjes, pra të një pasqyrë mitike të krizës shpirtërore që vuan Hamleti. Tek Hamleti, kjo zhbërje e brendshme është më e gjatë, më filozofike dhe më moderne në strukturë (sigurisht si pasojë edhe e kohëve të shkrimeve të tyre). Monologët e tij të famshëm (si: "Të rrosh a të mos rrosh/ Kjo është çështja...") janë drama të ndërgjegjes, jetës dhe vdekjes. Ndryshe nga Oresti, Hamleti nuk përjeton thjesht frikën e ndëshkimit apo dilemën e drejtësisë. Ai përjeton tmerrin e boshllëkut, më saktë të mungesës së kuptimit të asaj që mund të presë njeriun pas vdekjes së tij. Njerëzit e lashtë kishin perëndi për t'u bindur dhe orakuj për të ndjekur. Hamleti kishte vetëm mendjen e vet e cila gjat gjithë kohës e "zhbënte". Kjo e ndërlikon edhe më tej pyetjen nëse është Oresti më i vendosur sesa Hamleti.

Interpretimi tradicional, ortodoks ne na thotë po. Oresti vepron, kurse Hamleti filozofon. Ndërsa Sigmund Freud, brenda veprës "Interpretimi i Ëndrrave" e kundërshton këtë tezë. Freud vëren se Hamleti nuk heziton gjithmonë. Ai vret Polonin pa mëdyshje. Në sytë e tij, Hamleti është i pamëshirshëm kur objekti i dhunës është impersonal, ose kur kufijtë moralë janë të qartë. Hezitimi i tij i vërtetë, nuk është racional, por i pavetëdijshëm. Klaudi, vrasësi i të atit dhe burri i nënës, ka realizuar dëshirën e fshehtë të vetë Hamletit, atë që Edipi përjeton në mënyrë mitike. Këtu kemi të bëjmë me dëshirën për të zëvendësuar atin dhe për të fituar nënën. Prandaj, Klaudi për të nuk është vërtet një armik, por një pasqyrë e një dëshirës së ndaluar, dhe një faji të padurueshëm. Nga ky këndvështrim, Oresti mund të duket më i qartë në qëllim, më i vendosur, vetëm sepse bota e tij mitologjike ia lejon këtë. Ai vepron nën urdhrin e Apollonit, me autoritetin e një drejtësie të trashëguar, dhe për një kauzë që mbështetet nga rendi hyjnor. Ironia e madhe qëndron tek fakti se, edhe pse ai kryen një akt më të tmerrshëm, i cili është vrasja e nënës së tij (matricidi), ky akt "legalizohet" nga zëri i hyjnive dhe gjykatësve. Hamleti nuk e gëzonte dot të njëjtin fat, dhe për pasojë vuajti. Aty ku Hamleti mendon shumë dhe vepron vonë, Oresti vepron menjëherë dhe pastaj rrënohet nga pasojat e mendimet mbi të. Njëri e përjeton hakmarrjen si një "dramë e mendjes", tjetri si një plagë që hapet pas aktit final. Por të dy ecin mbi një fije të hollë mes detyrës dhe ndërgjegjes, moralit dhe misionit.

Nëse Hamleti është heroi i parë tragjik i epokës moderne, i vetëdijshëm, i përhumbur e filozofik, atëherë Oresti është i fundit hero mitik që e parathotë atë. Ai është pararendësi i Hamletit, jo vetëm në strukturë dramatike, por në vetë thelbin e tragjedisë së në djali i cili detyrohet të vrasë një familjarë për të rikthyer rendin. Shekuj përpara Shekspirit, Eskili mishëronte brenda Orestit ato vlera të cilat Hamleti do ti bënte të pavdekshme, dyshimin dhe impikimin moral të vrasjes. **Në këtë dritë të re, ai (Oresti) nuk është thjesht një pararendës mitologjik, por një "Proto-Hamlet", si figura e parë tragjike e cila e ndjen peshën e hakmarrjes jo si triumf, por si çarje e shpirtit.**

DANIMARKA HEQ TVSH-NË PËR LIBRAT PËR TË FRENUAR "KRIZËN E LEXIMIT"

Në Danimarkë, një e katërta e pesëmbëdhjetëvjeçarëve "nuk janë në gjendje të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst të thjeshtë". Qeveria daneze ka vendosur të heqë TVSH-në për librat "për të frenuar krizën e leximit".

Pas Republikës Çeke dhe Irlandës, një tjetër vend i BE-së (do të ishte, siç vë në dukje Publishingperspectives.com, edhe Mbretëria e Bashkuar, por ajo nuk është pjesë e Bashkimit Europian) ka vendosur të heqë plotësisht TVSH-në për librat, për të nxitur përhapjen e leximit, si te brezat e rinj ashtu edhe te të rriturit: bëhet fjalë për Danimarkën. Lajmi, natyrisht, është pritur me kënaqësi nga Federata e Botuesve Evropianë (FEP).

Christine Bødtcher-Hansen, e cila drejton shoqatën e botuesve danezë (Danske Forlag), njoftoi vendimin e qeverisë daneze, e cila ka zgjedhur të ulë në zero TVSH-në për librat (ishte 25%, pra bëhet fjalë për një ulje shumë domethënëse).

Ministri danez i Kulturës, Jakob Engel-Schmidt, e arsyetoi kështu vendimin: "Ne duam t'i japim fund krizës së leximit, e cila për fat të keq është përhapur këto vite".

Po, sepse të dhënat (edhe) në Danimarkë janë alarmante, sipas OECD-së. Mjafton të mendojmë se, siç shkruan gjithmonë *Publishingperspectives.com*, në vendin e Hans Christian Andersen dhe Søren Kierkegaard, një e katërta e pesëmbëdhjetëvjeçarëve "nuk janë në gjendje të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst të thjeshtë".

RRUGA E HUMANIZMIT DHE KUJTESA KOLEKTIVE:

Letërsia e Visar Zhitit në Kontekstin Shqiptar dhe Botëror

Nga Dr. Belfjore Zifla (Qose)

Kontributi i Visar Zhitit në letërsinë shqipe përfaqëson një vepër të jashtëzakonshme, jo vetëm në kuptimin e pasurimit të skenës kulturore letrare, por edhe në planin e raportit tonë me ndërgjegjen kolektive, e cila kushtëzon mënyrën se si e perceptojmë dhe ndërtojmë lidhjen tonë me të shkuarën. Në qendër të krijimtarisë së tij qëndron tema e humanizmit, e cila, përmes përvojave të jashtëzakonshme që trajton, kapërthen dimensionet individuale dhe kolektive të përjetimit njerëzor. Përmes një vizioni që shikon përtej vetvetes, Zhiti e konsideron letërsinë si instrumentin më sublim për të shqyrtuar natyrën njerëzore në rrethana ekstreme; rrethana që ai i paraqet me një thjeshtësi të ftohtë faktuale, larg zhurmës dhe retorikës. Kjo qasje e vendos veprën e tij brenda traditës së letërsisë së dëshmisë, ku dokumenti shpirtëror nuk është thjesht një regjistrim i ngjarjeve, por një reflektim i thellë mbi natyrën e dhimbjes, të traumës dhe të përjetimit të përbashkët njerëzor, duke e bërë lexuesin pjesëmarrës në një proces katarsues shpirtëror. Ky reflektim merr një dimension të veçantë kur lexuesi përballet me përvojën intime të personazhit, i cili ndan një përjetim metafizik të librit si mjet shpëtimi:

"Një i panjohur që s'e dija ku ishte e në ishte, po më rrëfente gjëra që s'i dija. Dikush po rrefehej tek unë dikur e unë e dëgjoja tani. Po dridhesha. Libri ekziston dhe kumti i tij qenkësh i mbërritshem. Është vërtetë i shenjtë, siç besonin në mesjetë dhe e kishin si objekt kulti dhe të magjisë. Engjëjt kanë shkruar, shenjtorët, Zoti vetë, pa u shenjtëruan librat. Librat vërtetë shërojnë plagët." (Rrugët e ferrit, f. 170) Ky fragment ilustron qasjen e Zhitit ndaj humanizmit dhe fuqinë e letërsisë për të ndërvepruar me përjetimet shpirtërore të individit dhe kujtesës kolektive, duke e lidhur lexuesin me përjetime transcendentale dhe katarsuese.

Një nga karakteristikat më të dallueshme të krijimtarisë së Zhitit është mungesa e heroit tradicional në kuptimin e fortë të termit. Personazhet e tij nuk janë në radhë të pare as rebelë, as disidentë; ato janë individë që përpiqen të ruajnë një normalitet të brishtë, të vetmen liri të mbetur në kushtet ekstreme të represionit. Kjo e drejtë themelore shndërrohet në subversion, në kufijtë e absurdit janë bie fjala momente ku edhe vetë akti i leximit dhe i shkrimit shihet si kundërshtim me vijën ideologjike. Ky fokus modest, me përulësi dhe afri me të tjerët përbën një thyerje radikale me doktrinën e realizmit socialist, e cila kishte mbushur skenën artistike shqiptare me figura heroike dhe spektakolare. Zhiti, duke shmangur heroizmin patetik, e vendos personazhin e tij në një horizont human, ku kujdesi për familjen, mëshira për të tjerët – përfshirë edhe përsekutorët – dhe kërkimi i çdo forme kontakti njerëzor bëhen baza e lidhjes së lexuesit me veprën, duke e afruar këtë të fundit në mënyrë intime dhe të prekshme. Kjo ndërlidhje midis përvojës individuale dhe reflektimit kolektiv e bën letërsinë e Zhitit jo vetëm një kronikë historike, por një përvojë shpirtërore që synon të depërtojë në dimensionet më të thella të vetëdijes dhe të kujtesës kolektive.

Në nivel intertekstual, veprat e Zhitit evokojnë jovetëm "Ferrin" dantesk, por shfaqen edhe ndikime të dukshme nga Kafka dhe Meyrink. "Rrugët e ferrit" janë të padukshme, lëvizja nga një hapësirë në tjetrën nuk perceptohet racionalisht, ndërsa ambienti i përshkruar është i errët, ngushtues dhe dehumanizues. Përmes këtij peizazhi, autorit i shfaqet mundësia të eksplorojë raportin e individit me pushtetin arbitrar dhe me kohën e deformuar; pamundësia për të perceptuar kohën objektive, zhvendosja e saj në një kohë arbitrare dhe të dhunshme – si kur hetuesit e marrin personazhin në pyetje pas mesnate – e shndërrojnë dimensionin kohor në një mjet torturues, i cili përforcon ndjenjën e pafuqisë dhe të izolimit të individit. Kjo përvojë nuk është metaforike, por një realitet i përjetuar; intensiteti dhe përmasat metafizike e vendosin veprën pranë dëshmive të Solzhenicinit, ku rrethanat ekstreme shërbejnë si mjet për të

përftuar njohje të re, reflektim të thellë dhe mençuri (telegrafi.com).

Përballja e Zhitit me arbitraritetin e pushtetit totalitar e vendos veprën e tij në dialog me përpjekjet më të thella letrare për të eksploruar metafizikën e qenies dhe të ekzistencës, jo thjesht psikologjinë. Siç vëren Hannah Arendt në *Origjinat e totalitarizmit*, dallimi thelbësor i diktaturave moderne qëndron në mënyrën se si terrori nuk godet vetëm të bindurit, por çdo individ në mënyrë arbitrare, duke e shndërruar dhunën në një forcë absolute dhe anonime. Pikërisht kjo përvojë e dhunës arbitrare – ku akuza shkruhet nga duar të padukshme dhe nënshkruhet pa u lexuar – e lidh përjetimin e personazhit të Zhitit me fatin kafkian të Jozef K.-së, duke krijuar një reflektim mbi përjetimet e izolimit, pasigurisë dhe padrejtësisë ekstreme.

Në kontekstin e lexuesit bashkëkohor, letërsia e Zhitit mbetet aktuale, sepse ofron një model të rrallë të ndërthurjes së dokumentit dhe trillimit letrar. Në një epokë ku të rinjtë kërkojnë letërsi që lidhet drejtpërdrejt me jetën reale, veprat e Zhitit demonstrojnë se dokumentimi dhe krijimtaria nuk përjashtojnë njëri-tjetrin, por ndihmojnë në ndërtimin e një reflektimi shpirtëror dhe filozofik të thellë (liberale.al). Ky reflektim nuk bie kurrë në kompromis me të vërtetën historike dhe nuk kthen traumat e së shkuarës në spektakël argëtues; përkundrazi, ai i çon ngjarjet në nivele metafizike dhe ideologjike, duke e kthyer rrëfimin në një përjetim që përfundon në katarsis shoqëror dhe humanist. Kështu, krijimtaria e Zhitit nuk është thjesht një kronikë historike apo një tregim për vuajtjet individuale; ajo është një letërsi e traumës, ku dhimbja personale transformohet në kujtesë kolektive dhe në reflektim mbi kuptimin e përjetshëm të ekzistencës njerëzore.

Nga këndvështrimi i promovimit kulturor, veprat e Zhitit meritojnë një vëmendje të barasvlershme me veprat ndërkombëtare të njohura për përvojën e dhunës dhe traumës, si "Ditari i Ana Frank" apo filmi "Lista e Schindler-it". Për shqiptarët, roli i tij është i veçantë: në një kohë apokaliptike, ai nuk ndalet te kërkimi eskatologjik, por arrin të artikulojë idenë e shpëtimit dhe të rehabilitimit, duke treguar triumfin e jetës jo përmes patetikës, por përmes një rrëfimi të zhveshur, që kalon nëpër ferrin më të errët dhe megjithatë ruan dimensionin e shpresës.

Në kontekstin e letërsisë shqipe, Visar Zhiti është tashmë një autor i kanonizuar, me një krijimtari që sjell elemente inovative në planin formal, struktural dhe narrativ, si dhe në përmbajtje, duke ofruar perspektiva të reja dhe universale. Megjithatë, vepra e tij nuk duhet parë thjesht si pjesë e sistemit letrar kombëtar; ajo përfaqëson dhe inkuadrohet në një kapitull të denjë të letërsisë botërore. Përkthimet e veprave të tij në gjuhë të rëndësishme të huaja, por edhe vlerësimet që ai si personalitet por edhe vepra e tij kane marrë jashtë Shqipërisë, jo vetëm që dëshmojnë vlerën e tij në kuadër kombëtar, por konfirmojnë edhe statusin e Zhitit si shkrimtar të një përvoje që tejkalon kufijtë kombëtarë dhe bëhet zë i kujtesës universale.

Zhiti, V. (1993). *Kujtesa e ajrit* Tiranë: Lidhja e Shkrimtarëve.

Zhiti, V. (1994). *Hedh një kafkë te këmbët tuaja*. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".

Zhiti, V. (1994). *Mbjellja e vetëtimave*. Shkup: "Flaka e vëllazërimit".

Zhiti, V. (2001). *Rrugët e ferrit: Burgologji*. Tiranë.

Zhiti, V. (2012). *Rrugët e ferrit: Burgologjia ime për Spaçin dhe më parë* (Botim i plotësuar). Tiranë: Omsca-1. Open Library

Zhiti, V. (2021). *Dorëshkrimet e fshehta të burgut*. Tiranë: Onufri.

TRE POETË BASHKOHORË GREKË

Ilias Qefallas, Janis Stefanakis, Janis Patilis

Përktheu: Niko Kacalidha

ILIAS QEFALLAS

Që në të gdhirë deborës i këndoj-
në vetminë time.

Ende blasfemon gjyshi im
duke kërkuar ujë atje poshtë nën dhe.

Llojë zogjsh të humbura- ashtu siç
humbasin njerzit dhe burimet.

Kullotë makabre. Tre lopë
qendrojnë duke mbllaçitur gjithësinë.

Nga mali në mal shkëmbinjtë
transportojnë idenë e vetmisë.

Po mirë, si nuk leviz duke ecur
gërthulë, pupëz kërcimtare?

Gjilpërë e artë hëna
plagos dhe përgjak qiellin.

Përse loton o mollë e kuqe?
Për krimbin që ushqej brenda meje.

Rrënkon lisi- druvarët
I prishen simetrinëe majave.

Në rrap mbështetur një jetë-
tani në qymyrin e tij.

Buzëmbrëmje dhe kambana ndjek
heshtjen e mrrolur të përrenjve.

Për të pirë ujë në strehë,
së prapthi varet pëllumbi.

Të gjithë harrojnë-asnjë stërgjysh
nuk është kthyer të na informojë.

Çfarë përfitoi shiu? gjithë ditën
e humbi duke larë dordolecin.

Pashë male që shtrengoheshin
dhe ndanin deborën të përqafuar.

Mos më ikë,mos, nuk i kam konsumuar
ende mënyrat për të të dashuruar.

Poeti qan sa herë
shkruan fjalen hënë.
Pranverë dhe lisat janë mbrehur
për të tërhequr malin drejt fushës.

Vetëm gjethi i hurmasë është
mund të të flasë për ngjyrat.

Me flokët e tyre të qullura
gratë e heshtura që kam dashur.

Vjeshtë-pres shami prej mjergullës
dhe mbështillëm-a më njeh?

Hyra u mbylla-në këmishen time
po kërcejnë sardelet e diellit.

Zogjë të butë-pra në këtë shtëpi
banojnë njerëz të qetë.

Mes gjithë kësaj botë të lulezuar
përse menduam një ferr errësire?

Nga malet e përtejme dërgojnë
retë përshendetje të përzemërta.

Nëse do ta kuptoja se çfarë i thotë shiu
çadres sime do të nisja dhe unë biseden.
Dikur kam ngritur një drurë gjigand
thotë një rrënjë e vjetër e harruar.

U gjakosa, ç' fatkeqësi dhe sonte
i penguar në draprin e hënës.

Bie borë dhe humbasin gjurmat
e lepurit duke ngatëruar gjahtarin.

Le të jetë i vetëm lisi në mal
asnjëherë nuk harroi lulezimin.

Mëngjes, drekë, darkë sytë e mi
fundosen në malet e larmishme.

Mëngjes dimëror dhe u kallkanos
i menduar para dritares së hapur.

Çfarë mirëkuptim-pikëllimin tim
ia thashë një biblbili dhe ai heshti.

O lulekuqe-fenere pranverore
ndriçoni zezonën e jetës sonë.

Pleqëri:dordoleci ngjante me mua
apo unë atij?
Natën mes mollëve të çelura
e harron fare hënën.

Shiko ngjyrën blu, të gjelbren, të kuqen
dhe të gjitha së bashku nëshkruajnë:Maj.

Para se të na marrë dheu
do të na marrin retë.

O dimër- realizo nëse mundesh
që të ftohtit mos bëhet drithërimë.

Çfarë dhimbje-sa këpucë paskan
mbetur boshe në këtë shtëpi.

Si arriti kaq shkreti në shtëpinë time
teksa unë nuk vajtur shkretëtirave?

Më erdhe si vesë dhe më ike si erë.
Tani pse më padit se s' të kam mbajtur?

Në ujrat e turbulluara të lumit
bretkocat vajtojnë të mbyturit e vjetër.

E fshehur në gjethishten e kujtesës
këpus një nga një gjethet për ta gjetur.
O drurë rrënjëthellë, flamujt e dheut
dhe poshtë të vdekurit flamurmbajtës.

Mos u shpërdoro shtegtimeve tha lisi
eja bashkë me mua në shtegun e qiellit.

Dhe prej një peri varet
merimanga që quhet jetë.

Bie shi-bie shumë shi por unë mund
të të thajë menjëherë me frymen time.

Sapo të zgjohesh mos harro të pastrosh
dyshemenë nga ëndrrat që ranë natën.

Zbardhëllon dhe macja ime si kusar
vjen dhe gërvish xhamin e dritares.

Sa me shumë shtohen poetet në treg
aq më shumë poezia fshihet nëpër strofka.

Sytë e tu liqene rënë në gjendje koma-
dridhem mos i prek dhe do më mbysin.

JANIS STEFANAKIS

Gjinkallat psallin
ulliri i bekuar
fryti i gjelbër.

Reja e bardhë
lahet në det
floknajë e kuqe.

Mban erërat
në zemren përqafuar
duke rënkuar.

Mundohet mendja
të vërë stërkëmbësh.
Mbahu zemra ime.

Hënë e zbërdhulet
po ta shikosh thellë:
shndërrohet natë.

Një lumë që
zbret në fushë
dhe laton gurë.

Qielli i hirtë
i zhurmshëm
re të rënda.

Antena totem
pallateve të larta
vjellin gënjeshtra.

Lira vajton
për të përvuajturit
dhe ti po më qesh.

Ve shpatullat
të mbaj retë,
një qiell të tërë.

Errësirë e mpiksur
hijet e njësuara
ujku duke përgjuar.

Përroi i turbullt
kujtimet shkëmbinjve
flasin: mos qa shpirti im.

Krasit fjalet
si ati im
pjergullen.

Mjergulla, shira,
ngrijnë refugjatet
xhamat e turbullta.

Erdhe hëne,
të lyesh çatitë
e bardha.

Hënë vetmitare
e plotë, tragjike
pa poetët.

Flokë të gjata
Shpleksur erës:
rreze drite.

Plak i pastrehë,
i përçartur
i vetmisë tënde.

Pas rebeshit
vështrimi yt
harku i ylberit.

Prite puthjen
porsi qiellin
pas dhimbjes.

Gjasme si për të mos e parë
errësira i hedh vështrime
tinzare dritës.



Jasemini i bardhë
hëna e fshehur
natë erotike.

Fryn erë
shkurre vallzojnë dritës
dhe është natë.

Dallgë pas dallge
terbohet deti
boshatiset hëna.

Dëllinjë, bletë:
diku atje zoti,
banon i vetëm.

Shkruan në murë
si fëmi përcakton
kufijtë e tua.

Gjethet bien
dhe ti rreshqet
në trotuaret e lagura.

Zagushti dhe shira
ujra rrjedhin lumenj
në fytyrën tënde.

Prapë bie shi
xhama të errëta

perde të lagura.

Mace, errësirë
gjethe drurësh përdhe
sipër kalon nata.

Hënë e lagur
do të rri në hijen tënde
nuk e duroj dritën tënde.

Po mbart një maçok
të zi në prehrin tënd
në gjinjtë e përflakura.

Re dhe pluhur
në qiellin e kuq
korba fluturojnë.

Re e bardhë
me litar të zi
do lidh hijen tënde.

Pulëbardhat puthen
shtrirë në barkë lakuriqe
ti vështron djaloshin.

More frymë:
shtrydhe renë
ujë nuk pive.

Re puplore
dielli qendis
emrin tënd.

Fryn veriu
flokët me onde
endin himne hareje.

Gjethe rrapi
levizje ajrore
mes mjergullës.

Druri brenda
shtëpisë mbiu
dhe hodhi rrënjë.

Fshat i shkretuar
muret e mbetura
qypa boshe jehojnë.

Zog i gjunjëzuar
çukit indiferent
vdekjen e tij.

Dallgët puplore
puthin shkëminjtë
dhe pastaj fashiten.

Ylli i detit
në thellësi dergjet i vdekur
peshqit mbajnë zinë e tyre.

Copë shalqini
hëna sonte
gjatë lindjes.

Derë e shqyer
tryezë e përmbysur
mure të vetmuara.

Druri i rrudhur
lëkurë që vdekja
rri duke përgjuar.

Jeta ikën
rriten hijet
e qiparisave.

Kur debora
loton në sytë e tu
kërkon diell.

Zog i vetmuar
cicërin në degë
dhe falë jetë.

A, lulet e mia,
që pa spektatorë
vehten pikturoni.

Hardhuca
është fati i shtëpisë
thonë shkrimet e shenjta.

Lakuriqi i natës
në mes të errësirës
ben rrathet e vdekjes.

Do të bëhem zjarr
tym që të ngjitem
thellësive qiellore.

JANIS PATILIS

Zambak mbaj
Dhe me dheun kam veshur
Engjellin tim

Në lëkurë të zbehtë
Sytë e përflakura
Po më përvelojnë.

Çdo fjalë e jotja
Dhe një dorë tjetër
Që më ledhaton.

Kafshata errësire
Fus në gojën time
Flokët e tua të zeza.

Goja ime e marrë
Eja pra fol tani
Me dy gjuhë

Jashtë robave të tua
Gjirin e vogël ta prek
Dhe ai po më ndjen

Gjiri në pëllëmbë
Kush ed i sa kohë do të duhet
të thithesh prej gotës

Një thagmë e re
Thimthi yt po rritet
Gjishtërijve të mia.

Gjiri i vogël
Ngopu me puthjen time
Që të rritesh

Festat e supeve
Në sqetullat e tua blerojnë
brishtësi të përzishme

Shpërndan pamje
Që të dy sytë e mi
I mbledhin fshehtas

Trup që përkulesh
Dhomën time të vogël
Në muze duke e kthyer

Madje dhe era
Trupin tënd duke fryrë
Në skulptor u shndërrua.

Si një fije letre
Shtypur prej erosit
Përpara dhe prapa

Vetëm pasqyra
Duron pa u thyer
Pamjen tënde

Dhe Janis Ricos
Nëse të shihte lakuriq
Do të ndalonte

Para teje duhet
Një minutë heshtje
Për të gjitha fjalet

Kaq ekzistente
Saqe është pjella jote
Dhe fantazia

Sytë kanë dolë për
Ekskursion në trupin tënd
Shiko se po bie mbrëmja

Bie një shi i imët
Sa të sigurtë që jemi
Në çarçafete bardha

Me dy trupat tona
Një këngë të ëmbël
I themi Himeneut

Vera vjen
Për të mbathur
Sandale të vegjel

Dy këmbët e tua
Simbligade të brishta
Sa mirë po kaloj

Sperma ime shiko
Në kofshen tënde
Se si ndrin e bardhë

Në një divan
Galaktikë e brishtë
Me vrima të zeza

Badëra të zeza
Puthin Dervenakiat
E trupit tënd

Si kamikazh
Mbi trupin tënd të bardhë
Dua të bie

Mbjell pasqyra
Dy sytë e mi të çmendura
Mbase kam për t'i ngopur

Si pesë qena
Mbi ty janë vërsulur
Të pesë shqisat

Sy të haruara
Mendje pa zot
Gjuhë e çliruar

Në doganën e ëmbël
Të gojës tënde
Gjithçka do të hapet

Trendafil
Para prapa karafil
Nga të hyj?

Buzë të brishta
Në gojën dhe gjuhën time
A do të jenë përgjithmonë?

Krater i turbullt
Shumë i vogël dhe brenda
Humbas qenjen time

Gjoks me gjoks
Katër këmbë e duar
Dhe dy kryet

Me sa njomësirë

Vështrojnë tavanin
Dy thembrat e tua

Si kalorës
Rend mbi dridhjet
E vitheve të bardha

Si një bushtër
Leshuar mbi shtrat
Dhe unë i vdekuri yt

Rënë mbi mua
Embël më varrosin
Dy sisat e tua

Zogj të mi të marrë
Që me uzo të zi qerasni
Sqetullat e zeza

Çfarë duan ata
Dy të çmendurit që zihen
Në mes të pasqyrës

Të dy vidhnin
Njëri tjetrin
I dhanë të gjitha

Je vonuar
Nga syri i vogël shikoj
Dhe të gjithë më kanë faj

Drejt mesditës
Në një re të vogël
Paske ngecur

Si flaka
Gjithçka e ben hir
Paçka se vezullon

Je alfa
Beta omikron
Je omega

Si rrojnë fëmijtë
Që mjekët roje
Nuk ta dinë

Vjeshtë e parë
Me kanatet e mbyllura
Ti fle e vetme

Tre flakë të zeza
Kur fle bëjnë fole
Në trupin tënd

Ti fle
dhe mua hëna
po tallet

Hënë e bardhë
Strukur në barkun tënd
Merrmë dhe mua brenda

Siç ka ardhur
Kështu ka ikur
Pa ty vera

Të ikur tani
Nëpër pallate
Sodomasit

Shpirtra të vdekura
Që kanë dhënë shpirt
Në çarçafe të bardha

Është era
Që për kurmin tënd
flet përçart në ranishte

Kaq shumë fole
Dhe unë endem pa stehë
Një zog i vetmuar

Afrohu erë
Me sill zërat e saj
Nga dherat e huaja

Nga pozicionet e tua
Erotike njërin ma fshihje
Mungesen

RAYMOND CARVER
Gënjeshtra

Tregim | Përktheu Ndue Gjika



Është gënjeshtër, - tha gruaja ime, - si mund ta besoni një gjë të tillë? Ajo është xheloze, kaq.» Goditi kokën dhe vazhdoi të më shikonte. Ende nuk e kishte hequr kapelën dhe pallton. Fytyra e saj ishte skuqur nga akuza. «Më beson, apo jo? Me siguri nuk e beson këtë?»

Ngrita supet. Pastaj thashë: "Pse duhet të gënjejë? Ku do ta merrte? Çfarë do të fitonte me të gënjyerën?" Unë isha në siklet. Qëndrova aty me pantoflat duke hapur e mbyllur duart, duke u ndjerë paksa qesharak dhe i krekosur, pavarësisht rrethanave. Unë nuk jam i prerë të luaj inkuizitorin. Tani doja që të mos e kisha dëgjuar kurrë me veshët e mi, që gjithçka të mund të ishte si më parë. "Ajo supozohet të jetë një shoqe," thashë. "Një mike për ne të dy."

""Ajo është një lavire, kaq është! Ju nuk mendoni se një mik, sado i varfër të ishte, qoftë edhe një i njohur rastësisht, do të thoshte një gjë të tillë, një gënjeshtër kaq të drejtpërdrejtë, apo jo? Thjesht nuk mund ta besoni." Ajo tundi kokën, si për të thënë që isha budalla.. Më pas zgjidhi kapelën, hoqi dorezat, vendosi gjithçka në tavolinë. Hoqi pallton dhe e hodhi mbi kurrizin e një karrigeje.

"Nuk di çfarë të besoj më", i thashë. "Dua të të besoj ty."

"Atëherë bëjeni!" tha ajo. "Më beso - kjo është gjithçka që po kërkoj. Po të them të vërtetën. Unë nuk do të gënjej për diçka të tillë. Atje tani. Thuaj që nuk është e vërtetë, zemër. Thuaj që nuk e beson, të lutem."

Unë e dua, dëshiroja ta merrja në krahë, ta mbaja, t'i thosha se e besoj. Por gënjeshtra, nëse ishte gënjeshtër, kishte hyrë mes nesh. Shkova te dritarja, larg saj, larg gjithçkaje..

"Duhet të më besoni," tha ajo. "Ti e di që kjo është marrëzi. Ti e di që po të them të vërtetën."

Qëndrova në dritare dhe pashë trafikun që lëvizte ngadalë atje poshtë. Nëse do të ngrija sytë, do të shihja reflektimin e gruas sime në dritare. Unë jam një njeri i hapur, e tregoj veten. Unë mund ta përballoj këtë. Fillova të mendoj për gruan time, për jetën tonë të përbashkët, për të vërtetën kundër trillimit, ndershmërinë kundër gënjeshtrës, iluzionit dhe realitetit. Mendova për filmin *Blow-Up* të Antonionit, që e kishim parë së fundmi. M'u kujtua libri, biografia e Tolstoit, që qëndronte mbi tavolinën e kafesë, ato që thoshte për të vërtetën, përplasjet që kishte pasur në Rusinë e vjetër. Pastaj më erdhi ndër mend një mik i vjetër, nga shkolla fillore dhe e mesme. Një mik që nuk mund të thoshte kurrë të vërtetën, një gënjeshtar i përhershëm, i pandreqshëm, por i dashur, me qëllime të mira, dhe një mik i vërtetë për disa vite të vështira në jetën time.

U ndjeva i lumtur që e kujtova. Ishte si të gjeja papritur një model, një ndihmë për të kuptuar krizën e tanishme në martesën tonë të deritanishme, të lumtur. Ky mik, ky gënjeshtar me zemër të mirë, vërtet mund të mbështeste teorinë e gruas sime — se ka njerëz të tillë në botë. U ndjeva i lehtësuar. U ktheva që të flisja.

E dija mirë çfarë doja të thosha: Po, me të vërtetë, mund të ishte e vërtetë — është e vërtetë. Njerëzit gënjejnë. Gënjejnë në mënyrë të pakontrolluar, ndoshta pa vetëdije, ndonjëherë në mënyrë patologjike, pa menduar për pasojat. Me siguri informatorja ime ishte një prej tyre.

Por pikërisht atë çast, gruaja ime u ul në divan, mbuloi fytyrën me duar dhe tha:

"Është e vërtetë, Zoti më faltë. Gjithçka që ajo ju tha është e vërtetë. Gënjeva kur thashë se nuk dija asgjë për të."

"A është e vërtetë kjo?" thashë. U ula në një nga karriget pranë dritares.

Ajo pohoi me kokë. Duart nuk i hoqi nga fytyra.

"Pse e mohuat atëherë? Ne kurrë nuk gënjejmë njëri-tjetrin. A nuk kemi thënë gjithmonë të vërtetën mes nesh?"

"U ndjeva keq," tha ajo. Më pa dhe tundi kokën.

"Më vinte turp. Nuk e dini sa turp kisha. Nuk doja që ta besonit."

"Mendoj se e kuptoj," thashë.

Ajo hoqi këpucët dhe u mbështet në divan. Pastaj ajo u ul dhe e tërhoqi pulovrën mbi kokë. Shtriu flokët e i çoi në vend. Mori një nga cigaret në tabaka. I mbajta çakmakun dhe për një çast u habita me pamjen e gishtave të saj të hollë e të zbehtë dhe thojve të saj të rregulluar mirë. Më dukej sikur po e shihja ndryshe dhe në një mënyrë disi zbuluese.

Ajo thithi cigaren dhe tha, pas një minute, "Dhe si ishte dita jote sot, i dashur? Në përgjithësi, d.m.th. E dini se çfarë dua të them." Ajo e mbajti cigaren midis buzëve dhe u ngrit për një minutë të hiqte fundin e saj. "Atje," tha ajo.

"Diçka," u përgjigja. "Pasdite këtu ishte një polic, me një urdhër, besoni apo jo, duke kërkuar dikë që jetonte në korridor. Dhe vetë menaxheri i apartamentit thirri për të thënë se uji do të mbyllej për një gjysmë ore ndërmjet tre dhe tre e gjysmë sepse do të bënin riparime. Në fakt, e kujtoj këtë se, pikërisht gjatë kohës që polici ishte këtu, ata donin të mbyllnin ujin."

"A kështu është?" - tha ajo. Vuri duart ne ije dhe u shtri. Pastaj mbylli sytë, e mërzitur dhe shpupurishi flokët e gjatë.

"Dhe lexova një pjesë të mirë nga libri i Tolstoit," thashë.

"Mrekulli." Ajo filloi të hante arra koktej, duke hedhur njëra pas tjetrës në gojën e saj të hapur, ndërsa cigaren e mbante ende mes gishtave të dorës së majtë. Herë pas here ndalonte për të fshirë buzët me anën e pasme të dorës dhe për të thithur cigaren. Mbathjet i kishin rrëshqitur pothuajse krejt. Palosi këmbët nën vete dhe u ul në divan.

"Si është ai?" tha ajo.

"Ai kishte disa ide interesante," thashë. "Ai ishte krejtësisht një personazh."

Ndjeva një therje në gishta, dhe gjaku filloi të lëvizte më shpejt. Por edhe unë u ndjeva i dobët, gjithashtu.

"Eja këtu, muzhik im i vogël," tha ajo.

"Dua të vërtetën," thashë me zë të ulët, tani mbështetur mbi duart dhe në gjunjët e mi. Pelushi dhe butësia elastike e tapetit më emocionuan. Ngadalë u zvarrita drejt divanit dhe mbështeta mjekrën time në një nga jastëkët. Ajo kaloi dorën e saj nëpër flokët e mi. Ajo ishte ende duke buzëqeshur. Në buzët e saj të plota shkëlqenin grimca kripe. Por ndërsa e shikoja, sytë e saj u mbushën me një pamje trishtimi të pashprehur, megjithëse ajo vazhdoi të buzëqeshte dhe të më përkëdhelte flokët.

"Pasha i vogël, - tha ajo. "Ngjitu këtu lart, buçko. A e besove vërtet atë zonjën e keqe, atë gënjeshtare të ligë? A e besove vërtet atë zonjën e keqe, atë gënjeshtare të ligë? Ja, vendose kokën në gjoksin e mamit. Kështu de. Tani mbylli sytë. Atje. Si mund ta besoje një gjë të tillë? Jam e zhgënjyer me ty. Vërtet ti më njeh më mirë se atë. Gënjeshtra është vetëm një sport për disa njerëz".

* * *

Mjeshtri i të pathënës

Raymond Carver dhe tregimi "Gënjeshtra"

Raymond Carver (1938–1988) është konsideruar një nga mjeshtrit më të mëdhej të tregimit të shkurtër në letërsinë amerikane moderne. Me stilin e tij të përmbajtur, të ashpër dhe të ndjeshëm, ai solli një formë të re të rrëfimit: atë që flet për jetën e zakonshme me një intensitet të heshtur, ku drama ndodh në nëntekst, në gjestet e vogla, në fjalët e kursyera.

Kritika amerikane e ka vendosur Carverin në qendër të asaj që u quajt **"realizmi i ndyrë"** (*dirty realism*) dhe **minimalizmi letrar**, krahas autorëve si Tobias Wolff dhe Ann Beattie. Ai është cilësuar si figura që **ringjalli tregimin e shkurtër** në vitet '80, dhe është nominuar për **Pulitzer Prize for Fiction** në vitin 1989, ku juria vlerësoi ndikimin e tij në formësimin e tregimit si një formë letrare më vete. Përmbledhjet e tij më të njohura përfshijnë *What We Talk About When We Talk About Love* (1981) dhe *Cathedral* (1983), ky i fundit konsideruar si kulmi i artit të tij.

"Gënjeshtra" është një tregim i shkurtër, por i ngarkuar me peshë emocionale. Në këtë tekst, Carver eksploron natyrën e së vërtetës, besimit dhe gënjeshtrës, jo si koncepte abstrakte, por si përvoja të prekshme, që ndodhin në dhomën e ndenjjes, mes cigareve, librave dhe një dritareje ku pasqyrohet fytyra e dikujt që nuk di më çfarë të besojë.

Ky përkthim përpiqet të ruajë ritmin e brendshëm të tregimit, tensionin dhe nëntekstin, duke sjellë në shqip jo vetëm fjalët, por frymën e Carverit — atë që flet më shumë kur hesht.

Përkthyesi



XHENI SHEHAJ

Ne, banorët e ishullit gri

Tregim

Të shtunën, kafenë e pasdites e piva tek plaka e Gjonajve. Jo se kisha dëshirë të pija kafe me të, por ime më këmbëngulte që herë pas here të shkoja te plaka Shano që të më shihte filxhanin, se helbete vajta tridhjetë e ende nuk po dukej gjë në horizont. Nëna, sa herë vija nga rituali i filxhan parjes priste ti jepja ndonjë lajm të mirë, lajm të tipit: kam një rrugë për të bërë. Rruga për time më ishte rruga e nusërisë.

Edhe atë të shtunë, nënë Shanua pasi lexoi gjithë ç'kishte brenda filxhani, më tha:

- Çupëë! Ke një rrugë, të afërt. Të tjerat janë gjepura

Unë si përherë vura buzën në gaz, pagova, dhe mezi prita të dilja jashtë. Rrugës për në shtëpi mendoja fjalët e plakës. Të them të vërtetën nuk i besoja këtyre ritualeve, por në disa raste edhe kishin dalë ca gjëra. Për shembull, kur fallxhorja i lexoi nënës në filxhan se e shihte të veshur me të zeza. Në krye të tri ditëve, xhaxhai i nënës vdiq. Apo kur i tha fqinjës sime se do martohej me atë që donte, ia gjeti dhe me emër. Por mua, në gjithë ato tri - katër herë që kisha shkuar nuk më kishte gjetur gjë. Ndaj dhe nuk e besoja por shkoja vetëm për t'i bërë qejfin nënës.

Në shtëpi gjeta vëllain dhe nënën që diç po gatuante. Im vëlla, kish vënë përpara një tas përshesh me kos dhe hante si i babëzitur. Për ta ngacmuar i thashë:

- Mos ha ashtu se do na turpërosh. Shumë shpejt do bëhesh kunat.

Ai çapëleu gojën (as që e kishte idenë se ç›po i përrallisja) ndërsa nëna u kthye vrik, fshiu duart në përparëse dhe me sytë xixëllues më pyeti:

- Rrugë? Lexoi rrugë Shanoja në filxhan?

Mua më vinte për të qeshur por dhe nuk doja ta lëndoja nënën, ndaj i tunda kokën dhe u ula. Eh, veç ta shihnit se ç›gëzim pushtoi qenien e nënës sime.

Epo, nuk i thonin gjë e vogël, ti martohej çupa 30 vjeçe.

Kaloi java, shendi i sime mëje ende nuk ish zbehur. Fallxhorja kishte thënë së shpejti, edhe një muaj, dy, tri shpejt janë. Prisnim.

Të martën vëllai erdhi herët në shtëpi. Ishte i zbehtë, i frikur. Mendova mos kish bërë fjalë me njeri. U ul, ma bëri me shenjë ti afrohesha. U ula pranë tij.

- E di çka ngjarë? - më pyeti.

-Jo.

- Dëgjova në kafene se ata emigrantët që kanë ardhur tek ne paskan sjellë dhe një sëmundje. Kishte zënë Tikun, Tikun e Bedriut. Ka dy ditë që nuk del, s'bëhet i gjallë. Doktori i shkon në shtëpi. Paska thënë që qenka ngjitëse.

- Edhe kjo duhej. Po si i bëhet? Nuk ka derman? - pyeta vëllanë.

- Se di. Do shkoj njëherë te berberi se do qethem. Të shoh se ça mund të marr vesh aty.

Kaq tha dhe doli. Unë mbeta ulur me mendjen tek rruga që parashikoi fallxhorja për mua.

Mos do më zinte sëmundja dhe do merrja udhën e vdekjes?

***

Epidemia shpërtheu fuqishëm ditët në vazhdim. Njerëzit sëmureshin njëri pas tjetrit. Mjekët nuk po mundnin të gjenin zgjidhje. Spitalet plot, kishat plot, shtëpitë plot. Ishim mbyllur në shtëpi dhe dilte vetëm im vëlla për ndonjë gjë të ngutshme. Nëna qante orar pa orar. Unë ndihesha e trembur por prapë se jepja veten. Darka na mblodhi rreth televizorit. Nuk flitej për gjë tjetër veç epidemisë.

Mëngjes. Trokiti dera. E hapi nëna. Dy burra, mjeku dhe një furgon i izoluar. Duke ruajtur njëfarë distance, mjeku nisi të shpjegojë rregullat që kishte nxjerrë qeveria. Nëna as që përpiqej ta dëgjonte. Para se të ikte, ai i la në dorë një letër ku ishin shënuar disa pika. Nëna mbylli derën, e lëshoi letrën përdhe dhe u mbyll në dhomë. E mora letrën dhe nisa të lexoja.

"I/e nderuar qytetar!

Në qytet ka shpërthyer epidemia ose siç njihet ndryshe Ethet gri. Po përhapet me shpejtësi dhe i sëmuri ka këto shenja:

- temperaturë
- flet përçart
- të vjella
- ndihet as në qiell, as në tokë
- qan ose qesh
- dridhet
- bëhet i dhunshëm
- ka dëshira vetëvrasjeje

Do ju lutemi, që derisa gjendja të stabilizohet disi të qëndroni në shtëpi, qetë, pa panik. Në rast se një familjar ka ndonjë nga këto shenja atëherë duhet të raportoni duke telefonuar në numrin 003. Menjëherë do të vijë një staf i gatshëm për ta marrë të sëmurin. I sëmuri do të izolohet bashkë me të sëmurë të tjerë. Në këtë mënyrë po përpiqemi të parandalojmë përhapjen. Ju falenderojmë për bashkëpunimin!"

E rilexova letrën dhe fiksova në mendje çdo simptomë. Tashmë isha tërësisht e panikosur.

Pasdite kur nëna doli nga dhoma nisa ti flisja për përmbajtjen e letrës. Vëllai kishte kryqëzuar duart e më ndiqte me vëmendje. Mbrëmja kaloi në heshtje. Kaluan në gjendje ankthi dy ditë.

U zgjova e mbytur në djersë. Jashtë ishte errësirë e plotë. Në dhomën ngjitur flinte im vëlla. U ngrita ngadalë, hapa derën dhe dola. Dera e tij ishte pak e hapur, ai flinte qetë. Nga dhoma e nënës dëgjohej tik taku i orës. Dola në oborr. Në grykë ndjeja një shtrëngim. Kisha frikë të merrja frymë normalisht. Më dukej sikur do të mbytesha. U ula tek shkallët por nuk po gjeja rehat. Befas, më erdhi të bërtisja, ta ngrija vendin më këmbë. U tremba. Preka fytin me duar, kapa flokët, fillova të numëroja deri në dhjetë. E ndieja veten në ajër, pa peshë, pa kurrgjë.

Prit... pa dale. Si ndihem kështu. As në qiell, as në tokë. Ku e kisha dëgjuar këtë? Ku?

Letra! Ndjesia sikur je në ajër, e kisha lexuar tek letra që solli mjeku. O Perëndi! Kisha marrë sëmundjen. Me të zbardhur dita, do vinin të më merrnin. Jo, nuk do vinte njeri. Vetëm nëse do i lajmëronte dikush. Po as nëna, as vëllai nuk e dinin, edhe po ta dinin ata nuk do tregonin, nëna do kujdesej vetë për mua.

Me këto mendime në kokë, me ndjesinë se nuk shkelja tokë u futa brenda. Nxitova për në krevat.

Mëngjesi erdhi dhe bashkë me të edhe një tjetër shenjë e sëmundjes. Isha mbyllur në banjo dhe po nxirja gjithë ç'kisha në stomak. Kur dola pashë nënën dhe vëllanë tek më prisnin. Të zbehtë, të trembur, ata m'i kishin ngulur sytë përvajshëm.

Iu afrova nënës dhe duke sajuar një buzëqeshje i thashë se nuk ishte asgjë. Buzët i dridheshin. Teksa më shihte në sy, largohej pa u ndjerë prej meje. Ajo kishte frikë. E ndërsa ne dialogonim me sy me njëra - tjetrën, vëllai pa u menduar dy herë i kishte rënë 003-shit. Sapo e kuptova se çfarë po bënte ai u bëra si bishë. Iu vërsula me vrull, e shtyva dhe nisa ta godisja.

Nuk më kujtohet se çfarë ndodhi më tej. U përmenda në një kapanon, rrethuar nga dhjetëra njerëz, të njohur e të panjohur. Afër kisha një vajzë që dridhej si ta kishte zënë korrenti. Pak më tej dikush çirrej e thërriste se do vriste veten, një tjetër fliste përçart.



M'u mor fryma. Nxitova jashtë. Ku dreqin jam këtu? Hodha sytë rreth e qark. O Perëndi! Ndodhesha, ndodheshim në një ishull. Na kishin degdisur në një ishull. Larg nga familjet, nga shtëpitë, nga gjithçka. Sërish marrje fryme. Paniku kish mbërthyer qenien time. Mendimi im i parë, të mbytesha. Një hedhje drejt e në ujë. Oh, mendim vetëvrasjeje! Sëmundja po përparonte. Prek qafën, flokët, buzët, 1, 2, 3, 4, 5, merr frymë. Oh, s'mundem, jo nuk e bëj dot. Po mbytem. Jo, jo!

Hap sytë. Jam shtrirë, më saktë më kanë shtrirë në një shtrat druri. Mbi kokë qëndron një plak, vajza që dridhet dhe një djalë me fytyrën tërë puçrra. Plaku më sheh drejt e në sy dhe ende pa hapur gojën unë ai i përgjigjet pyetjeve të mia:

- Ndodhemi në një ishull. Jam Ashiku, ndër të parët që sollën këtu. Jemi shumë njerëz, të gjithë të sëmurë. Ty të sollën dje. Kemi ushqim, ujë, krevate. Jemi të sëmurë por kemi edhe detin, edhe qiellin, edhe njëri - tjetrin. Në ishull nuk ka asnjë doktor apo tjetër njeri që të kujdeset për ne. Kështu që, ne ndihmojmë njëri - tjetrin, si dhe sa mundemi. Mirë se erdhe në ishullin gri e dashur!

Këto tha plaku dhe shtoi edhe një buzëqeshje, gjë që më xhindosi. Nuk u përmbajta dhe iu shkreha atij:

- Po si mund të jesh kaq i qetë, ë? Na kanë izoluar, mbyllur, dënuar këtu dhe ti flet sikur jemi për pushime.

Plaku, për çudi nuk u trondit. Ashtu buzagaz, ma ktheu:

- Epo boll më dha Perëndia sëmundjen, përse ti shtoj vetes edhe mërzinë? Pse ta mbush shpirtin me trishtim. Merre jetën si të vijë.

Më përshëndeti me kokë dhe u largua. Djali me fytyrën me puçrra e ndoqi pas. Ndërsa vajza me dridhje më shihte me përdëllim. Më vinte të ulërija.

Kaloi java, shenjat e sëmundjes po zbeheshin. Ndihesha më pak e këputur, por netëve vazhdoja të kisha ankth, frikë. Isha miqësuar me disa nga banorët e ishullit. Ditën e kalonim duke u kujdesur për të sëmurët, gatuanim, pastronim. Ishim bërë si një familje e madhe. Kishte pleq, të rinj e të reja, fëmijë. Çdo ditë që kalonte ne lidheshim më shumë me njëri – tjetrin. Përjetonim çdo dhembje, hidhërim, gaz të sho-shoqit. Kisha nisur të ndieja një qetësi shpirtërore që kurrë më parë s'ma kishte mbushur shpirtin. Ndoshta e kisha ndarë mendjen që ta vazhdoja jetën aty, në ishull.

***

Një vit e dy muaj jetesë në ishullin gri. Shumë prej banorëve vdiqën gjatë atij viti. Varrosa me duart e mia Olin dhe Kenin, binjakët 6 – vjeçarë; vajzën që dridhej, plakun Ashik dhe shumë miq të tjerë. Ata, me të cilët vdekja tregohej e pamëshirshme, detyroheshim t'i hidhnim në det, ndërsa të tjerët i varrosnim në varrezën e ishullit, një vend i vogël, me pemë, i qetë e i këndshëm. Tashmë në ishull kemi mbetur shumë pak. Epidemia duket se është rralluar ndjeshëm edhe në qytet. Muajt e fundit sollën njëzet e shtatë të sëmurë. Të rinjtë u mësuan shpejt me regjimin ditor të ishullit. Prej tyre mësuam se epidemia ishte në rënie dhe në qytet flitej se shumë shpejt do vinin të na merrnin e të na kthenin nëpër shtëpitë tona. Disa prej banorëve mezi po e prisnin këtë rast.

Sa për vete nuk dëshiroja aspak të kthehesha. Nëna dhe vëllai më kishin braktisur në çastin tim më të vështirë. Po ashtu dhe një pjesë e banorëve të vjetër të ishullit nuk donin të ktheheshin. Dhe në fakt nuk vonoi shumë derisa në ishull erdhi një varkë me disa persona. Ata zbarkuan dhe na mblodhën për të folur. U ulëm rreth e qark dhe dëgjuam me vëmendje diskutimin e tyre. Kishin ardhur për të na marrë. Qyteti tashmë ishte i sigurtë dhe ne mund të ktheheshim pa frikë. Banorët pas diskutimit u ndanë në dy grupe: ata që ishin gati të niseshin dhe ata që nuk donin të largoheshin. Unë bëja pjesë tek grupi i dytë. E kështu ndodhi që mbeta në ishull, bashkë me shumë të tjerë.

***

Dje bëra pesë vjet në ishull. Thuajse çdo dy – tri muaj varka vjen, zbarkon, na pyet, merr ata që duan të ikin dhe kthehet pa zhurmë. Por janë të paktë ata që largohen. Jeta jonë tashmë i përket ishullit. Nuk bëjmë dot pa zhurmën e dallgëve, perëndimet e magjishme, mëngjeset plot diell, qiellin mbi kokë, shiun kur zbret në det. Dje, në pesëvjetorin tim në ishull, rastisi të vinte dhe varka. Sapo njerëzit brenda zbritën, unë e lashë bisedën me Drinin, të dashurin tim, dhe nxitova drejt tyre. Drini u zbeh. Më kapi dorën duke më ndaluar.

- Mos ke ndërmend të ikësh? – pyeti i trembur.

- As që e çoj nëpër mend, - iu përgjigja. – Dua vetëm t'u lë një porosi.

Iu avita personelit të varkës, i përshëndeta dhe i pyeta për Shano Gjonajn nëse jetonte. Njëri prej tyre, më i vjetri, më tha se po, fallxhorja ishte gjallë. Kaloi epideminë më këmbë, mbushi 101 vite, pak e kërrusur por sheh ende mirë nga sytë. Më gëzoi lajmi se plaka rronte ende. Hoqa nga qafa kristalin tim turmalinë dhe ia zgjata burrit.

- Këtë do ia japësh në dorë Shano Gjonajt. I thuaj se ta ka dërguar vajza e Rumanejve. Vajza që kohë më parë i pe filxhanin dhe i gjete një rrugë. Të doli fjala nënoke ti thuash. Vajza e mori rrugën, të gjatë, të gjatë.

Burri mori varësen, më premtoi se do ta çonte porosinë time gjallë a vdekur. Dhe e kishte çuar. Pas disa muajsh, plaka më kishte nisur me varkën kuleçë, djathë, mjaltë dhe një libërth falli.

Ditët i kaloj duke lexuar librin. Ndoshta, një ditë, do të bëhem fallxhorja e ishullit gri. Banorët po shtohen, qëkur gratë e burrat kanë nisur të kokolepsen me njëri – tjetrin, po shtohemi. Ku i dihet, mbase do kenë nevojë për parashikimet e mia. Uroj vetëm t'i kem të bardha si bora e maleve e të ëmbla si mjalti.

ODISE KOTE

Burrat e mirë kthehen ...

Poezi

1- O pylli me ferra ...

O pylli me ferra, boronica, manaferra,
ku këndon gushkuqi e fishkëllen era.
Qeshin ca çapkëne, çmenden ca leshprera,
rroku – rrokulilsen përmbi luleshqerra,
buçasin në vena ndjesi të pandjera.
Vijnë ca miturake, ikin ca të tjera,
fustane të kuqe, fustane të verdha,
grisen dekolte, shqyhen ca dantella,
në furi aromash, def - dëfren hareja.
Hypin maje pishash edhe laureshat,
ujëra kristali bredhin në rrekezat,
rreze diellore,
eh gjethe lëpjetash,
pasqyra të bujshme ...

shpirt i shpirtit ti o pylli me ferra,
shtrëngatë e padukshme ...

2- Luftën e fituam ...

Luftën e fituam! Më mirê mos kish nisur fare.
Në samit dinak ushtoi bori fituesi.
Bota egërsuar krejt, u bë mê barbare,
Si nê epokën e gurit, gjahut, papirusit.

Luftën e fituam! Po paqja nuk duket askund,
Na thanë:paqja po vjen, arrihet, duhet të ecim!
Në lumenj gjaku, në psike, furi e luftës s'humb,
dhimbja e plagëve bën të flasë dhe memecin.

Luftën e fituam! Tani është kohë e mirê pazari,
dhe pse të rënët nuk kanë një kryq e një varr.
Kërkuan: duhet ta nisni me harresën së pari,
kujtimet e së shkuarës gjithnjë marrin hak ...

Luftën e fituam! Më mirë mos kish nisur fare!

3- Fotografi

Si mund të rrijë foto e trishtuar në mur, gjumi mërgon,
i merr me vete të gjitha pendimet dhe ikën të flerë.
Dhimbje e pabesueshme, mëri e zotit si flakë përvëlon,
venat e gjakut në fije zjarri, ngjiten lart, lart në qiell.

As adoleshentë me sy te nxirë, nuk kam parë nëpër dhoma,
është si t'i japësh dikujt që s›e do, një libër të keq.
Le t'i presë më vonë të gjithë drurët e kujtesës koha,
gjurma e dhunës mbetet muranë kulti për dreq.

Kurrsesi nën varëse floriri, qafat e nxira, me shenjat mavi,
nuk zbukurojnë sallone, as dhoma muzike më tutje.
Ato nuk e zhbëjnë dot të bërën, as murgj e priftërinj,
në meshëzat private ku derdhen mijëra fjalë e lutje.

Kudo ka vetëm fotografi që shkëlqejnë, çmim' i heshtjes,
rrëfen atë që rri fshehur, të vërtetën a enigma terri.
Magjepsje pas origjinës a të përpjeta protagonizmi,
në sezonin kur nocion' i së rremes është bërë qytetar nderi.

4- Nënëmadhja ...

Pëshpërit Nënëmadhja; veç ëndrrës së natës,
retë edhe shiu janë më afër Parajsës.

Retë edhe shiu janë më afër Parajsës,
bëhu lundërtar, kapiten i varkës!

Bëhu lundërtar, kapiten i varkës,
jeta është me dallgë, me shkëmbinj të ashpër.

Jeta është me dallgë e shkëmbinj të ashpër,
fije e hollë e ndan, Ferrin me Parajsën ...

Fije e hollë e ndan, Ferrin me Parajsën,
retë edhe shiun nga ëndrrat e natës ...

Historia nuk eshte sentimentale.
Sentimentale jane budallenjte e kohes.

5- O lum lumi ...

Kam lindur në fshatin e vogel ndanë një lumi
dhe si lumi kam vërshuar papushim,
o lum lumi.

Nuk jam rrjedha që shkon kuturu,
më frikeson ëndrra që është e mjaftueshme,
ëndërrimtar i padorëzuar kurrë,
o lum lumi.

Jam rrokullisur nëpër shkëmbinj e gurë.
Por do të vijë një dite që ndryshimi,
e di që një ditë ndryshimi do të vijë,
o lum lumi.

Udhët do të ndahen, siç ndahen idetë,
se udhëtar jam, dhe një lundërtar,
që çdo ditë zbuloj një lumë të ri
brenda shpirtit tim,
o lum lumi.

Se paqja arrihet vetëm përmes ndalesës...

6- Mahnitja ...

Kohët ikën larg, ti mbete prapë Mahnitje.
Ç›alkimi biblike e ngjiz atë nur?
Herë shfaqesh si dritëz gjasme në fikje,
herë vetëtimë që zemrën ma sëmur.

Kam dashur të harroj, nuk dija se si,
nuk gjeta asnjë lutje, mesazh apo psalm.
Shkenca e dorëzuar krejt në pafuqi,
mahnitja nuk spjegohet dot me fjalê.

Më ka ndjekur pas dhe kur jam rrëzuar,
kur askush si ndjeu frakturat e plagët.
Ajo ish aty - qepallë përpëlitëse,
që fliste e ndizte pasionet e flakët.

Edhe i ciflosur, brisk e trishtim,
sulmuar prej vulgut, nga e parëndësishmja.
Vendosur si mullagë aty për shërim,
qe gjithnjë ajo, shpëtim - Mahnitja.

Gjithë jetën pyeta: a ka shpirt Mahnitja?
Ç›alkimi biblike e ngjiz atë nur?
Herë shfaqesh si dritëz gjasme në fikje,
herë vetëtimë që zemrën ma sëmur ...

7- Frashër o Frashër ...

Sa nevojë kemi të të shohim çdo ditë,
por ti je larg, larg, gati i paarritshëm,
si një meteor në lëvizje.

Ti je atje mbi male, atje dhe shtëpia.
Ku mund të ishin tjetër përveçse atje,
Abdyli, Naimi dhe Samiu - tri majëmale,
dhe ëndrrat tona të pamjaftueshme ...?

Dua t'i takoj çdo ditë, po s'mundem,
pasi rritemi duke u rrëzuar,
vdesim duke qëndruar poshtë,
dhimbja është gjuha e heshtur e braktisjes.

Pa rrugën që të shpie atje sipër,
e nesërmja nuk është e sigurt.

E vetmja dëshirë e vërtetë që përvëlon,
është një dorë për t'u mbajtur...

Mos e vrit mendjen ku të çon ajo rrugë,
Kujdesu vetëm për hapin e parë,
ndërsa Shqipëria mendohet ende ...

8- Një qytet ku të bjerë dëborë ...

Reporterët u ndalën tek një fillikat,
djalkë nëntëvjeçar, me një gjymtyrë më pak,
(parakrahu nën fasha kullonte akoma gjak)
CNN, BBC, ZDF, me rradhë.

E pyetën për të kuptuar mistikën e ferrit,
psikikën e fëmijës të cfilitur, shpresëvrarë,
prej Moisiut apo Muhametit:
A ke një dëshirë, një ëndërr të zjarrtë?

Djalka nuk tha: të pushojë lufta në Gazë,
as të ketë ujë e ushqim për çdo vakt,
psherëtiu thellë si të qortonte Sinain,
dhe ata qe poshte endrrave vene zjarr.

Për t'i treguar botës formulën e ribërjes:
„Dëshiroj një qytet ku tê bjerë dëborë, tha,
me drita, muzikë e festime pa cak,
ku të luajmë të gjithë bashkë..."

Diç të ngjashme me përrallat e Andersenit,
me jetën në Suedi, Finlandë e Danimarkë ...

9- Labova e Kryqit ...

Pa më ftuan tulipanet, luleboret
në sheshin e Kishes,
atje, ku njëmijë e gjashtëqind vjet më parë,
perandori Justinian vu kurorë me Theodhorën.

Me ftuan në një valle vashash
me fustane ngjyra - ngjyra,
që shkëlqejnë diellit e shkasin gishtrinjve,
dhe shenjtëria më mori gojën e ia dha bukurisë.

Këtu perandori Justinian solli Kryqin
dhuruar në Romë prej Justinit, larë me ar,
me drurin e shenjtë të kryqëzimit,
Jezu Krisht,
as tridhjetë vjet ngjitur lart në qiell.

Kercej me vashat, hedhim valle marramendese,
rrotullohemi fugë,
në Laboven e Kryqit, mbi pëllëmbë të malit,
me ujra, burime e rrëkera dëbore,
me ftonj, arra e hije,
pemë, bashtina, vreshta pjellorie.

Dhe drita që mbi fytyrat tona bie,
ketu është tjetër dritë ...

Hajde mos e merr këtë dritë me vete,
që ta kesh deri sa të vdesësh.
Në qafë paç veten...!

10- Lermë të iki ...

Lermë të iki, të largohem,
kur të bjerë dëborë e parë.
Nëpër lugje, nëpër kroje,
në dhjetor a në janar.

Pas gabimesh do të kapem,
që të tretem pak e pak.
Të gjej shpirt e fije shprese,
të bie si lis i thatë.

Di që kjo e fundit herë,
kullon dhimbë e kullon gjak.
Pelegrin derë më derë,
i harruar, vetmitar.

Do lexoj çdo peng në gur,
veç me ujë e bukë thatë
do dëgjoj çdo zë në mur,
do të fle si murg i ngratë.

Do të fle si murg i ngratë.
Të betohem që s'do flas!
Si një libër lart në raft,
vetëm nëse s'do pëlcas...

Lermë të iki, të largohem,
kur të bjerë dëborë e parë.
Nëpër lugje, nëpër kroje,
të harrohem si një psalm.

11- Lumi i kësaj vere ...

Lumi i kësaj vere është përmbledhur
keqas,
duke humbur befas, lozonjëri e hire,
në ca të vogla, gjire e ngjire.

Humbën delta e rrjedha,
triumfe të mjera,
sikur i janë vënë pas një dredhie,
të shijojnë brengën e mëkatit,
që çarmatos fatin.

Po e çuditshme dashuri e peshkatarëve,
shtuar shpirtrash, kushedi prej çfare,
me fijet e një sage,
që i heq nga lista e vetvrasësve,
me pasion shkretëtinor.

Orë të gjata hutie, në brigje vetmie,
me adhurim çmendie,
(soditja e zogjve falas)
në muzgje e netët e gjata,
ku gërhasin metamrfozat dhe gjinkallat,
në ankth të padurueshëm...

12- Burrat e mirë kthehen ...

Jo gjithmonë burrat e mirë kthehen
ngadhnjimtarë,
ka erë fshikulluese fusha dhe baltë
tejendanë.
Kodrave me kamxhik shtrengate rrihen
muzgjet,
dhe pengjet ulërasin si ujqër të bardhë.

Plag' e mahisur bën gjumë si deti n'zheg
t'verës.
Jo gjithmonë burrat e mirë kthehen
ngadhnjimtarë.
Si lulja që sjell gaz, fshehur aty midis
ferrës,
drita e shpirtit dhe jo erresira, lë errësirën
pas.

Jo gjithmonë burrat e mirë kthehen
ngadhnjimtarë.
Çfarë thotë botë e fabulës për paqen që
flijohet?
Homeri shkruan: paqja do luftë më shumë
se një dekadë,
ku vdesin gjithë të dashurit e Troja
shkrumbohet.

Lumturi e kulluar ekziston veç në
plastikën rozë,
në këtë botën tonë të papërsosur e tinzare.
Burrat e mirë, ngadhnjimtarë nuk kthehen
gjithmonë,
e paqja ngjan fantazi e lindur nga lëndë
tradhëtare.

Nuk kthehen gjithmonë ngadhnjimtarë
burrat e mirë,
harrojnë urrejtjen, dashuria bën diçka të
tillë ...

13- Ujvara e ujit të mirë ...

Ç'fuqi e shkuli atë brinjën e malit,
lumi mbijetesës, kalë - revan u nis.
Ç'dhimbë e bujari, dhuratë e natyrës
trill, si një algoritëm futurist.

Ujë i mirë, larë në njëmijë zaje,
kurora dhe trupi lëshuar në gremina,
U tund krejt toka kur doli dhe qau,
ajo bukuri nga shpellat tektonike.

Ujvara e ujit të mirë, atje në Fterë,
trill, si një algoritëm futurist.
Aktet e përjetshme në sakrificë e skaj,
u bëkan gjithnjë për hir të dashurisë ...

FRANO KULLI

Fletëkampi

Tregim


Portret nga Pashk Përvathi

Ka qenë vera e vitit 1990. Pesëmbëdhjetëditëshi i parë i gushtit.

Ne me dy fëmijët tanë dhe kunati, Angjelini, vetë i katërti me të vetët kishim zanë një kabinë në plazhin e Shëngjinit. Kishim ba gati rropullitë që duheshin, pjata e tenxhere, lugë e piruj, ushqimet e lana mënjanë për këto ditë; aq mish, djathë e burofresko sa kishim mujtë me kursye prej kater pesë tollonave[1] të fundit, perimet e freskëta nga kopështi i shpisë, aq sa mund t'i rezistonin vapës së gushtit e kishim marrë trenin , që nisej nga Shkodra heret në mëngjes. Ashtu rrezgabezga[2], sikur do të na e zinte dikush atë furrikun kabinë ku do të përmblidheshim për pesëmbëdhjetë ditë tetë frymë, që mezi e kishim gjetë e ia kishim pague paret.

Simoni me Luçien, që shkurt e thirrshin Luçi, kishin një javë që kishin zanë vend te kampi i Punëtorëve. Në Shëngjin kishte dy kampe pushimi, oborret e jeshilueme të të cilëve ishin ngjitë e ngjitë; ai i puntorëve dhe ai i pionierëve. (Kampe quheshin asokohe shpitë e pushimit, njëlloj si vendvuajtjet e dënimeve për të burgosunit). Ishin burrë e grua. Luçit i kishte ra me ndejë në dhomë me një grua dhe Simonit me Rrustemin. Ashtu kishin mujtë me i gjetë fletët e kampit, veçmas. Luçi, bante si bante; ajo ishte mësue gjithmonë me njerëz gjithëfarësh e familjarizohej gjithësesi, po për Simonin ishte tjetër gja. Bashkëbujtësi i tij për këto ditë pushimesh ishte krejt i përkundërti i tij. Ai kishte qenë e, ende aty gjindej, në një zyrë hijerandë të qytetit, ku përziheshin e luheshin fate njerzish. Por, si i mirëinformuem për kohët që po ndryshonin ai ishte hedhë dukas në krahun e të revoltuemve...

Simoni, ai burrë i pashëm, me fytyrën e lëmuet e të buzëqeshun, , duke përshkue e soditë pothuaj krejt bregun, në orët e herëshme të mbasdites vinte tek ne, që ishim te hotel "Flutura", në krahun tjeter, jo larg portit. Njerëzit pushues të shtrimë në ranën e nxehtë nën çadrat e vjetrueme, në atë orë çonin përpjetë antenat e radiove "Iliria" të gatëshme me përpí zanin kumbues të spikerit, që vinte nga valët e "Zërit të Amerikës". Rrjeta e zhurmuesve ishte shprishë prej ngjarjeve të Ambasadave të Tiranës[3] e lajmet për hapje-thyerjen e portave dhe hyrjen e míja shqiptarëve në interieret e tyne ishin bá lajme të përbotëshme.

Simoni kishte qenë nxënës në Seminarin Papnuer. E kishte ndërpre rrugën e thirrjes meshtarake dhe prej andej kishte hy në rrugën e mësuesisë. E asaj rruge nuk i ishte nda mandej për rreth katërdhjetë vjet. Me atë ekzigjencë që kishte përftue në vitet nistore të rrugës së formimit të tij ndër jezuitë. Aq serioz kishte qenë me mësuesínë sa na e thoshte si pengun e vet, se dy herë , vetëm dy herë ishte paraqitë në orën e mësimit pa bá ditar edhe pse ato dy herë kishin qenë të justifikueshme.

Nejse... Tashti ai ishte në pension, kishte pesë vjet që ishte në pension dhe, ngjarjet e atyne ditëve që pasononin njéna tjetrën me një ritëm të hatashëm ai i komentonte shkurt, po me aq adrenalinë sa e banin burrin të fluturonte edhe kur ishte ndejun.

Mbasi fëmijtë tanë , të katërtit, që ishin në mosha të përafërta, ishim mbledhë rreth tij, ai ngrihej në gjunjë të mëdhenj e fillonte:

Unë prej Zotit jam i kshtenë
e gjithmonë kështu du me kenë...

Mandej Puna e pendimit...

O Zoti jem, po më vjen keq
megjith zemer
për mëkatet që kam ba
kam bjerrë Parrizin, kam fitu
ferrin,
por ma fort se t'kam fye ty.
O e mira e pambarueme,
Mëshirë o Zot, m'fal o Zot !
Po t'jap fjalen, me ndihmë tande
s'kam me t'fye mâ kurrë
Ashtu kjoftë !

Sapo kishte fillue uratën, që ua këndonte plot kantilenë e pasion fëmijve, prej larg, siç ishim ashtu grumbull, kush ndejë e kush në gjunjë, ndigjojmë zanin kumbues të Luçit:

-Simon, Simon...

-Urdhno, hajde Luç, hajde se këtu jam, a të thashë se po shkoj te Angjelini ?!

-Po, mor po, po u vonove fort se...

-Po na me pushime jena, moj Luç...

-A na duhet me u ba gadi, me shku..., a ke harrue , â ? Gruja e huaj asht e sëmurë e m'pret me i ba bâ inxheksionin e mbasdites.

Ata ishin martue vonë.. Edhe Luçia fillimisht kishte qenë nxanëse në Kuvendin e Murgeshave Stigmatine. Mbasi i paten qitë me forcë prej aty në fillimvitet '50, ajo kishte fillu punë në spitalin e qytetit, në fillim si sanitare, mandej si infermiere. Zoti s'ju kishte falë fëmijë. Tashti edhe ajo ishte në pension po, në spital, atje ku kishte shërbye prej katërdhjetë vjetësh, shkonte ditë për ditë. Në të njëjtën orë. Gjithmonë pak minuta para se të fillonte orari i punës. Kurse për kthimin nuk kishte orar. Ashtu sikurse nuk kishte pasë kurrë. Asgjë s'kishte ndryshue nga e përditëshmja e përherëshme e saj; kishte ndryshue vetëm dita e firmosjes së listëpagesës , nga dy herë në muaj në një herë në muaj. Dhe vendi i listëpagesës, nga Spitali i qytetit në Sigurimet Shoqërore...

Luçi e kishte mbyll aty bisedën e , duke na përshëndet ne ishte nisë përpara drejt "rezidencës" së tyre, drejt kampit pra. E bindur se Simoni po i shkonte mbas. Mirëpo ai, ende nuk ishte shkëput prej nesh.

-Gjithmonë kështu ka kenë Luçi, tuj ngá vrap. Më kujtohet njiherë, nuk ka shumë vjet, erdhi vonë fort prej spitalit . E i kthehem:

-Çká buna asht kështu, moj Luç, kaq vonë. Mandej, ti edhe ndoj ditë mundesh mos me shku moj burrneshë se ti tash në pension je. Po ajo, pa prit qortimin tem të përvujtshëm m'u kthye:

-Joo Simon, si mundem me ndejë pa shkue, ata njerëz kanë nevojë për mu e unë baj sevap për ta.

- Po, moj po, ban sevap për ta- i thashë- por po hin në gjynah me mu. E niset përmbas Luçit. Prej larg sheh Rrustemin, bashkëbujtësin e dhomës. Antenat e radiove "Iliria" tashma ishin ulë njiherëshi në të gjithë plazhin. Kishte mbarue edicioni i orës 6 të "Zanit të Amerikës" e ai mezi pritte me ja komentue Simonit, i cili gjindej në udhëkryq; me ndjek Luçin në ngutin e saj apo me durue të shamet e rregjimit prej Rrustemit...

Por e zhdavariti shpejt mëdyshjen, tue vijue në drejtimin për ku ishte nisë.

[1] tolloni - autorizimi për të blerë ushqime me të cilin racionoheshin ushqimet e munguara në treg.
[2] rrezgabezga-shpejt e shpejt, ik të ikim.
[3] ngjarjet e 2 korrikut 1990, kur mijëra qytetarë të Tiranës hynë në Ambasadat e vendeve perëndimore.

FARUK MYRTAJ

Njeriu vdes për librin e të tjerëve

Tregim



"Kjo kohë pa tru," po thoshte Sadriu.

"Paska pasur ndonjë kohë me tru?!"

"Kurrë deri në këtë farë feje!"

Trishtimi meritonte të pohohej, pastaj duhej rrëzuar e thërrmuar pa zhurmë, pa bujë e edhe nëse me dhimbje. Si gjithë gjërat në zonë mundimesh vullkanike.

"Liria vjen si shpresë se bëhemi më të mirë pas rënies së mëhershme të saj."

"Nuk po bëj shaka...", tha ai. "Sot më dhanë pesë milion..."

"Nuk dukesh sikur ke pranuar dhuratë!"

"Sepse jam i fyer!"

"I shpërblyer dhe i fyer, s'po të marrë vesh?!"

"Bashkë-fajtor dhe bashkë-vujtës!"

Si të kishim këmbyer portat, më mbeti mua t'i jepja nerv bisedën.

"Paguaj unë, sot e sa të jemi, me një kusht: Do të më shoqërosh deri tek shkallët e pallatit tim!"

Po e vështroja, ngultas. Si t'i lutesha për hollësi e të dhëna për të ngritur padi për korruptimin e të fundit mik në qytet. Aq më hahej muhabeti me të sa doja të besoja se vetëm mua më kishte mik. Mora një cigare, nga paketa e tij. Kësaj here kishte "Dunhill", kur zakonisht digjte "Slims".

"Ka shkak të të braktis edhe unë?!"

"S'beson ti që jam bërë me para?! Ja tek i ke!"

Hapi paksa zinxhirin e një çante dore meshini të kadifenjtë, që e mbante mes këmbëve. Prej atje brenda bënë sy tufa kartëmonedhash.

"S'besoj se janë para të vjedhura!"

E cika gotën me të tijën. Njeriu që s'ka vjedhur sa është bërë burrë, nuk vjedh më pastaj. Ata që vjedhin edhe kur janë bërë burra, kanë vjedhur gjithnjë.

Thyerja e madhe e vertebrës në këtë vend, veç së keqes mitologjike te njeriu me daljen nga kopshti Eden, kishte ndodhur kur e shpërfytyruan, kur e detyruan të hiqte dorë nga e drejta për të qenë individ, kur e lanë pa mendim, besim dhe pronë të vetën. Në momentin kur individi u katandisë të vetqortohej për faje që s'i kishte bërë, kur s'pati më asnjë të fshehtë veç për veten dhe, më në fund kur nisi të mburrej për varfërinë si lumturi, s'kishte mbetur kurrgjë prej njeriu. Çfarëdo boshllëk tjetër të shfaqej më pas tek ai, ishte veç ajo çfarë kishte fshehur aq gjatë.

Sigurisht s'besoja se Sadriu kishte marrë para të ndonjë tjetri.

"Me dikë vetëm sa përshëndetesha. As emrin s'ia dija. Më telefonoi para nja një jave..."

"Nuk të pyeta!", i thashë.

"Ti më duket se shkruan libra, më tha!" vazhdoi rrëfimin Sadriu.

"Me që s'merrem dot me tjetër gjë!"

"U paguajnë ndonjë çikë?!"

"Sot, shkruhet vetëm për lavdi dhe për tu përkthyer jashtë shtetit!"

"Punë është edhe kjo. Unë të marrë në punë të më shkruash një libër. Ti ma shkruan librin që dua dhe unë…të numëroj paratë! Lavdia nuk është mirë të mbetet ajër!"

"Ke të drejtë, por kush paguan për libra në këtë kohë?!"

"Unë paguaj. Një mik më ka lënë amanet t'i shkruhet një libër për jetën e tij. Ka lënë edhe paratë. Pesë milionë për ty. Ti di ta shkruash!"

"Pesë milionë për një libër?!"

"Tre milionë i ke në dorë, në këtë çantën që po ta lë këtu por të pesta janë të tuat. Ai më ka lënë histroinë e tij, të dhënat, dokumente, një si ditar, dorëshkrim. Kur ta botojmë librin që do shkruash ti, ke dy milionët e tjerë. Hajde mirë u pafshim!", më tha.

Po e vështroja Sadriun si njeri të minuar. Mund të shpërthente në momentin tjetër.

Mos o zot, se si u bëka njeriu kur bëhet me para të shpejtë! Edhe thjesht se ulemi në tavolinë me të, jemi të kërcënuar. Ndokush prej atyre që kanë hedhur këtë para të madhe, vjen e hedh ndonjë bumje, shkreh ndonjë karikator, aktivizon lëndë detonuese të fshehur në pirgun e parave dhe…!

"Ngrihemi, unë s'jam mirë…", thashë, si me shaka.

"Ti je rehat, vëlla! Unë jo. Unë jam milioner! Më premtove se do të më çosh deri tek shkallët!"

Sa herë ishim tallur me të tjerë që kishin humbur shpengimin, lirinë, duke u bërë me para të madhe, me ca të tjerë që për shkak të ligjit shoqëroheshin me roje personalë dhe me të tjerë të sotëm që shkojnë bëjnë dy-tri vite burg për të gëzuar më pastaj paranë e vjedhur.

Rrugës për në shtëpi të tij, mu bë se vërtet po kujdesesha t'i rrija si roje personal! E mbaja pak përpara, e shtyja të zhvendosej nga ana tjetër e trotuarit, të kalonim vetëm në rrugë me dritë, i vështroja me sy dyshues ata që fare rastësisht vinin përballë, por edhe ndokënd që vinte nga prapa. Ndokush që më njihte dhe nuk e mori vesh pse nuk i përshëndeta mbase thanë: i paskeni hedhur ca gota sot, ë?!

"A më shoqëron deri lart, te kati im, të lutem!" më tha Sadriu, kur arritëm tek pallati i tij.

Edhe mua, jo më Sadriut, më dukej se gjithë bota e dinte se ne kishim miliona me vete. Edhe fqinjët e tij, në të gjithë katet, mbase e dinin, edhe pse askush s'u pa në shesh-pushim apo të hapte derën e vet.

Më në fund, kishim arritur te hyrja e tij.

"Dje, e bëra derën super-sekrete, e sheh?!"

Më tha kështu dhe trokiti në derë. Trokiti në derën e shtëpisë së tij.

U dëgjuan hapa nga brenda dhe unë u tërhoqa, sigurisht mbase u binda që ishte zëri i gruas së tij! Dëgjova derën që mbyllej më çelës nga brenda, plotë tri rrotullime, rrëshqitja e shulit…dhe zbrita shkallët.

Teksa mora rrugën për në shtëpi, shkova ndërmend se mund të isha edhe unë i rrezikuar. Nuk kisha asnjë lekë me vete, por ndokush-i që dinte se Sadriu ishte bërë milioner, mund të merrte me mend se një pjesë të tyre, për të zvogëluar rrezikun ndaj vetes, m'i kishte dhënë mua.

Vonë fare, telefonoi. Sadriu: "S'po më zë gjumi, si i bëhet?!"

"Harroje veten duke shkruar!" Ç't'i thosha tjetër?!

"Po kur ta mbaroj atë libër, si do t'ia bëj?!"

"Shkruaj një libër për veten që u pagua për atë libër!"

"E pastaj?"

"Pastaj vjen fundi…"

"Kaq kollaj sa e thua ti?"

Dorëzoi librin për jetën e Tjetrit dhe ia dhanë dy milionët e tjerë nga ndërmjetësi, u takuam sërish.

"Ndonjë libër për dëshmorët?"

"Jo mor' vëlla jo!"

"Për ndonjë martir apo për diversantë?!"

"Për një ish-të burgosur. Që ka vdekur së fundi..."

"I afërt i këtij që paguan?"

"Ndërmjetësi im, edhe ai i rastësishëm në jetën e atij që s'rron më!"

"Pesë milionë lekë s'i ke marrë për gjithë librat që ke botuar deri tani!"

"E vërtetë…"

"Hajde gëzuar për të vërtetat! Premtove se do merrnim edhe një birrë të dytë!"

Kamerieri i solli menjëherë. Si t'i kishte pasur veshët te ne. Sadriu e ktheu gotën me fund dhe nisi të rrëfente.

***

Ai që kishte paguar, në mungesë, si i vdekur, paskej dalë nga një burg i gjatë politik si njeri pa njeri. Askush s'i kishte shkuar në burg. As gruaja, as vëllezërit, për be. Prindërit vdekur kur ishte atje brenda. Sapo qe liruar, kishte ardhur në kryeqytet. Vinte vërdallë selisë së partisë së parë opozitare.

"Kjo më nxori nga burgu…" thoshte. Edhe të panjohurve ua thoshte, por asnjëherë s'provoi të hynte brenda oborrit të saj. Deri ditën kur pa të hynte fytyra e një njeriu që i kujtoi burgun.

U dëshpërua, ia tha dikujt që ndodhi aty pari. A thua në këmbim të rrëfimit të arsyes së shkrirjes në lot, i kërkoi tjetrit dy dopjo raki. Kaq ishte mjaft për ta dehur trupin e tij të rrënuar.

Tjetri, si fajtor për dehjen e marramendjen e të panjohurit, e kishte marrë në shtëpinë e vet…

Që t'i biem shkurt, ky ishte njeriu që më dha mua tre milionët! As ky vet, s'e mori vesh pse e bëri një gjest të tillë! E futi në banjo të munduarin, e lau, duke e qortuar e përmendur ëmbëlsisht me ca pëllëmba. Pasi e solli në vete, i dha për të ngrënë dhe natyrisht mendoi se në rastin më të parë do duhej ta nxirrte deri në rrugë, aty ku e kishte parë, te selia e opozitares që ishte bërë në pushtet.

Aty mori vesh se ish-i burgosuri kishte një pasuri të tërë pronash.

"Të gjitha pronat e mia bëhen të tuat, nëse t'i i rregullon me shkresa. Kujt t'ia lë tjetër unë?!"

"Mua të m'i lësh, pse jo!"

"Ty do të t'i lë! Aq më shumë kur as ti s'paske njeri në këtë botë!"

Ky birbua, dhuruesi im, i solli menjëherë letër, bojë e penë dhe ai i bekuari i hodhi në letër të gjitha. Kur kishte parë atë njeriun e burgut duke hyrë serbes te selia e partisë, qe ndjerë pa shpresë për kthimin e pronave, ndaj mendoi të provonte mos ditët e mbetura i mbyllte nën kujdesin e një njeriu si ky që e futi në shtëpinë e tij pa asnjë interes.

Pas kësaj, bamirësi e mbajti edhe më mirë. E veshi me kostum, me këmishë e kollare, e këmbenin ndonjë teke së bashku. Sëmundjet e burgut i lulëzuan aty, por tjetri pajtoi një zonjë plakë për t'i shërbyer. Kjo botë qenkej plotë me të vetmuar që i gjendeshin njeri-tjetrit. Edhe plaka paguhej prej parave që do dilnin prej pronave kur të legalizoheshin dhe shiteshin mirë e bukur.

E vetmja kërkesë e ish të burgosurit, qenkej t'ia paguhej kuota e anëtarësisë në partinë e opozitës, edhe pse kjo tingëllonte si shaka e një jete të pashpjeguar dot kurrë.

Vetëm kur i erdhi hera që ai rob Zoti të mbyllte sytë, ky bamirësi im mori vesh se burgu i gjatë kishte ndodhur prej ëndjes së pandreqshme të atij për të lexuar libra të ndaluar...

I kishte bërë një qivur të mrekullueshëm, varr prej mermeri të shtrenjtë. Mbase ngaqë kurrë nuk kishte pasur shtëpi. Një herë në muaj i shkonte në varreza. I ndizte dy qirinj te kryet dhe një në fund të këmbëve.

"I jam në borxh atij njeriu, më tha...Nuk di ç'të bëj tjetër për të. Mbase mbylli sytë me idenë se isha unë bamirësi i tij, por e vërteta është tjetër…"

"Ai është edhe bamirësi im, që shkrova libër për të! Njeriu vdes për librin e të tjerëve!"

ZAHO VASILI

Dy lumenjtë

Poezi

POPULLI IM

Ky populli im i lashtë
Që deri këtu ka ardhur,
Ishin dhe nuk ishin bashkë
Po në luftë nuk kanë falur.

Ai kurrë s'e shkeli fjalën
Se e kishte me besë shumë,
dy duart i kish për pallën
Kishte gjunjë, po s'ra në gjunjë...

Kështu ishim, kështu mbetëm
Se ishim lulja e burrit,
Ai u përkul vetëm
Para ZOTIT dhe FLAMURIT...

DY LUMEJTË...

Gjithë lumejtë do vërshojnë
Herë vrullshëm, herë avash.
Ata ecin dhe s'ndalojnë
Asnjë herë nuk kthehen pas.

Dhe lumejtë njerëzorë
Gjithmonë para do vërshojnë,
Ndryshe nga lumejt, luginash
Do kthehen që të kujtojnë...

Do kthehen që të kujtojnë
Gjithë ata që kanë ikur,
Asnjëherë mos i harrojnë
Sepse në shpirt na ka pikur...

Këta lumej kthehen mbrapa
Se brenda digjen nga zjarri,
Mjerë ata që s'hedhin hapa
Tu shpien lule te varri...
MORA RRUGËN

Mora rrugën për tek nëna
Zot o Zot,
Ku flinte më rrahu zemra
Fortë e fortë.

Atje ishte dhe babai
Perëndi,
Zemra filloi të më qajë
Si dy sy...

Erdha nënë, dielli im
Të të shoh,
Nëna nuk ka perëndim
Lindjen njoh.

Ati im rrezet e diellit
Zot o Zot,
Zgjuar unë i kam në gji
Jetë e mot...

MOJ PIKA E LOTIT...

Moj pika e lotit sa e vogëël je
Këputesh nga sytë dhe bije përdhe,
Moj pika e lotit që brenda ke zjarr
Dhe me flakën tënde djeg drurë dhe bar.

Moj pika e lotit që rrjedh si burimi
Kur bie në tokë ndizet gjelbërimi,
O moj pika e lotit ti je ndarë në mes
Gjysma për atin, tjetra nëna, s'vdes...

VARGJET ÇANË MURET E KALASË

Burgosur te shtatë penxheret, atë mot
Kuçioti që tundi muret si rapsod,
I lidhur këmbë e duar me zinxhirë
Pas tërhiqte një copë hekur me pahir.

Qelia po rridhe ujë sa shumë pikonte
Kuçioti me zemrën stërrall, do duronte,
Po brenda qelisë hyri si një bubullimë
Lufta që bëri Çerçizi, vetëtimë.

Ishte lufta e Mashkullorës, histori
U vra Hajredin Tremishti dhe u mbajt zi,
Po turku doli i mundur për liri
Ngjarja u fut brenda burgut, në qeli.

Duart lidhur, prangat zvarrë, me gjëmim
Hodhi vargjet për Çerçizin, me një frymë,
Muret e trashë të burgut vargu i ç au
Edhe turqit nga qelia, sec i vrau...

Leri djemt e mi të shkojnë, turk o turk
Dhe me vetëtimë qëlloi, nga ai burg,

Se ai ishte Çerçiz Topulli, zoti vet
Dhe ju skuqi ju me bojë, po ju vret.

Ja kështu e çau burgun, kënga e kuçiotit
Se ishte nga Labëria, bir i Zotit,
Ka një shekull historia, që ndriçohet
Do vijnë me qindar të tjerë, do këndohet...

VAZHDIM I KËNGËS SË POPULLIT

Dola në udhë e të prita
moj nepërka pika – pika
me tre gurë të godita
të vrava më vraftë pika

-Qenë mollë po dil e priti
I mora nga degë e shpirtit
Të ëmbla si zemra tënde
Cilin djalë ti nuk e çmende.

Të vrava më rëntë pika
Të godita po ti s'ike
Bëra shaka si për dita
Jo mor jo nuk vritet drita
Jam i joti yll me çika...

PORTRET

Për kapele i kam retë
Dhe për supe kam malet,
Për duar kam përrejtë
Për këmbë lumejt që nuk ndalen.

Për kokë do kemë diellin
Dhe yjet i kam për sy,
Goja ime është burimi
Dhe për qafë një selvi.

Dhe jetoj nën qiell
Jam bërë flakë zjarri,
Por në gjoksin tim, si diell
Mbaj zemrën e Shqiptarit...

Atë e kam nga të parët
Brenda meje si minierë,
Ngaqë e kam nga Shqiptarët
Nuk e ndërrova asnjë here...

TEPELENA MËMA E ERËS...

Malet janë burrat
Grykat janë gratë,
U lidhën në çift
Për një jetë të gjatë...

Grykat janë gratë
Që prodhojnë erën,
Që të çajnë stuhitë
Hapur e kanë derën.

Grykat janë mëma
Lindi Tepelena,
Lindën dhe kalanë
Bashkë me bedena.

Vjosa është bija
Përkëdhel kalanë,
Me valët e saj
Gjitone, aq pranë...

Mëma grykë lindi
Birin, trim Alinë,
Era më e marrë
Tundi Rumelinë...

Era mëmë lindi
Gjithë bilbilejtë,
malet baballarë
Nuk i lanë të shkretë...

Selam të foli zemra
Trego veten, të ra shorti,
Me këtë erën e mëmës
Vulosi me grykë të topit...

Mëma erë lindi
Trimin Matohiti,
Orator që bindi
Popullin e ngriti.

Bija e erës lindi
Dhe bijën Nimete,
Lavdia s'e la
E mori me vete...

Shih sa erëra ka
Tepelena Mëmë,
Se na lindi Paron
Golikun për këngë

Lindi Agim Shehun
Edhe Petrit Rukën,
Që i kishin vargjet
Më të shtrenjtë se bukën...

Këto janë erëra
Që i lindi Mëma,
Ata s'vdesin kurrë
Se pronë i ka kënga...

S'janë vetëm këta
Është gjithë historia,
Që i lindën malet
Grykat, mëmësia.

NJERIU KRYQ KRYQËZUAR NË KRYQ

O i dashuri im lexues
Me vëmendje pak më ndiq,
Njeriu në këmbë, krahëhapur
As ngjan vetë me një kryq?

Unë them nga vetë njeriu
Dhe këtë ma thotë shpirti,
Nuk them se e lindi feja
Nga njeriu lindi kryqi.

Ky njeriu krahë hapur
As nuk shpreh dashurinë?
është gati që me zemër
Të të japi përqafim...

Njeriun kryq e mbërthyen
Krishtin krahë hapur në kryq,
Se qe zemra e përqafimit
Në ato mote dhe në atë vit...

Meqë i kishte brenda vetes
Mund të ndodhte ndryshe vallë?
ai u ngjall për dashurinë
për mirësinë ai u ngjall...

DO TË LË MOR BUKUROSH...

Kur i hedh dy sytë e shkruar
Sheh lulen apo sheh mua
Nëse na vështron të dyja
Do dehem nga kënaqësia
Del se qënkemi njësoj
Një puthje do ta dhuroj...

Kur mi hedh dy sytë jeshilë
Të ngjaj si maj a si prill
Sheh sythet a më sheh mua
Të dyja pëllumb i shkruar
Them se do jemi njësoj
Nga ti qafimin kërkoj
Je i mirë e s'të kam faj
Do të puth dhe unë pastaj.

Kur i hedh dy sytë mbi mua
Sheh sythe, filiza shkruar
Nëse vjen më prek me duar
Puthjet do të jenë krua
Dy buzët për ti freskuar
Do ti shpupuris flokët
Dhe do të lë bukurosh
Përmbi gjinj ti ta vësh kokën...

DUA...

Dua një gur të filloj murin
Dua një fjalë të vazhdoj fjalinë
Dua një kokërr të shtoj grurin
një notë kënge për dashurinë.

Dua një puthje të shtoj lumturinë
Dua një lule që të nxjerri sythe
Dua një pikë lot ta mbyll fatkeqsinë
Dua fole të më vijnë dallëndyshe.

Gjeta gurët, e bëra murin
Gjeta fjalët, e ndërtova fjalinë,
Nga kokërra doli ara që mbajti grurin
Notat sollën këngën për burrërinë...

E gjeta puthjen, por jo lumturinë
E gjeta lotin dhe mu bë rrëke
I gjeta sythet, ma dhanë dashurinë
I gjeta dallëndyshet dhe ngritën fole.

Lulështari e lulështoi jetën
Desha, dua dhe do të dua,
Dashuri e lule më dhanë të vërtetën
Që hyri dhe mbeti tek mua...

IRWIN SHAW

Pjetri Numër 2

Tregim

Para dy javësh u botua një tregim i Irwin Shaw në faqet e ExLibris, për të cilin mora shumë përgëzime -për përkthimin dhe zgjedhjen. Disa prej komentuesve më sugjeronin të përktheja një tjetër tregim të po këtij autori Zgjodha të përkthej tregimin e mëposhtëm, tregim i cili më ka pëlqyer që nga leximet e mia të hershme, gati gjysëm shekulli më parë.-

Rudolf Marku

Ishte e shtunë, mbrëmje, dhe njerëzit vazhdonin të vrisnin njëri-tjetrin çdo orë në ekranin e vogël. Policët qëlloheshin në krye të detyrës, gangsterët hidheshin nga çatitë, dhe një zonjë e moshuar helmohej ngadalë për shkak të perlave të saj, ndërsa vrasësi vihej përpara drejtësisë nga një kompani cigaresh pas një sërë diskutimesh të gjata në zyrën e një detektivi privat. Aktorë të guximshëm dhe të paarmatosur hidheshin mbi kriminelë që mbanin pistoleta 45, dhe vajzat naive shpëtoheshin nga vdekja me thikë, falë ndërhyrjes së shpejtë të djemve simpatikë dhe guximtarë.

Pjetri rrinte ulur në karrigen e madhe përpara ekranit, me këmbët sipër krahut anësor të karriges, duke ngrënë rrush. Nëna e tij nuk ishte në shtëpi, prandaj ai i hante edhe bërthamat, teksa shikonte me vëmendje dhunën që zhvillohej përpara tij. Kur nëna ishte në shtëpi, frika nga apendisiti qëndronte pezull në ajër dhe ajo bënte kujdes që çdo bërthamë të nxirrej dhe të vendosej në një tabaka cigaresh. Gjithashtu, nëse ajo do të ishte aty, do të kishte dhënë dhe ca leksione të vogla, të mërzitshme për cilësinë e argëtimit në televizion për të rinjtë dhe ndërhyrje të shpejta me nerva në butonat e televizorit për të gjetur diçka që përcaktohej vagullt si edukative. Ndodhej i vetëm, në mënyrën më të guximshme i pagjumë, në orën njëmbëdhjetë të natës, Pjetri shtypte bërthamat mes dhëmbëve, duke shijuar zhurmën e pasjellshme dhe vetminë e lirë të shtëpisë bosh.

Gjatë reklamave televizive, Pjetri i mbyllte sytë dhe imagjinonte veten duke ju hedhur shishe burrave të mëdhenj, të paqethur, që mbanin pistoleta dhe që ecnin ngadalë lart një shkallë të errët drejt derës pas së cilës të gjithë e dinin se shefi ishte duke pritur. Fryrja e këllëfit të armës nën xhaketën e tij prej fanelate ishte e pashmangeshme.

Pjetri ishte trembëdhjetë vjeç. Në klasën e tij kishte edhe tre djem të tjerë me të njëjtin emër, dhe mësuesi i historisë, që mendonte se ishte njeri me humor, i quante ata Pjetri Një, Pjeter Dy (ky që po hante rrush, me gjithë bërthama), Pjetri Tre dhe Pjetri i Madh. Pjetri i Madh ishte, sigurisht, djali më i vogël në klasë. Ai peshonte vetëm njëzet e tetë kilogramë, mbante syze dhe në lojëra gjithmonë zgjidhej i fundit. Klasa qeshte gjithmonë kur mësuesi i historisë i thërriste "Pjetri i Madh", dhe Pjetri Dy qeshte bashkë me ta, edhe pse në të vërtetë nuk i dukej edhe aq qesharake

Dy javë më parë ai e kishte ndihmuar Pjetrin e Madh , dhe tani ata ishin, si me thanë, shokë. Të gjithë Pjetrat ishin, si me thanë, shokë, për shkak të atij mësuesi të historisë që bënte si komedian. Nuk ishin shokë të vërtetë, por kishin diçka së bashku, diçka që djemtë e tjerë nuk e kishin. Jo se u pëlqente kjo gjë, por ja që kështu kishte ndodhur, dhe kjo i bënte përgjegjës për njëri-tjetrin. Që dy javë më parë, kur Çarli Blejsdell, që peshonte pesëdhjetë e pesë kilogramë, ia mori kapelën Pjetrit të Madh gjatë pushimit dhe filloi të bënte budallain me të, dhe, kur Pjetri i Madh dukej sikur do të shpërthente në lot, ai, Pjetri Dy, ia rrembeu kapelën dhe ia ktheu mbrapsht te zotit, duke iu përball Blejsdellit. Sigurisht që pati një sherr, dhe Pjetri mendoi se do të ishte rrahja e tretë për atë semestër, por ndodhi diçka e mrekullueshme. Në mes të sherrit, pikërisht kur Pjetri shpresonte që të shfaqej ndonjë nga mësuesit (që, çuditërisht, shfaqeshin gjithmonë kur nuk të duheshin), Blejsdelli lëshoi një

goditje të fortë. Pjetri u përkul dhe Blejsdelli e qëlloi në majë të kokës dhe theu krahun. Kuptohej menjëherë që e kishte thyer krahun, sepse ra përdhe duke bërtitur, dhe krahu i varej si një fill. Valteri, mësuesi i edukatës fizike, më në fund u shfaq dhe e mori Blejsdellin duke bërtitur gjithë kohën, dhe Pjetri i Madh u afrua dhe i tha me admirim: "Garip, një gjë duhet ta pranosh e ke kokën gur!" Blejsdelli mungoi në shkollë dy ditë, dhe ende e mbante krahun në fashe, dhe sa herë që përjashtohej nga shkrimi në dërrasën e zezë për shkak të dorës së thyer, Pjetrit i vinte një ndjesi e ngrohtë në gjithë trupin. Pjetri i Madh rrinte vazhdimisht pranë tij, i bënte punë të vogla dhe i blinte lëngje, sepse prindërit e Pjetrit të Madh ishin të divorcuar dhe i jepnin gjithë paratë që donte, për t'ia bërë qejfin. Por gjëja më e mirë ishte ndjesia që kishte pas sherrit. Ishte njësoj si ajo që ndoshta ndjenin njerëzit në televizor pasi hynin në një dhomë plot me armiq dhe dilnin prej saj me vajzën, ose me dokumentet, ose me të dyshuarin, duke lënë pas kufoma dhe shkatërrim.

Blejsdelli peshonte pesëdhjetë e pesë kilogramë, por kjo nuk e kishte ndalur Pjetrin, ashtu siç asnjëherë fakti që spiunët kishin nga dy armë nuk i ndalte njerëzit e FBI-së në ekran. Ata e shihnin çfarë kishin për të bërë dhe thjesht e bënin. Kaq. Pjetri nuk dinte ta përkufizonte vetë, por për herë të parë në jetën e tij ndjeu vetëbesim dhe krenari të vetëdijshme për veten.

"Le të vijnë," murmuriti nëpër dhëmbë, duke përtypur bërthamat e rrushit dhe duke parë televizorin me sytë e ngushtuar, "veç le të vijnë."

Ai ndiente se kur të rritej, do të bëhej një njeri i rrezikshëm, por një i tillë tek i cili të dobëtit dhe ata që ndiqeshin padrejtësisht mund të kthenin sytë për siguri. Ishte i bindur se do të bëhej një e nëntëdhjetë e dy centimetra i gjatë, sepse babai i tij ishte po aq i gjatë, edhe të gjithë xhaxhallarët e tij, dhe kjo do ta ndihmonte. Por do t'i duhej të zhvillonte krahët. Ishin thjesht shumë të hollë. Fundja, nuk mund të shpresoje gjithmonë që njerëzit të thyenin kockat mbi kokën tënde. Kishte një muaj që bënte pompa çdo mëngjes dhe mbrëmje. Deri tani mund të bënte vetëm pesë e gjysmë përnjëherë, por do të vazhdonte derisa t'i kishte krahët si shufra çeliku. Krahet e tillë mund të bënin vërtet ndryshimin midis jetës dhe vdekjes më vonë, kur do të duhej të hidhje veten poshtë një arme dhe të çarmatoste dikë. Duhej të kishe edhe reflekse të shpejta, sigurisht, dhe të ishe në gjendje të mashtroje me sytë e tu në drejtimin tjetër para momentit vendimtar. Dhe, më e rëndësishmja nga të gjitha, sado i madh të ishte rreziku, duhet të ishe pa frikë. Një çast hezitimi dhe të priste morgu. Por tani, pas betejës për kapelën e Pjetrit të Madh, nuk shqetësohej më për atë pjesë pjesën e pa-frikës. Nga tani e tutje, do të merrej vetëm me çështje teknike.

Nëpër kanale filluan të shfaqeshin komedianë, duke qeshur me dhëmbët zbuluar, dhe Pjetri shkoi në kuzhinë dhe mori një tjetër vilë rrushi dhe dy mandarina nga frigoriferi. Nuk e ndezi dritën në kuzhinë, dhe ishte e çuditshme se sa misterioze mund të dukej një kuzhinë rreth mesnate kur nuk ishte askush tjetër në shtëpi, dhe kishte vetëm dritën e frigoriferit të hapur, që hidhte hije nga shishet e qumështit mbi linoleumin e dyshemesë. Deri vonë nuk e kishte pëlqyer shumë errësirën dhe gjithmonë ndizte dritat kudo që shkonte, por duhej të praktikoje të jesh pa frikë, ashtu si për çdo gjë tjetër.

I hëngri dy mandarinat duke qëndruar në errësirë në kuzhinë, thjesht për praktikë. Pastaj u kthye në dhomën e ndenjës, duke mbajtur vilen e rrushit. Komedianët ishin ende në ekran dhe ende qeshnin. Ai nisi të luante me butonat e televizorit, por në të gjitha kanalet burrat mbanin kapele qesharake, qeshnin dhe bënin shaka për taksat e të ardhurave. Po qe se e ema nuk do ta kishte bërë të premtonte që do flinte në orën dhjetë, do ta kishte fikur televizorin dhe do kishte shkuar në shtrat. Vendosi të mos e humbte kohën dhe u shtri përtokë për të bërë pompa, duke u përpjekur të mbante gjunjët drejt. Ishte tek e katërta dhe po ngadalësohej kur dëgjoi britmën. Ndaloi në mes të një pompe dhe priti, për t'u siguruar. Britma u dëgjua sërish. Ishte një grua dhe ishte britëm shumë e fortë. Ai ngriti kokën drejt televizorit. Aty ishte një burrë që fliste për dyllin e dyshemeve, me mustaqe dhe shumë dhëmbë, dhe ishte e qartë që ai nuk po bërtiste.

Hera tjetër që u dëgjua britma, pati edhe rënkime dhe të folura në fund të tyre, dhe tingulli i grushteve që rrihnin derën e përparme. Pjetri u ngrit dhe e fik televizorin, për t'u siguruar që tingujt që dëgjonte nuk po transmetoheshin nga aty. Trokitja në derë filloi përsëri dhe një zë gruaje bërtiti "Të lutem, të lutem, të lutem..." dhe nuk kishte më dyshim për këtë.

Pjetri hodhi një sy përreth në dhomën bosh. Tri llamba ishin ndezur dhe dhoma ishte e



ndritshme dhe e ngrohtë, dhe drita reflektohej në vilen e rrushit që mbante në dorë dhe mbi xhamin e pikturës së varkave në Cape Cod, që tezja Martha e kishte pikturuar vitin që kishte qenë atje. Televizori qëndronte në qoshe, si një sy i madh i verbër, tani që ishte i fikur. Jastëkët e karriges së butë ku ai kishte qëndruar për të parë programet ishin shtypur dhe ai e dinte që nëna e tij do të vinte dhe do t'i rregullonte para se të flinte, dhe e gjithë dhoma dukej si një vend ku ishte e pamundur të dëgjoje një grua duke bërtitur në mesnatë dhe duke goditur derën me grushte dhe duke bërtitur "Të lutem, të lutem, të lutem..."

Gruaja tek dera bërtiti, "Vrasje, vrasje, po më vret!" dhe për herë të parë Pjetri u ndje keq që prindërit e tij kishin dalë atë natë.

"Hape derën," bërtiti gruaja. "Të lutem, të lutem hape derën." Tani ishte e qartë se "të lutem" nuk e thoshte thjesht nga mirësjellja.

Pjetri hodhi një vështrim të shqetësuar përreth. Dhoma, me të gjitha dritat e saj, dukej e çuditshme dhe kishte hije pas çdo gjëje. Pastaj gruaja bërtiti përsëri, thjesht një britmë pa fjalë këtë here... Filloi të ecte ngadalë drejt derës së përparme. Në korridor ishte një pasqyrë e gjatë dhe ai pa veten mirë. Krahët iu duken shumë të hollë

Gruaja filloi të trokiste përsëri me grusht në derën kryesore dhe Pjetr-i e vështroi me kujdes. Ishte një derë e madhe çeliku, por po dridhej lehtë, sikur dikush me një makinë po punonte mbi të. Për herë të parë ai dëgjoi një zë tjetër. Ishte një zë burri, vetëm se nuk tingëllonte tamam si zë burri. Tingëllonte si një kafshë në një shpellë, që gërhiste dhe po vendoste të bënte diçka të paarsyeshme. Në të gjitha skenat me kërcënim dhe dhunë në televizor, Pjetri nuk kishte dëgjuar kurrë një gjë të tillë. U afrua ngadalë drejt derës, duke u ndjerë si atëherë kur kishte kaluar gripin, duke kujtuar sa të dobëta i dukeshin krahët në pasqyrë, dhe duke u penduar që kishte vendosur të ishte pa frikë.

O Zot! bërtiti gruaja. O Zot, mos e bëj!

Pastaj pati disa goditje të tjera dhe ai tingulli i ulët kafshëror i bishës në shpellë që nuk e dëgjon kurrë në televizor, dhe ai hapi derën me një tërheqje.

Zonja Çalmers ishte aty në koridor, në gjunjë, përballë tij, dhe pas saj Zoti Çalmers qëndronte i mbështetur pas murit, me derën e apartamentit të tyre të hapur pas shpine. Zoti Çalmers po nxirrte atë tingull të çuditshëm dhe kishte një armë në dorë, duke e drejtuar atë nga Zonja Çalmers.

Koridori ishte i vogël dhe kishte atë që nëna e Pjetrit e quante letër-muri në stilin *Amerikan i Hershëm* dhe një llambë prej bronzi. Kishte vetëm dy dyer që hapeshin në koridor, dhe familja Çalmers kishin një tapet përpara derës së tyre ku shkruhej "Mirësevini". Çalmers ishin në mesin e të tridhjetave dhe nëna e Pjetrit gjithmonë thoshte për ta: «Një gjë është e sigurt për fqinjët tanë, se janë të qetë.» Ajo gjithashtu thoshte që Zonja Çalmers shpenzonte shumë para për pamjen e saj.

Zonja Çalmers ishte paksa e shëndoshë, flokët i kishte bionde të bukura dhe fytyrën të butë e rozë, dhe gjithmonë dukej sikur sapo kishte dalë nga salloni i bukurisë. Ajo gjithmonë i thoshte Pjetr-it në ashensor me një zë të butë, sikur gati do të qeshte: «Ua, po bëhesh një djalë i madh.» Duhej ta kishte thënë këtë të paktën pesëdhjetë herë. Ajo gjithmonë mbante një aromë të fortë parfumi.

Zoti Çalmers mbante syze pince-nez pothuajse gjithmonë, ishte duke u tullacuar dhe punonte deri vonë në zyrë shumë mbrëmje të javës. Kur e takonte Pjetr-in në ashensor, thoshte: «Po ftohet,» ose «Po ngrohet,» dhe kaq, kështu që Pjetri nuk kishte ndonjë mendim për të, përveçse se dukej si drejtor shkolle.

Por tani Zonja Çalmers ishte në gjunjë në koridor dhe fustani i ishte shqyer, po qante dhe kishte vija të zeza në faqe dhe nuk dukej si të kishte dalë nga salloni i bukurisë. Dhe Zoti Çalmers nuk kishte xhaketë, nuk kishte syzet, flokët që i kishin mbetur ishin të çrregullta, dhe po mbështetej pas letrës së murit ndërsa nxirrte këtë tingull kafshëror, me një pistoletë të madhe, të rëndë në dorë, dhe e drejtonte direkt nga Zonja Çalmers.

-Më fut brenda shtepise,-bërtiti Zonja Çalmers, ende në gjunjë. -Duhet të më futësh ne shtëpi!! Ai do të më vrasë! Të lutem.

-Zonja Çalmers... filloi Pjetri. Zëri i tingëllonte sikur po përpiqej të fliste nën ujë, dhe ishte shumë e vështirë të shqiptonte "s"-në në fund të emrit të saj. Ai shtriu duart pa siguri përpara vetes, sikur priste që dikush t'i hidhte diçka.

-Hyr brenda, ti!- tha Zoti Çalmers.

Pjetri e shikoi Zotin Çalmers. Ai ishte vetëm pesë hapa larg dhe, pa size, po i gurdulloste sytë. Pjetri bëri një lëvizje me sytë, ose të paktën, më vonë ai kujtonte që kishte bërë një lëvizje të tillë. Zoti Çalmers nuk bëri asgjë. Thjesht qëndroi aty, me pistoletën të drejtuar, disi, sipas Pjetrit, njëkohësisht edhe nga Zonja Çalmers, ashtu edhe nga ai vetë. Pesë hapa ishin një distancë e gjatë, shumë e gjatë.

«Natën e mirë», tha Pjetri dhe e mbylli derën. Nga ana tjetër e derës u dëgjua vetëm një vajtim i vetëm, dhe pastaj asgjë.

Pjetri hyri brenda dhe e ktheu vilen e rrushit në frigorifer, duke ndezur dritën kur hyri në kuzhinë dhe duke e lënë të ndezur kur doli. Pastaj u kthye në sallon dhe mori kërcellet e tufës së parë të rrushit dhe i hodhi në oxhak, sepse përndryshe nëna e tij do t'i vërente, do të kërkonte bërthamat dhe nuk do t'i gjente, dhe të nesërmen do t'i jepte katër lugë gjelle me qumësht magnezi.

Pastaj, duke lënë dritat e ndezura në sallon, edhe pse e dinte çfarë do të thoshte nëna e tij për këtë kur të kthehej në shtëpi, ai shkoi në dhomën e vet dhe u fut shpejt në shtrat. Priste të dëgjonte krisma armësh. Kishte dy ose tre zhurma që mund të kishin qenë krisma, por në qytet ishte e vështirë të kuptoje se çfarë ishin.

Ishte ende zgjuar kur prindërit e tij u kthyen në shtëpi. Dëgjoi zërin e nënës së tij, dhe nga mënyra si tingëllonte, e kuptoi që po ankohej për dritat e ndezura në sallon dhe kuzhinë, por bëri sikur flinte kur ajo hyri në dhomë për ta parë. Nuk donte të niste një bisedë me nënën për Çalmers, sepse ajo do ta pyeste se kur kishte ndodhur dhe do të donte të dinte çfarë po bënte ai zgjuar në mesnatë.

Vazhdoi të dëgjonte për krisma për një kohë të gjatë, dhe nën batanije ndjeu se u nxe dhe u djersit, pastaj u ftoh shumë. Dëgjoi disa zhurma të mprehta, të paqarta gjatë natës së qetë, por asgjë që mund të thuhej me siguri; dhe pas një farë kohe ra në gjumë.

Në mëngjes, Pjetri u ngrit herët nga shtrati, u vesh shpejt dhe doli nga apartamenti pa i zgjuar prindërit. Koridori jashtë dukej njësoj si gjithmonë, me llambën prej bronzi dhe letër-murin me lule dhe tapetin e derës së Çalmers -ëve me mbishkrimin "Mirësevini". Nuk kishte trupa dhe as gjak. Ndonjëherë, kur Zonja Çalmers qëndronte aty duke pritur ashensorin, mund të ndjeje aromën e parfumit të saj për shumë kohë pas saj. Por tani nuk kishte asnjë aromë parfumi,

vetëm aroma e zakonshme e pluhurit në një pallat banimi.

Pjetri vështroi derën e Çalmersëve me nervozizëm, ndërsa priste që të ngjitej ashensori, por ai nuk u hap dhe asnjë zë nuk doli prej tij.

Sam-i, burri që e drejtonte ashensorin dhe i cili gjithsesi nuk e pëlqente Pjetrin, vetëm mërmëriti kur ai hyri në ashensor, dhe Pjetri vendosi të mos e pyeste per asgjë. Doli në rrugën e ftohtë dhe të ndritshme të mëngjesit të së dielës, duke pritur të shihte makinën e morgut përpara derës, ose të paktën dy a tri makina policie që patrullonin. Por aty ishte vetëm një grua e përgjumur me pantallona sportive që i bënte shëtitje një qeni boxer, dhe një burrë me jakën e xhaketës të ngritur që nxitonte nga cepi i rrugës me gazetat nën sqetull.

Pjetri kaloi në anën tjetër të rrugës dhe shikoi lart, nga kati i gjashtë, nga dritaret e apartamentit të Çalmersëve. Perdet veneciane ishin tërhequr në çdo dhomë dhe të gjitha dritaret ishin të mbyllura.

Një polic po ecte në anën tjetër të rrugës, i rëndë, i veshur me uniformë blu dhe me qëllim të qartë në ecjen e tij, dhe për një moment Pjetri ndjeu si të ishte afër arrestimit. Por polici vazhdoi drejt bulevardit, ktheu në cep dhe u zhduk, dhe Pjetri i tha vetes: «Ata kurrë nuk dinë gjë.»

Eci lart e poshtë në rrugë, fillimisht në një anë, pastaj në tjetrën, duke pritur, megjithëse nuk ishte e qartë se çfarë po priste. Pa një dorë që doli nga perdet në dhomën e prindërve të tij dhe mbylli dritaren me një përplasje, dhe e dinte që duhej të ngjitej shpejt lart me një justifikim të mirë përse kishte dalë, por nuk mund t'u dilte përballë atyre atë mëngjes, dhe do të shpikte një justifikim më vonë. Ndoshta do të thoshte që kishte shkuar në muze, megjithëse dyshonte që nëna e tij do ta besonte.

Pasi kishte vëzhguar rrugën për gati dy orë dhe pikërisht kur po afrohej te hyrja e ndërtesës së tij, dera u hap dhe zoti dhe zonja Çalmers dolën jashtë. Ai kishte vënë syzet pince-nez dhe një kapele ngjyrë gri të errët, dhe zonja Çalmers kishte veshur pallton e saj prej gëzofi dhe një kapele të kuqe me pendë mbi të. Zoti Çalmers po e mbante derën hapur me mirësjellje për gruan e tij, dhe ajo dukej, teksa dilte nga dera, sikur sapo kishte dalë nga salloni i bukurisë.

"Mirëmëngjes," tha zoti Çalmers, ndërsa i kapi krahun gruas së tij dhe nisën të ecin përpara, duke kaluar pranë Pjetrit.

"Mirëmëngjes, Pjeter," tha zonja Çalmers me zërin e saj të butë, duke i buzëqeshur. "A nuk është një ditë e bukur sot?"

"Mirëmëngjes," tha Pjeter, dhe u habit që fjala i doli dhe tingëlloi si një "mirëmëngjes" i vërtetë.

Çalmers ecën poshtë rrugës në drejtim të Madison Avenue, dy të martuar, krah për krah, duke shkuar në kishë ose në një hotel të madh për mëngjesin e së dielës. Pjetri i shikoi, i turpëruar. I vinte turp për zonjën Çalmers, që kishte qenë ashtu siç kishte qene natën e kaluar - në gjunjë, duke bërtitur dhe aq e frikësuar. I vinte turp për zotin Çalmers që kishte bërë atë zhurmë që nuk i ngjante zhurmës së një qenieje njerëzore dhe që kishte kërcënuar se do ta vriste gruan e tij dhe nuk e kishte bërë. Dhe i vinte turp për veten që kishte qenë i patrembur kur hapi derën, por nuk kishte qenë më i patrembur dhjetë sekonda më vonë, kur zoti Çalmers ndodhej pesë hapa larg me armë në dorë. I vinte turp që nuk e kishte strehuar zonjën Çalmers në apartamentin e vet. Por më shumë se gjithçka, i vinte turp sepse të gjithë i kishin thënë mirëmëngjes njëri-tjetrit dhe Çalmersët po ecnin qetësisht së bashku, krah për krah, në diellin me erë, drejt Madison Avenue.

Ishte pothuajse ora njëmbëdhjetë kur Pjetri u kthye në apartament, por prindërit e tij kishin fjetur përsëri. Në orën njëmbëdhjetë kishte një program mjaft të mirë, për kundërspiunazhin në Azi, dhe ai e hapi automatikisht, ndërsa po hante një portokall. Ishte mjaft emocionuese, por pastaj erdhi një pjesë ku një oriental mbante një bombë që tik-tikonte në dorë në një dhomë plot me amerikanë, dhe Pjetri e kuptoi çfarë do të ndodhte. Heroi, që ishte i patrembur dhe vinte nga Kalifornia, po fillonte të bënte një mashtrim me lëvizjen e syve, dhe Pjetri u shtri dhe e mbylli televizorin .

Duke mbyllur pak sytë, Pjetri e shikoi ekranin e verbër për një moment. Ah, mendoi ai me një mosbesim të menjëhershëm dhe të përhershëm, pas asaj nate në të cilën kishte përballuar botën e të rriturve - të pakuptueshme,të paturp dhe të armatosur - dhe kishte dështuar ta çarmatoste, ah, le ta mbajnë këtë histori për vete , sepse është për kalamaj.

"Kleopatra dhe Frankenshtajni", ose rinia nëpërmjet një lupe të re

RINIA DHE QYTETI NË "KLEOPATRA DHE FRANKENSHTAJNI"

Nga Danielle Bartholet/ The Berkeley Beacon

Duke u endur në dyqanin e vogël si dollap me emrin e përshtatshëm "The Almost Corner Bookstore" në lagjen Trastevere të Romës, Itali, piktura në kopertinën e "Kleopatra dhe Frankenshtajni" më ngriti sytë nga tavolina kryesore. Romani i vitit 2022 nga Coco Mellors kishte qenë në listën time të librave për t'u lexuar prej muajsh, dhe për ndonjë arsye, u ndjeva e tërhequr ta merrja në dorë. Pyeta veten pse një libër që portretizonte jetën në New York City më kishte ardhur nëpërmjet një librarie në Romë.

Romani më ra në sy nëpërmjet forcës së gjithëpushtetshme të njohur si BookTok, një nënseksion i TikTok-ut i dedikuar për gjithçka që lidhet me librat. Recensionet në video që kisha parë premtonin shkrim të bukur, personazhe të gjallë e evokues dhe mjedisin vezullues të New York City-t në fillim të viteve 2000. Lexuesit flisnin për një shkrim që të linte pa fjalë dhe momente emocionale që të bënin të qaje, duke pohuar me entuziazëm se ky libër duhej të ishte në listën time të domosdoshme për t'u lexuar, si të thuash, tani.

Në këto aspekte, nuk u zhgënjeva. Ky roman i jashtëzakonshëm njujorkez bazohet në vibrime, energji dhe ndjesi të përgjithshme. Nuk mund ta shpjegoj më mirë se kaq.

Libri hapet në natën e Vitit të Ri të 2006-s, kur personazhet kryesorë Kleo dhe Frank kanë një takim të rastësishëm, ndonëse nuk mund të ishin më të ndryshëm. Vetë titulli i romanit është marrë nga nofkat që Kleo dhe Frank i vënë njëri-tjetrit në takimin e tyre të parë. Gjashtë muaj më vonë, ata janë të martuar. Prej aty, shpaloset një zinxhir ngjarjesh që zbërthen jo vetëm jetët e tyre, por edhe jetët e atyre që u janë të afërt.

Është një rrëfenjë e rinisë dhe mungesës së përvojës, pyetjeve rreth identitetit, dhe ndjesinë e të qenit i palidhur dhe i humbur mes atyre që mendoje se i njihje më mirë. Ngritjet dhe uljet e tij dhe kulmi shkatërrues tregojnë se çfarë ndodh pas një zgjedhjeje të momentit, dhe se si ajo del jashtë kontrollit tonë.

Aspekti që e veçon këtë roman është kasta e tij e personazheve. Çdo person i vetëm është një individ plotësisht i mishëruar, me dëshirat, shpresat dhe të metat e vetat. Një arritje e tillë e bën çdo faqe të romanit plot ngjyra dhe personalitet. Çdo personazh ka zërin dhe ndjesinë e tij të veçantë në kapitujt e këndvështrimit të tyre, diçka që është e vështirë të arrihet dhe të mbahet në një roman me një kastë kaq të madhe. Mellors arrin të prezantojë shumë pjesë të ndryshme në lëvizje duke i penguar ata të mjegullohen me njëri-tjetrin.

Libri është në kategorinë e trendeve, ende popullor në TikTok, dhe për këtë arsye gjen një vend ekspozimi në tavolinat e librarive. Është një roman që sfidon çdo kategorizim tjetër, që të mbërthen, si sytë e pikturës në kopertinën e tij.

Kur arrita në kapitujt e fundit, u godita nga një ndjenjë serendipiteti. Romani përfundon me Kleon dhe Frankun në Romë. Siç e përmenda më herët, unë e bleva librin në atë qytet, pa e pasur idenë se do të përfundonte atje. Ajo rastësi e bëri fundin e romanit tepër të hidhur e të ëmbël, pasi më kujtoi kohën time në Itali, të cilën e rijetova përmes syve të Kleos teksa ajo bënte një stazh atje.

"Kleopatra dhe Frankenshtajni" na çon në një udhëtim nostalgjik që nuk i shmanget realiteteve me të cilat njerëzit përballen në jetët e tyre dhe sjell në faqe, nëpërmjet një shkrimi verbues, si gëzimin e pamasë, ashtu edhe trishtimin melankolik të të kuptuarit të vendit tënd në botë. Rrëfenja urbane më transportoi nga New York-u në Los Angeles e në Romë, një tur kozmopolit përmes syve të personazheve që janë të paharrueshëm shumë kohë pasi faqja e fundit e romanit është kthyer.



Karikaturë nga Arben Meksi